

INTERVISTË ME FATMIR KRYPËN

Prishtinë | Data: 3 mars, 2020

Kohëzgjatja: 305 minuta

Të pranishëm:

- Fatmir Krypa (I intervistuari)
- Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Fatmir Krypa: Pra, po ja fillojmë... unë jam lindë në vitin 1942, në Gjakovë, në një familje zejtarësh. Kam pasë fatin prej një babe i cili më ka ushqy me dije dhe edukatë edhe respekt të punës, të cilin unë sot e përcjelli hap pas hapi kur shkoj në mendjen... atë e mbajë dhe në studion time. Vazhdimisht monitorojmë, tu i evoku gjërat të cilat kanë pasu gjatë jetës sime, dhe është një shembull i mirë që mu më ka mbajtë gjatë tanë jetës. Kur u prezantojsha si fmi, kur më pytshin qytetarët për ndonjë rast, “Djali i kujna je?” Kur i tregojsha se djali i Halil Krypës, “Respekt”. Nuk dishin të thonin fjalën respekt, por afërim i thojshin, shumë burrë i mirë, shumë burrë i ndershëm... fjalë, epitetet ku ma të ndryshmet, ma të mirat.

Edhe unë atëherë si fëmi fort nuk i fokusojsha kto vëmendje, çka do të thotë kjo? Por me kalimin e kohës unë fillova të monitoroj situatën se vertetë qenkëm në një familje fatbardhësisht tu u eduku prej një njeri i cili edhe sot e mbajë një edukatë të tij, megjithëse jam shkollu 20 vite në shkollë. Por, ajo edukatë që më ka dhanë prindi nuk është edukatë as master, as doktoraturë, por është një edukatë e cila është e veçantë, prindore, jetësore e cila i nevojitet çdo njeriu. E edukata familjare është shumë e madhe për çdo krijesë që rritet e zhvillohet. Shkolla mund ta perfeksionoj, t’i jep kahje të ndryshme, mirëpo edukata familjare është shumë me rëndësi.

Erëmirë Krasniqi: Çfarë njeriu ka qenë baba i juaj edhe çfarë përvoja ka pasë?

Fatmir Krypa: Ai... përvoja e tij ka qenë se ka pasë një dalje prej Gjakovës shumë shpesh, shumë herë. Ka qenë një tregtar, me profesion rrobaqepës. Dhe ka ble materialet në... për dyqanin e tij në Zagreb, Maribor, në Celje, Kranj... andena ku kanë qenë fabrikat e tekstilit. Dhe kështu importonte edhe modele të reja, importonte edhe me çmime më të volitshme për me i bo konkurrencë që atëherë të tregut. Dhe ishte i veçantë se nuk kishte asortiment të tillë, kolegët e tij nuk e kishin atë asortiment që ky e mbante. Dhe, ai me atë që lëvizte poshtë e lartë nëpër ish-Jugosllavi. Ai vetvetiu e sjellte një gamë kulture të Zagrebit, Lubjanës, Sllovenisë... edhe ajo domosdoshmërisht binte... reflektohej te ne në familje, në sjelljen... Ai me qytetërimin e tij edhe njerëzit i bënte për vete.

Kështu që, une si fëmi i tina kom pasë atë përfitim që e kom ritransmetu në vete edhe në fëmijët e mi. Përveç anës pedagogjike, çka kom mësu në pedagogji e në psikologji gjatë shkollimit e gjatë leximit, e

gjatë praktikës në jetë me studentë [gjatë përvojës 50 vjeçare, une e kom gërshetu të kaluarën me këtë të sotit t’u i harmonizu gjërat dhe t’u e dhanë një mendim ashtu adekuat për secilin fëmijë.

Erëmirë Krasniqi: Sa fëmijë keni qenë në familje?

Fatmir Krypa: Edhe ashtu si fëmijë ishtë një jetë e veçantë tash kur e shof nga këndvështrimi i moshës 78 vjeçare. Unë për herë të parë në lagjen ku jetonim, ndoshta ka qenë edhe topi i parë në lagje... po, po, në qytet të Gjakovës një prej topave të parë të 11astikut {lëvizë duart sikur luan me top} kanë qenë që ma ka sjellë prej Zagrebit. Dhe ne nuk dinim me lujt me të, ai kcente shumë... ishim mësu me lujt me topa prej leshit që ja u nukshim lopëve leshin, e bojshim topin. Bojshim topa prej cuklave, me të lunim. Kurse kur ma sjelli baba atë top ishte, ishte befasi se si ai hedhej nalt e ne s’dinim sa duhët... edhe nuk dishim një herë hala me manovru me... si vepron një top i 11astikut. Domethënë, deri në atë gjendje.

Ajo kohë kur unë kom shku në shkollë, kur ia spjegoj dikujt diçka thotë, “Çka është kjo?” I thonim taftë. Taftë. Çka është taftja? Ka qenë një pllakë A4 më një kornizë të drunit, si tabelë e zezë, e hollë. Dhe njënen anë ka qenë pa vija, njënen anë ka qenë me vija të bukurshkrimit. Vija të gjana dhe të ngushta, të gjana dhe të ngushta. Njëra anë ka qenë e zbrazët, krejtësisht e zezë, dhe në të ne i shkrunim detyrat që na i jepte mësuesi në klasë dhe i zhvillonim në shtëpi, dhe ia kthejshim me një shkumës i cili e gërrithte, linte gjurmë të bardha, të hint a linte. Dhe ajo ishte fletorja, ajo ishte si me thanë të gjitha çka kishim, çka posedonim. Megjithëse, abetarja ekzistonte për mësuesin. Kurse për ne abetarja në gjysëmvjetorin e parë nuk ka ekzistuar. Ne gjysëmvjetorin e dytë na kanë dhanë abetarën. Por me gjetuninë e prindit, ai më ka... mu edhe disa shokë të mi, fletore më ka sjellë, fletore të cilat ma vonë fillunë të bahen përditshmëri e nxanësave të mavonshëm.

Por kjo, kur i them dikujt se në taftë ne kemi shkru matematikë, kemi vizatu, kemi llogaritë, kemi bo bukurshkrim. Dhe çka ishte ma e keqja, ti duke shku në shkollë me taftë në krahë, ndonjë shok, ndonjë shok, s’mund ti them si shok ai, por dashakeqës, vinte dhe ta fshinte detyrën dhe ti shkojshe në shkollë pa detyrë.

Erëmirë Krasniqi: Domethënë, krejt detyrat i bojshit në të njejtën taftë?

Fatmir Krypa: Njejtën taftë, njejtën taftë. Po, po. Ajo fshihej me leckë, fshihej me leckë. Shpuza nuk ekzistonte në atë kohë. Shpuza nuk ekzistonte. Dhe ashtu ishte një jetë fëminore e shkollimit të vitit të parë. Para kësaj më kujtohet një ngjarje kur mbi Gjakovë defilohen aeroplanët të cilët tërhekshin forcat e Luftës së Dytë Botërore prej Greqisë, dhe kalonin ka Gjakova. Posa kisha dalë, kisha tre vjet. Ishte fundi i luftës dhe u mbush qielli me aeroplana. Kurrë s’kisha parë një gjë të tillë. Aeroplana, s’mund t’i numrojshe sa ishin shumë, ndoshta 80 deri në njëqind. Ishte mbushë qielli.

Një burrë në moshë ashtu 30, 40 vite më kapi për dore dhe rrugës kur dola në rrugë më tha: “Ik ndër një strehë.” Unë s’disha pse. Deri sa t’i jepsha përgjegje pse, ai më kapi për dore dhe më futi ndër një strehë edhe më tha se mund të më vrasin aeroplanat. Çka disha fëmi që munen me vra aeroplanat mu, çka i’u kom bo une diçka, po ishte luftë ata e dinin e une nuk disha se për çka janë ata, se për çka është aeroplani, për herë të parë e shifsha. Edhe qiellin e mbushën plot dhe më kapi dhe më sjelli në një

strehë, streha ishte për nja 70 a një metër e gjatë, më terheki ndër atë strehë deri sa u largun aeroplanat andej nga Peja.

Kur ndëgjoni mandej nga pleqtë se është bombardu Peja. Ajo ishte bombardimi i gabushëm sipas disa të dhënave, se është bo gabim që është bombardu Peja. Ajo në një farë forme gabim, apo ka qenë gabim i dhanë nga shpiunazhi, ka dhanë me qëllim dikush apo ajo nuk i dihet përgjigje, akoma deri më sot. Viktima ka pasë shumë në Pejë, në njerëz dhe në infrastrukturë. Këtë më kujtohet mandej kur e kom vizitu Pejën edhe kur e kom pa në realitet Pejën si qytet. Kur kom shku në Shkollën e Artit, kom vërejt gjurmët ku janë bombardu vendet, lokacionet ku janë bombardu edhe të dhënat të cilat ma të detajshme të këtij rasti. Por, ta kalojmë këtë, të vazhdojmë me formën e vijimit të shkollimit...

Erëmirë Krasniqi: Zoti Krypa, çfarë familje keni qenë? Sa keni qenë e madhe?

Fatmir Krypa: Po nga familja kështu kemi qenë, unë kom qenë djali ma i madh në familje prej gjashtë fëmijëve. Dy motra dhe kemi qenë katër djem. Unë prej tyre ma i madhi, dhe prej kësaj kanë arritë të shkollohen me diploma master domethanë dy vëllaznit tjerë dhe unë. Në art nuk ka doktoraturë, se do ta kisha bërë, por në art nuk ka doktoraturë. Edhe vllau mas meje që ishte, ishte i interesum, ma tepër fokusohej nga zeja e prindit. Kurse motrat krynin gjimnazin edhe u martu njëna, u martu tjetra. Dhe kështu kanë metë me...

Erëmirë Krasniqi: A i ndimojshit babës si fëmijë?

Fatmir Krypa: E tani kështu. Në këtë pyetje është një përgjegje shumë që e përdori vazhdimisht si moto: “Mos të humbet koha kot”. Atë e kom si moto edhe në familjen time, e kom pasë edhe e kom në punën time sot. Unë në mëngjes e programoj ditën, çka do të bëjë paradite, çka do të bëjë gjithë ditën dhe në mramje. E planifikoj ditën. Një agjendë globale [të përgjithshme]. Mund të ndërhyjnë rastet kur mund të thërret dikush, një agjendë me shku, ndonjë kërkesë tjetër dhe ndryshon. Por në 80 përqind t’i përmbylli ato agjendat që i kom planifiku në mramje. Dhe vllau mas meje që ka qenë e ka vazhdu zejen e babës edhe mandena e ka ndrru edhe atë se iu mërzit, e ka pa që ndoshta në punësimin e kish me qenë diku ma mirë. Në ndërmarrjen “Agimi” u bo një mbikqyrës, një shef, mandena në shtëpinë e mallnave “Agimi” të Gjakovës, dhe aty përfundoi edhe karriera e tina se u bo lufta dhe ajo u mbyll. Mandena ka pasë punë tjera.

Dhe kështu që, vllaznit tjerë, njëni profesor në kibernetikë, e pat studiu kibernetikën. Tjetri maqinerinë në Zagreb, e ky kibernetikën në Beograd. Që të dy janë si me thanë, janë mundu që t’i fokusoj që të kenë sa më shumë profesion atë që është deficitare. Dhe iu kam... kanë gjetë përkrahje dhe financiare dhe kështu të gjitha... edukative edhe i kom trasu që ta vazhdojnë një drejtim të tillë. Dhe edhe njëni edhe tjetri e kanë përfundu me sukses, njëni në Beograd e tjetri në Zagreb.

Erëmirë Krasniqi: Mendova kur keni qenë fëmijë a i keni ndihmu babës?

Fatmir Krypa: E tani une kthehem nga vetja. Ishte qe thashë një kërkesë e prindit që mos ta humbja kohën kot. Ky motiv mbetet edhe sot. Shkollën e kisha larg nga shtëpia skaj më skaj Gjakovës. Dhe gjithnjë më pyste në mramje, referimi u deshtë raport për çdo mramje. Për çdo mramje u deshte m’i dhanë raport se çka kom bo sot, çka mendoj nesër, çka ki në plan nesër. Këtë kur e them, i thom

faleminderit babës. Ai më linte në një farë forme një kënd sa për lodra ma të arsyeshmet, e jo të humbem krejt në lodra. Prej shkollës nëse ki me mësu, kryj detyrat. Nëse nuk ke me mësu, eja në dyqan. Edhe njëhën duhej ta zgjedhshe. Të dalim me shokë, me luajt, me luajt, me luajt deri në pafundësi. “Jo, jo”.

Në klasën e shtatë dhe në klasën e tetë u kriju teatri i fëmijëve në Gjakovë dhe unë së bashku me disa shokë të mi u përzgjedhëm në atë ekipë me luajt “Borëbardhën”, mandena “Kësulëkuqen”, e mandena edhe disa të tjera kështu. Me ka 20 premiera, asine repriza. Në Pejë shkojshim, ne Gjakovë shkojshim edhe në shfaqje. Kështu që, m’u deshke me dhanë edhe kontributin në shoqinë tjetër të amatorizmit artistik. Dhe kështu që i thojsha babës, “Sot kom prova”. “Eh, po mirë, shko në prova”.

Por këndojsa edhe kështu, u deshke edhe në kor të shkollës të shkoj. Shkojsa në kor të shkollës kur kishim provat për ndonjë kremtë fundviti... mandena prova për teatër. Dhe krejt këto përfundojshin mbrenda ditës. Dhe dyqanin... dhe qitash e shtina maqinën, muj me pasë, dje e kom sjellë prej shtëpisë, maqinën e rrobaqepsisë, qe ktu e kom, e fotoqrafojmë mandej. E sjella, se vajzës duhet të ia shkurtoj një parë trenerka.

Erëmirë Krasniqi: Domethënë, ai e ka bo edhe...

Fatmir Krypa: Unë zanatin e rrobaqepsisë e kom mësu në tërësi. E di plotësisht. Kjo ka qenë një moto e imja që ta mësoj zanatin. Shkollën po se po, zanatin. Kudo që të shkojsh me zanat... në Afrikë me të gjujt me parashut, me të gjujt dikun me një vend, munësh me jetu. Edhe ajo më pat dhanë edhe si motiv që ta mësoj edhe zanatin e fotografisë në Pejë. U pozicionova te një fotograf edhe ai, i bojsha fotografitë e mia që e kisha një Altix IV, një aparat të vjetër, Altix IV. Edhe bojsha fotografi kështu. I zhvillojsa aty. Dikur fillova edhe vetë me i zhvillu në emulsion te ai.

Fillova me i ndihmu se ai e kishte mangësi të pamurit. Unë isha në Shkollë të Artit atëherë. Por, para se të vijë te kjo, kur thashë nuk po defilojë nëpër një situatë, por po kaloj... e aty e mësova edhe zanatin e fotografit. Prej retushit të fotografisë, që ishte jashtëzakonisht vështirë, por synin e kisha jashtëzakonisht të mrehtë se isha nxanës i Shkollës së Artit. E bojsha fotografinë e retushit s’u vrejke a është e prekne fare, se në film u dashke me laps me bo retush. Në film.

Dhe mësova të fotoqrafoj në studio, se në natyrë, në enterierë, në eksterierë u bonë... me drita, pa drita këto u bonë krejt. Dhe të zhvillojë fotografinë, të bojsh retush, zanati i fotografit u mësu. Zanatin e rrobaqepsisë e kisha mësu.

Erëmirë Krasniqi: A qepshe për vete?

Fatmir Krypa: Po, po. Unë këmishat i kepsha për dymbëdhjetë minuta. Dymbëdhjetë minuta e kepsha një këmishë. Se bojshim gara me, se kena pasë edhe tre punëtorë tjerë te baba në dyqan. Kështu që, bojshim gara me punëtorët, kush po i kepë ma shpejtë. Dymbëdhjetë ka qenë norma të cilën e kom arritë më së shpejti. Dhe kështu pantollat po ashtu. Mirëpo, kjo ishte vetëm sa për ta mësu zanatin edhe nuk disha se çka do bahet me mu. Une vizatimin e kisha mësu që heret, në mënyrë instikti. Edhe në klasën e katërt fillore e bona një portret të Skenderbeut që gjindej atëherë në librat e historisë, në profil. E mësojshim Skenderbeun por në vija të shkurta, sa për të mësu kush është

Skenderbeu. Dhe ishte fotografia në faqen e... me një faqe të librit. Dhe une e marr atë edhe e rriti në fletë të bllokut numër katër, aq kena pasë blloka. Dhe mbasi që e punova, ia çoj mësuesit në orën e vizatimit edhe i thom, “A e kom vizatu mirë?” Edhe pak me një frikë a e din se ai i përngjante Skenderbeut, e shihsha që po i përngjanë.

Edhe çdo punë që e bojsha ia tregojsha babës. E kom pasë një kontakt kështu si me thanë një... raporti ka qenë prind fëmijë por si me thanë unë mendojsha se din ai gjithçka. Ku din të vizatoj ai, a di? Por thonte se mirë, “Mirë është, po”. Ma bonte rrafsh ndoshta ndonjëherë, por më thonte se mirë, por edhe une i besojsha. Dhe atë ia çoj mësuesit, Mazllom Hoxha, një mësues shumë i përmbajtun, shumë edhe sikur të gjithë mësuesit e asaj kohe që kanë qenë shembull për nxanësin, për prindin, për kulturën e asaj kohës. Për çdo send kanë qenë shembull. Mësuesi ka qenë diçka si një njeri që e bon korigjimin e shoqnisë në çdo hap. Edhe me të pa në rrugë të keqe, “Kqyre djali i mirë se e ki keq”. A e din, në rrugë munët me të këshillu e lëne ma në klasë. Aq ka qenë roli i mësuesit kudo, në çdo vend. Edhe ka qenë respekti po ashtu i nxanësit ndaj mësuesit. Kur i ka thanë mësuesi një gjë të tillë, ajo ka qenë një gjë e përmbyllun, e përkryme. Edhe e vërtetë, edhe e sinqertë që po thotë, dashamirësi. Jo vetëm sa për ta thanë.

Edhe ai më thotë se, “Kush të ka ndihmu?” A e din, më thotë mësuesi, a e di? “A të ka ndihmu dikush?” Unë isha më i madhi, s’kish kush me më ndihmu, çfarë!! Po i them, “Jo, vetë e kom bo”, a e di. “Shumë bukur”, thotë, “shumë bukur. Ma jep këtë”. Edhe e ngjet me i thojshin patenta, do farë kapse me maje, të rrumbullakta me maje kanë qenë. Me katër patenta e ngjiti diku në mur të klasës atë fletën numër katër aty, Skenderbeun. Edhe mu m’u dokë *uha* {onomatope} mësuesi ma ka zgjedhë këto edhe nxansave ju erdh mirë, a di, kjo qysh po dika ky me vizatu, a di, po... Tashti isha, a e din, prej nxanësave si të thojsh tash modesti, kemi qenë, po, 40 nxanësa në klasë.

Erëmirë Krasniqi: A ka pasë vajza në atë kohë?

Fatmir Krypa: Po, po, po, po, po, si jo. Ka pasë vajza. Edhe ka qenë një numër mjaft... edhe aty një rast kur m’u bo përzgjedhja e asajna une fillova me mendu se ndoshta po dikem me vizatu. Ndoshta po dikem me vizatu, a din, po. Dhe të nesrit, ashtu gjatë javës mësuesi më thotë, “Fatmir, duhesh me i bo krejt hartat e gjeografisë”, që kishim mësu për lumenjtë të Jugosllavisë së atëherëshme. Sot di ta vizatoj tani hartën e kufirin e Jugosllavisë përmendësh. E di edhe lumenjtë, liqenjët, malet, fushat, xehëroret, të gjitha ato t’i boj disa harta.

Ato hartat ishin në gjysë hameri. Dhe ai i kishte porositë diku dy shtaga dhe i vënte shtagat dhe i virrte në klasë. Të gjitha ato detyra që ne i kalonim gjatë procesit mësimor më shtike t’ia vizatoj dhe unë i pasqyrojshim në klasë. Dhe kjo m’u dukë mu në klasën e katërt se është diçka një punë që po e boj, po menoj veç une, a e din, si... po modestia ka qenë tejet e madhe, tejet e madhe, tejet e madhe. As s’guxojsha ti thojsha vetit se unë po dikna diçka. Por s’di pse po e boj une këtë, se s’ka qenë moto te të rinjët të krenohen me një punë që unë e kom bo, a unë... edhe me rrejt, ajo ka qenë e pamundur, e lëne ma atë të vërtetën ta tregojsh, t’ia pasqyrojsh dikujt që e ke bo vet, që ta ka verifiku dikush ma i vjetër. Edhe ndonëse dojsha të barazojsha me landë të tjera. Qitu i kom dy libra...

Erëmirë Krasniqi: E krejt i mësojshit... krejt klasa mësojshit gjeografi përmes vizatimeve tuaja?

Fatmir Krypa: Po. Po. Ishin hartat. Ja kufiri, ja ku janë malet... Trigllavi, qe ku është maja e Trigllavit {tregon me gisht} e Slloveni, 2700 e sa metër, tash, 2800 a sa, po, është kjo e naltë. Kqyre këtu ku është kjo {tregon me gisht}, kjo është Panonine, kjo është fusha ma e madhe, qe ku është ktu, qe ku është... Dalmatët ku kanë qenë, krejt këto. Edhe aty ishin edhe historia, edhe gjeografia aty. Dhe une tashti fillova edhe vetvetiu të pasqyroja dhe dijen dhe në landë të tjera, se matematikën e disha mirë. E kisha një djalosh që punonte në dyqan te na dhe ai s'kishte detyrë në matematikë që nuk më shtinte me zhvillu në kohë të lirë. Kur s'kisha me punu diçka më shtinte me punu në matematikë. Matematikën e kisha diçka, përveç vizatimit si landë të dytë. Edhe ka qenë momenti kur a të studioj arkitekturën, a të studioj artet? Aty ka qenë një dilemë, por veproj 60/40 të studioj artet, se matematikën e kom dashtë...

Eh kështu tani... kur një ditë me qiti profesori në klasë me më... matematikë, po tash për me e marrë një notë. Dhe e qiti një kolegë që dinte, që ishin... Në klasë nuk kishte ma tepër të shkëlqyshëm se tre, katër student... tre, katër nxënës. Jo sikur tani tërë klasa është e shkëlqyeshme, ose 80 përqind. Atëherë kanë...

Erëmirë Krasniqi: Nuk mujshin krejt me përcjellë, a qysh...

Fatmir Krypa: Qysh?

Erëmirë Krasniqi: Nuk ishin krejt të aftë me u kyç në sistem...

Fatmir Krypa: Jo, jo, jo, po shiko tashti. Nuk kanë pasë kush të ngritë nivelin e tyre. Dhe nivelin tash po them na katër, pesë nxënës prej 40 nxënësve, çdo i dhjeti me qenë... 40 nxënës... 40 me qenë të shkëlqyshëm ishte bukur një krenari me qenë. Edhe na jepnin nga një libër, qitu e kom, ta tregoj mandena. "Për sukses të shkëlqyshëm i jepet ky libër filan fistekut". Edhe në gjysëmvetor edhe në fund të vitit, i kom ato dy libra. "Si u bë njeriu vigan?" Libri i parë i cili është përkthyer në gjuhën shqipe, edhe "Tregim për bukën e bardhë".

Edhe ky ka qenë fillimi i përkthimeve nga literatura serbe sepse s'kishte shkrimtarë të cilët... ma vonë Esat Mekuli me poezitë e tij e kështu.

Erëmirë Krasniqi: Po libra?

Fatmir Krypa: Urdhno? Libra nuk kishte. Doli ma vonë "Rrushi ka nisë me u pjekë" i shkrimtarit Sinan Hasani, por ai ishte vitet e mëvonshme, shumë mëvonshme. Ai është romani i parë shqiptar që ka dalë, "Rrushi ka nisë me u pjekë" i Sinan Hasanit. Fatëkeqsisht nga një njeri që mandena e devalvoi vetën politikisht, ku edhe vepra e tina, ndoshta e para që është shkruar si roman i parë nuk permendet. Nuk din kush. Nuk e permend kush. Nuk e vlerëson kush, se e njollosi vetën, e njollosi edhe artin e shkrimit me punën e tij që bëri në politikë. Po them, se une polikan nuk kam qenë edhe nuk jam, nuk mirrem, por ashtu e menjanuan atë krijimtarinë e tina.

Dhe kështu që, me atë... në gjysëmvetorin e dytë se është, ktu po e zo pak në spikamë këtë vitin e katërt se ajo është një trampolinë prej të tjerëve, prej vetës, që kom ba në vështrim me artin. Dhe në gjysëmvetorin e dytë më shkoi mësuesi Mazllom, më erdh një tjetër Salih Canhasi, një burrë ma i

vjetër. Ishim mësu me atë mësuesin e ri. Ishim mësu, ai ishte ma alegro, ma i përafërt. Ky ishte ma me përvojë, kishte ma përvojë edhe... por disi na, si vajza ime e dytë kur donim ta regjistronim në klasën e parë, “E du mësuesen e bukur babi, e du mësuesen e bukur nanë”.

Edhe na donim mësuesin me qenë i bukur. A ky Salih nuk ishte me atë por mandena ai e boni, e kompenzoi atë fizikus me punën e tij, me gjestet e tij, me vlerat e tij. E boni të bukur vetvetën. Ma të bukur se sa që ishte ndoshta, ndoshta, mësuesi Mazllom, të cilin e kom një respekt të madh. Edhe kurdo që e kom pa, jemi pa, e kujtonim me mallë njëni-tjetrin, ato vizatimet që i bëja. Atëherë i kujtonim. Kur më ka vdekë edhe nana, ngushllimet që m’i ka bo, ju thotë, “Fatmiri ka qenë një prej nxanësave ma të mirë që kom pasë”. Ne sobën e burrave aty, që s’ishte vendi, por ai e thoshte, “E kom pasë nxanës të mirë”.

E kur një ditë ky mësuesi Salih, kishimi orën e vizatimit, kjo është shumë me randësi për mu, vitale. Ishte ora e vizatimit, pushimi ishte i gjatë, 15 minutësh. Kishim dalë të gjithë jashtë. Mësuesi Salih e kishte gjetë një perspektivë, një rrugë, në perspektivë, ndërtesa ma e madhe, ma e vogël dhe ma e vogël, si zvogëlohej në një libër. Dhe donte me e vizatu në dërrasë të zezë për me e mësu na perpspektivën, çka është perspektiva, me mësu me e vizatu shpia qysh duket në fillim e madhe, e njëjta shtëpi, por kur shiqohet prej së largu, po edhe e njëjta shtëpi ku është e dyta, e treta, dukën se janë ma të vogla. Ato në realitet janë të njëjta. Dhe ka marrë me vizatu, ato ju kishin pasë rrëzu, s’kish pasë mujt m’i vizatu.

Ku e morra vesh une? Po më thërret kujdestari, se edhe mësuesi Salih më shtini me punu mu disa vizatime mandena. Të gjithë kryetarët e Republikave, se m’pa edhe ky, “Kush i ka bo këto harta?” “Kush e ka bo këtë?” “Fatmiri”. A din? Eh më shtini me i bo mandena krejt kryetarët e Republikave të asaj kohe që ishin të Jugosllavisë. Lazar Kolisevski, nga Maqedonia. Djura Pucar “Stari”, prej Vojvodinës. Ivan Gosnjak, ka qenë prej Kroacisë. Petar Stambolic, ka qenë prej Serbisë, e të tjerë, e të tjerë. Kështu prej gjashtë republikave. Me i bo krejt kta kryetarët e Republikave, me i bo. Kishim mësu na në aty edhe tashti më shtini ai me ia vizatu aty.

Edhe ta vizatojsh, edhe ta rujsh karakterin nuk ishte gja e vogël. Se aty një imtësi e vogël të ia bojsh tani ke një hark në sy nalt, edhe një poshtë. Po asnjëni se kemi synin të njëjtë. Dy harqe i kemi, asnjëni se ka synin e njëjtë. Ta bojsh ma të hapët, ma të pjerrët, ndryshon karakteri. Hunën ma të gjanë, hunën të gjatë, buzën ma të trashë, buzën ma të hollë, ballin ma të ngushtë, ti e ndryshon karakterin. E ti tash duheshe me i vlerësu mirë këto proporcione. E se di une i pata... në mënyrë instinkte, si fëmijë, i pata përvetsu.

Edhe tash po e lidhi me mësuesin Salih. S’ka mujt me i vizatu, e ka fshi me shpuzë. Mirëpo, shpuza ka qenë e terur. E ka fshi, disa herë e ka fshi, sipërfaqsisht. Ama sytë e mi kanë qenë aq të mprehtë, sa e vrejta në tabelë se është fshi ma parë shtëpijat të cilat u dukshin si të rrëzume. Jo në perspektivë me qëndru ato, por ato u rrëzojshin. S’ka mujt. “Kujdestar, ku është Fatmiri? Thirre Fatmirin”. Vrap une, thotë “A din me vizatu këtë?” Po e kqyri, rrugicë me tri shtëpia njëna anë, tri shtëpia tre-katëshe njëna anë, tri shtëpia tre-katëshe tjetra e në perspektivë. Ma e madhe, ma e vogël dhe ma e vogël. Ashtu edhe ana tjetër. Edhe une pa vizatu asnjëherë në perspektivë i thom, “Po”. S’e di ku morra guximin

edhe kjo bash sot i boj pyetje vetit si kom marrë guximin m'i thanë po. Edhe i thashë, "Po". Edhe morra e vizatova ashtu siç ishte në libër.

Kur ju afrova tabelës e pashë se mësuesi kishte vizatu ma parë, s'kishte mujt ta vizatonte, e kishte fshi. Edhe mu kjo më erdh si me thanë keqardhje, por krahas kësaj keqardhje edhe një mburrje, që tashti une po vizatoj ma mirë se mësuesi. *Uaa* {onomatope} kush jom une? Në klasë të katërt me një mësues me shumë përvoja, me një njeri që... jashtëzakonisht pedagog. Mandena qe thashë, e boni vetën të bukur, të mençëm te une sikur të ishte ai gjithçka mbi mu. Edhe e vizatova. As nuk më tha mos i thuj kuj se e ke vizatu ti. Por unë kurrën e kurrës deri mbas vdekjes të tina, Salih Canhasit, ndjesë pastë, nuk e kam thanë kta. Po pse edhe mos ta them? Se nuk është e thane ai si pedagog me ditë me vizatu. Por ka qenë një pedagog i mirëfilltë për të gjitha të tjerat që mu më ka majtë në atë gjysëmvetor të dytë në një rank shumë të lartë të punës time që kom ba me landët e tjera dhe me landën e vizatimit.

Edhe, kështu që, unë gjatë tonë jetës e kom përmend, e kom përmend, edhe në biografinë time, në monografinë time, do ta kem portretin e tina. Do ta kem fotografinë e tina, se jemi nxanësa te dalur në shkolle fillore, me flok të rrumë se baba aty ka pasë princip, këtu kom pasë një vërejtje te ai, por hajde guxo me i thanë pse. Kur bojshim me dalë me shku në fotografi për fund të vitit m'i jepke paret me shku te berberi, me shku m'u qethë. Jo, m'u qethë, por me rru tërësisht kokën. Ashtu bënim të gjithë pothuajse, fëmijët. Dhe jam në fotografi të klasës së tretë, fotografinë e klasës së katërt me flokë të rrumë. Po mirë, ajo është fizikusi, aty është, me gjithë atë është një e vërtetë, një biografi, një ashtu që une e kom parasysh. Dhe me këtë njohuri që pata përmbledhë, se edhe e kom edhe nënshkrimin e tij, që do t'ia deponoj, do t'ia... në monografinë time këtu që e kom. Edhe që më ka dhuru atë libër, shkrimin e tina dokumentar që e kom, do ta... se sa herë ta shof më del fotografia e tijë përballë. Edhe e kom një respekt të veçantë.

Kjo, viti i katërt ka qenë për mu një bazament që e ndërtova vitin, e ndërtova veten me landët e tjera me një sukses të shkëlqyshëm e me një njohuri që kisha përfitu nga vizatimi dhe vazhdova mandej në klasën e pestë e të gjashtë e....

Pjesa e Dytë

Erëmirë Krasniqi: Qysh vendosët me shku në Shkollë të Artit, të mesmen po mendoj...

Fatmir Krypa: Qe shkojmë... klasën e shtatë në orën e vizatimit po ndëgjojmë ka ardhë një arsimtar prej Pejës, quhej Shahin Kryeziu¹. *Uaa* {onomatope}, na s'dishim hiç kush është ai, i sertë thojshit. Oh, çka do të thotë i sertë, i ashpër, po kërkonte shumë. Unë për vizatim s'e kisha atë merak, po thojsha hajt. Erdhën profesori i vizatimit, në orë të vizatimit Shahin Kryeziu, kjo ishte klasa e shtatë e shkollës fillore.

¹ Shahin Kryeziu u regjistrua në Shkollën e Mesme të Arteve në Tiranë në vitin 1938, në klasën e Prof. Odhise Paskalit. Gjatë viteve 1940-1943 qëndroi në Torino (Itali), pastaj vazhdoi studimet në Akademinë e Arteve në Firenze (Itali). Nga viti 1945 filloi të jepte mësimë në Shkollën e Lartë të Pejës, si Mësues i Vizatimit. Ai ishte ndër nismëtarët për themelimin e Shkollës së Lartë të Arteve në Pejë gjatë vitit 1949.

Edhe kur e dha temën, e kishte bo ni temë, e kishte marrë një vizatim të vetin, një pikturë në realitet, natyrë të qetë me fryta, me lule dhe me një pelhurë e kishte vizatu, e kishte pikturu edhe na pruni, e ngjiti në tabelë dhe tha, “Ja ta vizatoni, keni kujdesë këto, këto, këto”. A din sa vështirë është ajo ta vizatonin nxanësat e tjerë, unë e vizatova ato dhe tha, “Javën tjetër duhet në shtëpi ta ngjyrosni”. Po mirë, unë e ngjyrosi edhe e ngjyrosi me ngjyra temper, në Gjakovë...

Erëmirë Krasniqi: Ngjyra temper tash ka pasë...

Fatmir Krypa: Në Gjakovë nuk kishte ngjyra temper. Ai kishte ardhë prej Pejës, kishte mbetë se kishte studiu dy vjet në Venedik edhe kur ka ardh gjatë Luftës se Dytë Botërore ka qenë këtu, e ka nxonë Lufta e Dytë Botërore dhe nuk u kthy mo në Itali. Me ato dy vite të studimeve ka mbetë në Pejë, ka qenë si profesor i vizatimit, mirëpo është shpërngul në Gjakovë dhe erdhi si mësimdhanës në shkollë te ne fatbardhësisht për mu. Dhe unë, ngjyrat temper i kisha marrë prej babës, m’i kish ble baba mu në Celje, ku prodhoheshin. Celja prodhonte ngjyra temper, aty prodhohen, në Kroaci. Aty m’i kish ble, se unë i thashë ni parë ngjyra. Ai ia ka spjegu atyne ngjyrat, ia kanë dhonë ni parë ngjyra, t’u mendu se edhe atje punohet me këto ngjyra sikur punohet ne Celje e në Zagreb, normal. Pse jemi na në provincë atje s’do me thonë se s’dimë çka jonë temperat, e ne s’kemë pasë lidhjen. Kur m’i pruni si kollodonta. Na punojshim me ngjyra të uji, na i thonim ngjyra akuarel në mënyrë ma profesionale, po në mënyrë të shkollës fjala ishte popullorqe “ngjyra të ujit” i thonim, se me ujë, pjesa dërmuse punojnë me ujë. Shumë kërkon ujë akuareli edhe akua- ujë, ngjyra të ujit.

Dhe unë e bona me ngjyra temper. Sa kisha majtë në mend ngjyrat, diçka kisha shënu, molla, këtu e kuqe, këtu e verdhë, këtu pak si e gjelbërt, mollës me ia dhonë këto pak sipas imagjinatës, pëlhurës ashtu si ishte si e portokallt, e bona me një ngjyrë të portokallt e pak bojë kafe ku duket ma e mbyllt, pak të zezë tu i përzi ngjyrat unë dhe ato e bona, e kreve. Natyrë të qetë dhe tash isha kureshtar me ditë a e kom punu mirë. M’u dukej gjatë me ardh ora e javës me ma korigju profesori Shahin, se ishte në atë kohë ma profesionalisti pothuajse prej shqiptarëve në Kosovë. Nuk kishe njeri që ishte ma i shkolluar me dy vjet të fakultetit. Dhe unë e prita ato në koridor me vizatim në dorë pa hy në klasë dhe i thom, “Profesor, a ka mundësi me më tregu a e kom punu mirë?” Ma murr në dorë, p’e kqyr. Tha, “Hin mrena në klasë”. E murr me ditar edhe e shënoi orën, i kreu ato procedurat.

Edhe tash po i pyt nxansat, “Qitni vizatimet mi pa se çka keni vizatu në shpi atë detyrën që e kom dhonë me ngjyros” dhe prej tyre askush, pothuajse dy tre vetë kishin bo tentativa se s’kishin ditë si ta ngjyrosin përmendsh ashtu. Po tre veta s’di që e kishin nisë, një pak ma e kish ka përfundimi e unë e kisha përfundu ato edhe me ngjyra temper që ishte për to diçka... edhe mu mandej po më thotë, “Çu në komë ti djalë i mirë. Ku i ki marrë ti këto ngjyra? Me çfarë ngjyra e ki punu ti këto?” Se shkrunte aty nalt *Temperne Boje* [Srb.: ngjyra temper]. Unë i thojsha, “I kom bo me ngjyra temper, asi si kollodont” thojsha. E dike që s’ka, se as në Pejë, as në Gjakovë, as në Kosovë, “Ku i ki marrë ti ato ngjyra?” Thojsha, “M’i ka ble baba mu në Zagreb atje, në Maribor, s’e di ku mi ka ble”, “Aha, po çka të punon baba?” Po i tregoj. Nejse, s’o me rëndsi ajo, “Shumë mirë”. Ajo filloi mandej nifarë korespondence me to, afërsie me to, çdo detyrë e merrsha me përkushtim dhe përfundoj klasa e shtatë me një respekt të ndërsjellë, unë për atë, ai për mu.

E ndrrum shkollën, shkum me një shkollë të re, dulem krejt se shkollat ishin të mangëta në Gjakovë. Bohej klasa e shtatë në shpinë e Begut, më një shpi private, nëpër shpia private. Shkollat ishin, shkolla e Komonit ishte uzurpu nga partizanët² ishte bo shkolla ku e kom kry katër vjet klasën, tri vjet. Shkolla e Mejtepi, Ruzhdije turqisht kjo i kanë thonë, ku e kom kry klasën e katërt aty ku isha me ata mësuesit. Klasën e pestë e pasna kry edhe klasën e gjashtë në lokalet e Gjimnazit. Klasën e shtatë në shpi private. Kështu ishin “Shkolla e Mullashabanit”, ishte “Shkolla e Begit”, “Shkolla e Komonit”, shkolla e tash s’po më kujtohen emrat e atyne shkollave, të atyne pronarëve të shpiave që kanë qenë ma të mdhaja, parizanëve ja u kanë marrë edhe e kanë shëndru në shkolla. Mandej, mandej kjo u bo një shkollë e re në klasën e tetë ku u fokusum një shumicë prej shpiave private dhe u bo një shkollë e madhe me emër të një serbit “Vojo [Vojislav] Lakičević”, dhe aty ishte ndoshta me mija nxanës, shumë shumë shkollë e madhe, mija nxanës. Fillonte prej mëngjesit deri në mramje me ndoshta tri turne kanë qenë dhe aty e kom përfundu klasën e tetë.

E kom fjalën për Shahinin, profesorin Shahin, respekt, që e kom ndoshta para televizionit [kamerës] me i kërku një falje edhe që s’kom mujt m’i kërku falje. Ni herë kur e kom taku rastësisht, se u bona redaktor për sajimin e monografisë se Kosovës në Galerinë e Kosovës, dhe e sajum po mendoj kush me marr pjesë ku, piktorët, skulptorët, grafistët edhe e kishin harru Shahinin piktorët. Thamë, “E ku është piktori Shahin Kryeziu?” “Jo, s’e kena shti”. Thashë, “Si nuk e keni shti? Ai ka dhonë bazat, ka dhonë mësim në Shkollë të Artit, ka dhonë mësim brezave”. Thashë, “Ai ka qenë njeri i shkollum me dy vjet të fakultetit”. Thashë, “Si mos me hy?” Atëherë u murr parasysh që unë ta vizitoj se nuk ishte ai prezent me vepra të artit me brezin e ri, ta vizitojmë.

Mora përsipër ta vizitoj dhe ta konsultoj çka ka prej veprave për me shti në monografi. E vizitova, por fatkeqsisht ishte pak pa qef. U çu nga shtrati edhe po m’i tregon çka ka prej veprave, kur e mora vesh arsyen pse ishte. I thashë, “Unë e kom marrë për detyrë që juve me ju rreshtu në Monografinë e Kosovës si nisëmtar i parë i artit pamor të pikturës në Kosovë”. Tha, “Shumë faleminerës, Fatmir”, thashë, “Nuk muj me anashkalu artin pamor pa qenë aty Shahin Kryeziu, ju keni dhonë shumë në skenografinë, keni bo shumë si skenograf në Teatrin e Gjakovës, keni bo shumë sa keni mujt prej anës pedagogjike, keni bo shumë vepra sa keni mujt, sa s’keni qenë të kuptushëm në atë kohë me vepru, sa ka qenë e mundun mu zhvillu edhe e kuptushme arti mu ekspozu”. Ku m’u ekspozu aty? Kush me kuptu artin aty? Kush me ta hap ekspozitën, se s’kanë ditë çka o ekspozita. Pse me pikturu unë? Për çka me pikturu unë? S’e ka motivu.

Kështu që, ka qenë i tërhekun ai dhe kështu që veprat çka i ka bo, do peisazhe të Rugovës, do motive nga Peja, do figura kështu nga rrafshi i Dukagjinit, ato ka qenë me vetë-iniciativë, vetëm për ta pasë një person që e ka pasë për zemër që e ka pikturu ose ndonjë motiv, kurgjo tjetër. Por, motiv për të ekspozu nuk ka pasë, s’ka pasë ku. Kështu që, unë, falë asaj kërkese sot është në Monografinë e Kosovës dhe këtu kur e krym krejt këtë bisedë, pimë kafe tha “Fatmir”, si sot po më kujtohet kjo thanje me za gjithë të shterrun, “Ksi here ki ardh me punë, rradhës tjetër do të vish me nejt” dojke me thonë

² Anëtar i çetave dhe i njërive të tjera që morën pjesë në luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve të vendit.

edhe t'i evokojmë se edhe si skenograf i kom ndihmu në skenografi kur i bojshim ato [shfaqjen me] Kësulkuqen, shtëpinë e Kësulkuqes m'pat shti me vizatu atë derën e Kësulkuqes, ato drrasat me ato vijat e drunit të vjetër me ia bo. Më pati shti me ia bo ashtu, ato shpia me dërrasa, kasolla e gjyshes m'pati shti me ia bo.

Erëmirë Krasniqi: Në shfaqjet e shkollës...

Fatmir Krypa: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Për këto shfaqjet e shkollës?

Fatmir Krypa: Unë isha... shfaqja e anëtarëve të Teatrit të Fëmijëve të Gjakovës, e kom fjalën kur thashë parëz, aty isha edhe si aktor. Shahini m'pat shti me i përly dur të kështu në skenografi edhe t'i evokojmë... dhe unë kështu si i ri isha plot edhe obligime... qe sot kur m'bike në mend thojsha, qe sot ta vizitoj, qe nesër ta vizitoj, qe pasnesër ta vizitoj, qe pasnesër ta vizitoj. Kur një ditë ndëgjoj se nuk është mo dhe aq u pendova, aq u pikëllova që mo nuk pata rast atë bisedë me zhvillu, që m'tha, "Ta zhvillojmë një bisedë se ksi herë ki ardh me detyrë, me punë e ta evokojmë pakëz", kish dëshirë se mo nuk ishim profesor-nxanës por ishim si kolegë ma i vjetër, ma i ri. Dhe të bisedonim për artin për kohën që kemi qenë bashkë në shkollë, i ndihmojsha në klasën e tetë me nxanësa si kurse më pati shti me mësu me vizatu.

Erëmirë Krasniqi: Ai ka qenë i Shqipnisë që ka ardhë gjatë kohës së Shqipnisë së Madhe, Italisë, a i vendit?

Fatmir Krypa: Jo jo, ka qenë i vendit, po po.

Erëmirë Krasniqi: A kanë ftu të Kosovës m'u eduku në Itali?

Fatmir Krypa: Jo, jo, ai ka shku mu shkollu në Itali, por ndërkohë ka ardh sikur vijnë në pushime dhe ndërkohë ka kris Lufta e dytë Botnore, se befas Lufta e Dytë Botnore ka kris në Itali kur i ka msy Gjermania Italisë dhe prej atyhit mandej ka marrë Evropën. Kështu që atëherë mbeti pa e vazhdu shkollimin dhe me atë shkollim ka dhonë sa ka dhonë kontribut. Dhe mu, masi që po kthehemi në klasën e tetë, tash është me rëndsi zhvillimi i matutjeshëm. Në klasën e tetë pata arrit me profesorin Shahin shumë gjana t'i trajtoj ma drejt për së drejtiti me të, dhe unë përveç që bojsha punime të shkollës, unë kom vizatu se tash që e pata punu portretin e Skendërbeut, portretet e atyne kryetarëve të republikave atëherë. Unë e fitova nifarë, si me thonë, përvoje edhe dëshirë edhe përvojë të vizatoj portrete edhe ku me marrë portrete me vizatu ashtu, vizatojsha edhe palidhje, s'ishte interesant, po të vizatoj portrete të artistave.

Ali Podrimjen e kom pasë shok, e kom pasë në lagje një dyqind metra ma poshtë se shpia jeme banonte. Ai binte nga shpia ime për me shku në shpinë e vet, dilte për me dal në qytet ka shpia ime. Ai derën time duhej ta kalonte ma së paku dy herë në ditë, dhe Ali Podrimja kishe punëtorë që shpërndajshin filmin në kinemanë "Hysni Zajmi" në Gjakovë. Ata kishin një repertor të çdo filmi që

vinte në gjuhën serbo-kroate, vinte i përkthym prej anglishtes, frengjishtes, vinte në gjuhën serbo-kroate. Kush e dinte e dinte, shumica e dishin, po na prej fëmive ma pak e dishim, por qytetarët e dishin gjuhën serbo-kroate, dhe ai vinte i përkthym në këtë faqe, dy fletë. Faqen e parë titulli i filmit, artisti kryesorë që e lunte rolin ose artistja kryesor ose artisti kryesor ose qe te dytë, dhe mrenda ishin disa skena nga filmi dhe faqja e fundit ishte në mënyrë koncize përmbajtja e filmit, që tash ti ku da dishe frengjishten, ku ta dishe anglishten, ku ta dishe gjermanisht, a din. Po ti e shiqojshe filmin edhe sipas ngjarjes kuptojshe filmin, e komentojshe ashtu.

Alia qato përmbajtjet që vishin me qindna i merrte prej njërit pr ej tyne që e njipte edhe i shiste. Ai i mirrte, ai pronari që ia jepke i filmit e merrte një pjesë, Alisë ja jepte edhe një pjesë që pe shet. Unë kisha pare se qepsha në dyqan te baba dhe ja rrespektojsha rregullat shkollë, teatër, shtëpi, nuk kom teatër, dyqan, detyrat, në shkollë, çdo gja në rregull. Kur shkojke në mbledhje te prindjërve *okay* [eng. në rregull], çdo gja në rregull, po dhe knaqësi unë kur t'i lypsha ndonjë lek, ndonjë dinar atëherë ishin, i lypsha për mos me bo veten fort të mërzitshëm, “Dy dinarë” i thojsha babës. Ai kurr nuk mi jepte dy dinarë, por pesë. Edhe unë ato dyshin e hargjojsha, treshin e rujsja. Dhe kështu, çka të boj unë me ato treshin, unë blejsja përmbajtje nga Ali Podrimja. Ai kishtë përmbajtje, përmbajtje, përmbajtje mbledhte, të çdo filmi, çdo filmi dhe unë kisha bo një koleksion atëherë nuk ishte i vogël, nja 370-80 përmbajtjesh. Isha prej atyre që kisha koleksion ma së shumti prej këtyre përmbajtjeve. Aliu vinte, “A e ki këtë përmbajtje?” I thojshin serbisht *Sadržaj* [Përmbajtje]. “A e ki?” Thojsha, “E kom. Ami dy copa”. E ndërrojsha me njo që s’e kom, e kështu bojshim ndrrim tani.

Unë këto përmbajtje, tash kur e zuna në gojë këtë, i shfrytëzojsja për m’i vizatu artistat. Mos ta vizatoj një njeri palidhje, ku me pasë fotografinë me fotografu dikend, jo. E merrsha fotografinë e përmbajtjes edhe e bojsha vizatimin. Atë vizatim nuk ishte aq me rëndësi, unë ia tregojsja Shahinit se u bo edhe e mërzitshme ajo, secili ishte ma interesant, po unë vetëknajqesha. M’kujtohet një femër një film u konë “Bagdadski Prosjak”, Lypësi i Bagdadit, kështu u konë. Një femën ka pasë me një shami, e bukur ka qenë, me një shami më asoconte në tebdilet e Gjakovës, por ishte me një shami të bukur edhe femër e bukur edhe e pata vizatu ato jashtëzakonisht bukur. Të tjerat më interesojsjin artistat që i adhurojsja, jo palidhje. Kirk Dagslasin, e vizatojsja gati përmendësh, Burt Lancasterin³ e vizatojsja me ato vetlla {tërheq vetullat me duar} përmendësh.

Erëmirë Krasniqi: A i shtojshit ju në ato përmbajtjet, a qysh i rujshtit?

Fatmir Krypa: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Këto portretet a i shtojshit mandej...

Fatmir Krypa: Jo, jo, unë në fletë të bllokut numër pesë, në fletë të bllokut numër pesë, jo m’i bo unë sa përmbajtja, përmbajtja ishte A5, unë e bojsha në flëtë të bllokut numër pesë, ma të mdhaja edhe ato i pata deponu, i pata bo një numër të vizatimesh bukur shumë të mëdha dhe ato vizatime i

³ Burton Stephen Lancaster (1913-1994) ishte një aktor dhe producent amerikan. Fillimisht i njohur për të luajtur “Djem të ashpër” me role më komplekse gjatë një karriere 45-vjeçare në film dhe, më vonë, televizion.

shërbeva, i shfrytëzova për me konkuru në Shkollë të Artit. Mora një informatë çka ka në Shkollë të Artit, kur shkova atje, thanë “Duhet me vizatu”, shkova atje. Niherë ma s’pari kisha një problem, djali ma i madh prej gjashtë fëmijëve, baba punonte me njerëz të huaj në dyqan. Unë si ma i madhi me i dal prej dorës m’vinte keq, me shku diku në Pejë, Pejë punë e madhe, por m’bonte një orë, një orë e gjys me shku autobusi nëpër rrugë me gropa, një orë e njëzet minuta bonte, aq sa bon sot Prishtinë-Gjakovë autobusi.

Si thashë, unë me shku atje pa e pyt babën dhe ma s’pari, e kisha një ilake në shkollë ku punojsha, ku mësojsha në shkollën “Voja Lakičević”, dhe i thom “Sali Ballata, a mundesh m’i thonë ti babës se Fatmiri po ka dëshirë me shku në Shkollë të Artit, se profesori Shahin po i thotë, drejtorja e shkollës i ka thonë...” Se neve na mbledhën ditën e fundit të shkollës, të gjithë ata tri klasët që e krym klasën e tetë, në orën katër pasdite na thirri drejtori me arsimtarët kujdestarë dhe arsimtarët kyç të landëve në një mbledhje masdite. “Ti ke prirje për matematikë, duhesh me shku këtu, këtu. Ti ki prirje për këtë, me kështu këtu këtu. Ti ki prirje për vizatim, me shku në Shkollë të Artit. Ti ki prirje për muzikë, me shku në shkollë të muzikës në Prizren. Ti me shku në Pejë”, kështu do farë udhëzimesh edhe mu m’kishin thonë me shku gjithsesi në Pejë.

E tash ku me marrë unë gjithë atë guxim m’i thonë babës, edhe jo që s’kisha guxim, por edhe vet ndërgjegja edhe ndërgjegjen, m’vriste ndërgjegja si me lonë unë atë vetëm me pri ma s’pari, e të tjerët mandej, ku me punu me punëtorë të huaj ishte shumë keq. Ai shkonte ka ni javë ditë në udhëtime që thojsha, ni javë ditë ishte larg dyqanit e t’iu linte dyqanin... mundesh me marrë me mend në durë të huja çka mund të ndodhë. Edhe unë i thom këtij Sali Ballatës, e kishim *akraba* [kushëri] si thonë turqisht, e kishim në afërsi familjare. Them, “Si ti them unë babës?” “Hiç mos ki merak ti se do t’i them unë”. Thom, “Faleminderes me bo këtë shërbim”.

Ni ditë, unë dilsha në dyqan vazhdimisht ni herë në ditë, bon vaki dy ditë nuk dilsha ni ditë dilsha, ni orë, dy orë ashtu. Ai ka dalë, se mësues ishte në atë shkollë, ka dalë prej punës dhe ka kthy edhe ai në dyqanin e babës të vet edhe se i kishim dyqanet ballë për ballë. Më vëren se po dal prej dyqanit edhe del dhe m’thërret, “Fatmir, eja këtu!” Shkoj unë dhe i afrohem, thom “Çka ka të re?” Tha, “Kom folë me bacën Halil”.

Erëmirë Krasniqi: Baba juj?

Fatmir Krypa: “Kom folë...” po, “Kom folë me bacën Halil për punën tone”, thashë “E çka të tha?” Tha, “Njëherë ishte kureshtar me ditë, po më thotë ‘E more Sali, po kur ta krym ky djali çka bohët?’” Se s’kishte ndonjë shembull, nuk ishte ndonjë dikush që e ka kry Shkollën e Artit hala. Muslim Mulliqi që ishte përpara, ishte sa e ka pasë regjistru Fakultetin e Arteve në Beograd, Tahir Emra ishte në vitin e tretë, Esat Meka ishte në vitin e dytë që ishin... si gjakovar ishin në Shkollë të Artit, por të krym dikush nuk kishte që me thonë, “Qe qiky qeshtu u bo”. “Baca Halil bohet arsimtar i vizatimit, hiç mos e ki merak”, “Sali ti e din, ani de ani, le të shkojnë”. Dhe unë e mora guximin dhe nuk e pyta vetëm i kom thonë, “Babë kishte provim pranues”, tash unë me marr kto sikur i kom thonë unë, a i ka thonë dikush tjetër. Po i thom, “Kishte provim pranues në Shkollë të Artit ni javë ditë. Po u duhke me shku të shtunën me gjetë një shpi me qera”. Edhe një shok e kisha prej Gjakovës, por ai ngeli, nuk mujt me

kalu edhe e gjetëm në Kale... tash majdan, aty i thonë. Edhe ni javë ditë e murrëm atë shpi, pagujtëm tash nuk m'kujtohet sa dinarë n'mramje edhe një javë ditë qëndrum aty. Dhamë për çdo ditë vizatim, vizatim.

Erëmirë Krasniqi: Krejt javën kishit?

Fatmir Krypa: Krejt javën edhe ditën e fundit e kishim një ditë hartim serbisht. Serbishten nuk e dijsim ne prej Gjakovës, rrallë kush e dike serbishten, shumë vështir, se edhe serbi që ishte një rrugicë ata flisnin shqip shumë bukur. Flisnin shqip për mrekulli, nuk tentonte ai me përdorë gjuhën serbo-kroate, jo, shqip fliste. Tash ishte një problem qysh me shkru atë hartim, por unë s'e di si më erdh ajo, ai guxim dhe tema ishte: "Një ngjarje nga jeta juaj", serbisht "*Jedan doživljaj u tvom životu*" [Një përjetim në jetën tënde]. Kur ja nisi me shkru unë, çka me shkru? M'kishte vdekë gjyshja para dy vjete edhe unë, e donim shumë atë gjyshe, tejmase, dhe ajo dhembshuri akoma ishte te unë. Çka me shkru s'disha tjetër, e shkruj dhembshurinë e gjyshës që kisha, që s'e kisha mo.

Po i boj sot pyetje vetiti thojsha, "Po mirë mor burrë, ti që s'pe din gjuhën serbishte, pse s'ki shkrujt pak bile? Shkruj pak", se na dhanë nga një dy-fletësh të atyne fletoreve të mdhaja. Unë një faqe e gjysë e lshova me shkrujt gjysën shqip, gjysën serbisht, dhe aty një shovenist serb që jepke gjuhën serbishte, përtej mase ai shkyhet prej gazit tu e lexu atë hartim. Nga ana tjetër arsimtarët që i kanë kqyr vizatimet kanë propozu mu që vitin e dytë, në gjysëmvjetorin e dytë me kalu në vitin e dytë sikur Muslim Mulliqi edhe atë e kishin avancu. Unë këto s'e kom ditë. Një profesor që jepke vizatimin vitin e tretë fillum të shqroheshim me të se bojsha dekorimin e Vitit të Ri së bashku e bojshim, shkrujshim parolla e pllakata s'bashku. Dyrte nëpër kamione, se erdh ligji secila firmë me pasë të shkru me në derë të kamionit cila firmë është, e cilës firmë është ky kamion, me shkru serbisht edhe shqip.

Na punojshim s'bashku me atë profesorin e vizatimit dhe një ditë në bisedë e sipër, kishte besim shumë te unë, se besimi dukej te unë edhe në fizikus edhe në punë praktike sa që një ditë po më thotë, "Shko te vida në shpi, këtu nër dollap, nër çarshaf merri qikaq pare", mu po m'thotë si nrxanës shko në dollap, nër çarshaf merri kaq para se i vyjshin dhe kishte besim. Na bisedojshim për shumë gjana dhe kisha ndërgju unë pak a shumë diçka, kisha ndërgju po deshta me ditë ma kontretisht prej tij thashë, "Profesor Kamenović",⁴ thashë, "kom me ju pyt diçka." tha "Urno Krypa!" Thashë, "Unë e di që e kom bo një gaf të madh, një gabim kur e kom shkru hartimin, e kom bo llom, kom shkru s'di as vet. Kom dëshirë, e kisha pagu me pare me ble atë hartim me pa çka kom shkru, e kisha rujt për kureshtje me pa çka kom shkru".

Ata m'kanë propozu për me më avancu në shkallë të dytë. Thotë "Kush? Ju po doni me propozu ato për me avancu në shkallë të dytë? Por shiqoni çfarë hartimi ka bo". Edhe ata bijnë poshtë. Tha, "Kur na ka tregu Brane Nikić hartimin, na kemi thonë ma mirë ky me ndejt rregullisht edhe këtu me mësu gjuhën, gjuhën me mësu edhe normal talentin e ka edhe e tregon. Aty, kjo ka qenë motivi që ty nuk të kemi avancu ne vitin e dytë". Dhe kjo më dha mu një kurojo që mandej unë e pasna një talent dhe unë po e boj punën ma shlrshëm, ma shlrshëm dhe ashtu...

⁴ Svetozar Kamenović

Erëmirë Krasniqi: Çfare ishin profesorat? Çfarë profili? Prej kahit vishin? Çfare ishin studentat?

Fatmir Krypa: Profesorat kanë qenë nga Serbia, nuk ka pasë profesor që ka dalë se ne ishim ata të parët që po dalim, Muslimi ishte thashë në vitin e parë të studimeve, Tahirin unë prej vitit të tretë kur shkova në vitin e katërt. Mandej edhe të tjerët ma vonë kështu e kryen, nuk kishte. Kryesisht ishin profesorat nga Serbia, nga Mali i Zi dhe si për korrektësi të profesorat praktik nuk kena vrejt shumë injorancë, jo, jo injorancë se në art të bonte për vete. Unë për shembull e kom bo për vete profesorin Svetozar Kamenović, ai, qe shoqja [Hyrije Krypa] dy vjet ka qenë ma e re, kur e kom kry kjo ka qenë në vitin e tretë edhe unë isha në Beograd student kur po më shkrun letër. Tha, “Po të lavdon profesori Kamenović, po thotë se ka qenë një nxanës këtu, quhej Fatmir Kripa, çfarë vizatime bonte ai, po të lavdon në klasë”.

Domethonë, kanë qenë, se arti të bon për vete, e bon ti me punën e bon për vete. Mirëpo, si të thom, ajo gjithmonë nuk kemi ditë sa na urrenin, nuk kemi ditë fatbardhësisht sa na urrenin serbët. Kur kom shku në Pejë, unë gjuhën e kom mësu për një gjysëmvetor, për një gjysëmvetor e kom fol perfekt serbishten. Mas vitit të parë kom qenë i barabartë me të tjerët se edhe ata të Pejës folshin një gjuhë. Fjalorin, në fjalorin e tyne ishin një mori fjalë serbishte të inkorporume. Kur thojshin, “Çka po zemrohesh,” thojke, “Çka po bonitësh?” ose “Çka p’e rrit mendjen?” “Çka po pravitesh?” “Kuh çka po plivatke” për çka po notojke.

Unë kur isha në gjysëmvetor të parë nuk i kuptojsha as vetë fjalorin, ishte një botë krejt tjetër prej Gjakovës. Nuk e kuptoja as shqiptarin, kolegun e klasës nuk e kuptoja. Se ne si klasë kishim njëzetë nxanësa, njëzetë nxanësa. Prej njëzetë nxanësave e vrejta në fotografi kishim qenë pesë maksimumi atë vit që i kanë pranë shqiptarë, do të thotë prej njëzetëve, pesë shqiptarë. Në popullatën sa ishin shqiptarë, sa ishin serbë ishte një diskriminim, por megjithatë viti kur ishim pranë pesë shqiptarë ishte viti kur ma s’ shumti kishin pasë shqiptarë. Dhe kështu që me atë numër, gati që ka përfundë me atë normativë i të pranumit të atyne nxansave.

Erëmirë Krasniqi: Çka pikturojshin? A ju qitshin natyra të qeta a...

Fatmir Krypa: Detyrat kanë qenë të shkollës, punonim simbas modelit, gjipsit, ishte detyra ma ekzakta që une e vizatoja prej atyre përmbajtjeve atëherë prej letrës. Tani vinte modeli prej gjipsit para nesh në formë natyrale, sa është madhësia e kokës natyrale, figura të lashta antike vijshin edhe mandej fillonte portreti i gjallë, në vitin e dytë portreti i gjallë. Vinte ndonjë model, aty qëndronte një javë ditë deri sa ta vizatojshim, një javë ditë, por nga pesë orë në ditë. Kishim tri ditë në javë, katër ditë vizatim. Ai gjatë asaj jave bojshim tri ditë ka pesë orë, 15 orë vizatim. Dhe pjesa tjetër ishte pikturë në natyrë, pikturë sipas natyrës së qetë që bonim në klasë dhe detyra sipas imagjinatës që jepshin tema të ndryshme edhe simbas imagjinatës, por kryesisht kanë qenë ato simbas modelit.

Aty mundej syni të ekzaminojë saktësisht çka po sheh përball teje, si duket një buzë e çame, pak e fryme, pjerrtaz e gjonë e ngreme ose e tkurrme, ka mollëza, sa i ka të qitme, krejt ti ato i monitorojshe, me aparatën, me syrin aparatën ma të përpiktë. Kur te arritshe këtë ti ishte me notë ma të lartë, se i

përngjante aq sa i përngjante modeli vizatimit ose vizatimi modelit ishte nota ma e lartë, se saktësisa, ti nuk kishe nevojë kush është cili model është edhe saktësisht majshe me dallu edhe si amater edhe si profesionalist se cili model është edhe a ia ka qëllu karakterin apo jo.

Kështu që, aty vlerësohej nga ana e profesorave me nota valide, me notë ma të naltë. Dhe ne, Shkolla e Artit në Pejë kemi qenë në Jugosllavi, kemi qenë shkolla ma e mirë prej shkollës që ekzistonin, e Lublanës, Zagrebit, Beogradit, Nishi, Novi Sadi, Shkupit, prej Malit të Zi, Mali i Zi ne jse nuk ka pasë Akademi, Shkupi nuk ka pasë, Prishtina nuk ka pasë. Prej shkollave të mesme që kanë pasë, Nishi edhe Novi Sadi prej krejt republikat kanë pasë, e Serbia i ka pasë tri njo në Beograd, njo në Sarajevë, Novi Sad edhe njo në Nish, tri i ka pasë Serbia se ka qenë edhe e madhe. Shkolla e Artit në Pejë ka qenë njona prej shkollave ma të mira në atë grup të shkollave të mesme. Kur shkojshim ne në Beograd pytshin në provim pranues, “Prej cilës shkollë vjen? Prej cilës shkollë të artit vjen?” “Nga Peja”. “*Pečka škola*”. Thojshin Shkolla e Pejës, edhe ishte një burim, por Beogradi ka qenë shumë rigoroz.

Pjesa e Tretë

Erëmirë Krasniqi: Zoti Krypa qysh, a e dishit prej fillimit që keni me vazhdu arsimimin e ju në Beograd? A ishte diçka si pjesë e kulturës e shkollës së mesme me ju pergatit për fakultet?

Fatmir Krypa: Po, meqenëse disa kolegë paraprakisht ishin në Beograd, ishte Muslim Mulliqi edhe Rexhep Ferri, Tahir Emra. Atëherë nevojat në Kosovë ishin të mëdha edhe duhej që ato t’i përmbyllnim të gjithë, nuk mjaftonte më një, dy, tre. Kështu që, ma merrke mendja se do të ketë edhe për mu dikund vend dhe do të isha edhe unë i nevojshëm për artin e Kosovës nesër. Vendosa dhe arrita një kënaqësi në punën time gjatë shkollimit të mesëm, me preferencat e kolegëve që kisha ma të vjetër, prej profesorave që jepshin mendim të mirë për mu dhe prej asaj vet-dëshire që ta arrijë edhe një nivel ma të lartë të dijës, se dija në art nuk është kurr e arritne deri këtu është, ta përsosi sa është e mundur me këtë shkollim. Por, prapë ishte një dilemë, si unë prapë tash nuk jam ai që do t’i ndihmoj prindit, kthehesha prapë me mendimin te prindi, si tash unë ta kërkoj në vend se të bëhem ndonjë arsimtar në shkollë, t’i ndihmoj prindit, t’i shkolloj vllazërit, motrat edhe t’ja heki një barrë prindit.

“Jo”, baba më thotë vazhdo me studime dhe ajo është, do të thotë një sakrificë shumë e madhe, do të sakrifikoj. Ai ka pasë një kënaqësi në jetë me ndi edhe tek vetvetja edhe te atë që do ta ketë brez të ardhshëm. E pata nuhatë atëherë, kishte një shoqëri të gjithanëshëm, se ka qenë edhe futbolleri i parë në ekipin “Vllaznimi” të Gjakovës. Aty ka pasë fillu ekipi i parë me të, mbrojtës i djathtë, i kom fotografitë. Në oborrin e shtëpisë time janë mbledh mandej kanë shku janë mbledh në fushë të sportit. Kështu që, ka pasë një gjithanëshmëri, kish qef këto gjana me i... dhe aty nuk ka hezitu fare me më thonë se, “Shiko unë të shkollova pesë vjet në shkollë të artit edhe tash e kreve. Eja hi në punë ma ngjet dorën diçka”. Mirëpo, ai ishte i mendimit që unë të vazhdoj ma tutje.

Dhe unë, me këtë kisha një potencë, përveç ato që kisha absorbu nga ana praktike e punës edhe potencë që ta ndihmoj dhe t’i jap edhe dashuri prindit edhe kuptohet edhe shoqërisë nesër. Kto nuk e kisha mendu, shoqërisë nuk isha në gjendje edhe nuk ishim në gjendje që ta mendonim që do t’i

kontribojmë shoqërisë, larg asaj, që do të jemi ne që do t'i kontribojmë shoqërisë. Do t'i kontribojmë diçka për të mira materiale, që sot të mirat materiale janë sekondare aq sa primarja është me bo një ekspozitë jashtë, me mu vlerësu mirë si kosovar, si shqiptar nga Kosova. Kështu që, atëherë u vendosa patjetër me shku në Beograd edhe me vazhdu studimet. Ishte situata pas ramjes së Raković⁵.

Erëmirë Krasniqi: Në '66-tat?

Fatmir Krypa: Ishin vitet kur, jo '63 edhe unë kisha një botëkuptim që do të kem probleme në Beograd kur të shkoj, isha përgatitë për probleme. Po mirë, ato dilnin e humbshin edhe isha fokusu në punën ekzakte me artin që do ta zhvilloj në fakultet. Nuk droja në bisedat me atë çka ndodheshin rreth meje. Në praninë të vitit të parë ndodhi një befasi. Aty një kolegë që jepke provimin pranus në Beograd ishte pranë meje, pra kishim shtafellajat sikur ky {bën me gisht nga shtafellaji prapa} dhe vizatojshim një model te gjallë deri këtu {prek gjunjët}, poziciononte kësi soji dhe e ne e vizatonim.

Ai ishte nga krahu i djathë i imi, më një *mašne* [srb.: fjongë], i veshun me pantolla të hekurosme, këpucat mundeshe lirisht mi kre flokt me i pa pasqyrë, ishte nga Beogradi po. Unë i rëndomtë, një djalosh nga Kosova, modest i veshun, po jo në atë gjendje. Prindi kishte kujdes edhe në veshmbathje dhe të gjitha ato, po unë vet i kërkoja jo të nivelit të lartë, por të nivelit, gjithmonë kisha parasyshtë se nuk ishin lekët e mia, po ato që duhet ta kurseja edhe prindin, një veshje normale.

Vizatova modelin, vizatonte edhe ky i Beogradit. Unë e vizatova shpejt, kisha përvojë, ai ishte me një shkollë, kurs dy-vjeçarë si shkollë e lartë ishte ajo i thojshin “*Šumatovačka škola*”. Një shkollë e mesme dy vjeçare e lartë, si shkollë e mesme dy-vjeçare. Edhe unë dal në pushim në provim pranus, dalim të gjithë në pushim dhe kthehem. Në kandin e djathë na tha profesori shënoni emrin t'ju di se kush jeni dhe si po vizatoni, të ju njof. Edhe unë e shkruva emrin Fatmir Kripa ta dinë se ata e lexojshin “u”, Krupa edhe unë e shkruva ashtu e kom diplomu me Kripa.

Kur kthehem e shoh përfundi emrit të vizatume një sharrë, sharrë asi të gjatë që sharragjitë sharrojnë dru, të dorës, një sharrë të dorës të madhe. E shoh e kish vizatu përfundit emrin sharrën edhe unë i thom, “Darko”, thashë, “Kush e ka vizatu kto? A mos e ki pa?” Ai më kthehet, “Pse?” Thom, “Qysh more pse, sharrën, çka është kjo?” (qesh) Tha, “Kjo është simboli yt” “*Zaštitni znak*. Emblema jote”. Njeherë s'e kuptoja, *Zaštitni znak*, çka është serbisht? E kisha kuptu por nuk e kishim bo në shkollë të mesme këto gjana edhe s'e dija çka është, por më dukej se nuk është një shenjë e mirë. “Por është një amblemë e jotja, sharraxhi. Çka po don ti artin, sharraxhi?” Tha, “Unë ta kom vizatu”. Edhe unë e fshiva edhe mandej si me hi në fjalë me të në provim pranus, me hi në fjalë me to, nejtë. U kry provimi pranus, ai kishte kalu, po kishte kalu shkallën e parë, kishte kalu po shkallën e parë edhe tash unë e përcjella, ai kishte drejtimin e pikturës, vinte edhe nuk vinte.

Erëmirë Krasniqi: Ju a u përcaktut për pikturë?

⁵ Aleksandar Ranković ishte një politikan jugosllav, që konsiderohej si njeriu i tretë më i fuqishëm në Jugosllavi pas Josip Broz Tito dhe Edvard Kardelj. Midis 1945-1966, Ranković mbështeti kontrollin e pakicave serbe të Kosovës kryesisht të banuar me shqiptarë përmes politikave shtypëse antishqiptare nga policia sekrete. Në Kosovë, periudha 1947-1966 njihet kolektivisht si “Epoka e Ranković”.

Fatmir Krypa: A jo pardon, jo jo paska qenë një shok tjetër që paska kalu, ky Darku paska ra në provim. Po vjen dita e hane kur e merrshim rezultatin, do të thotë punum deri të shtunen një javë ditë edhe atje, pesë ditë, katër ditë, e hane, e marte, e mërkure, e ejte, e premte, pesë ditë. Të hanën e merrshim, se në orën tetë në mëngjes do të del rezultati. Unë shkoj në orën 8:30 prej kureshtjes sa më shpejtë me pa rezultatin. Kur e shof listat ishin dalë, ishin shumë vetë dhe *rag, rag, rag* {onomatope} e gjoj Fatmir Kripa, u bo. Tash e lypi unë Darko Glišić *dak dak dak dak* {onomatope} nuk ka, kqyri në listën tjetër Darko Glišić *dik, dik, dik* {onomatope}, s'ka! Kqyri te tjetra Darko Glišić, nuk ka. Thashë, "Ah që nuk e kom atë idiot me pa me sy, atë prepotent, atë shovenist".

Edhe tash unë me plot optimizëm, me plot gaz po shkoj, po ngjitem, po dal prej Fakultetit. Nja 50 metra, jo nja 30 metra aty prej Fakultetit është një kafe, kafiteri kafe ku Branislav Nušić⁶, Dositej Obradović⁷, kta shkrimtarët serbë aty janë vendosë, janë ulë, kanë bisedu, kane shkru, kanë meditu, aty i kanë gjetë ftymëzimet me njerëzit dhe e kanë rujt asi soji çfare ka qenë para 200 e sa vjete, ashtu 300 vjete, e kanë rujt ashtu. Sot e ki në Beograd, e kom kqyr një ditë është maru ndërtesa dhjetëkatëshe, ajo ka ngelë e tillë. Sa herë kom shku, deri para luftës kom shku e kom vizitu edhe tash e pash në internet ishte ashtu, ishte ndërto një ndërtesë shumëkatëshe, ajo ishte ashtu me atë ngjyrë.

Po dalim, ky Darko me nja tre, katër shokë kishin çu ka, se a do të kalojmë a s'do të kalojmë, kishin kështu i kishin çu ka një gotë, a dy, a tri, ishin trimu t'u qesh *ha-ha-ha, hi-hi-hi* njëni me tjetrin. Kur po e shof, qe Darko, thashë, "Uh, sa mirë, sa mirë". Po nij ata edhe unë po ngjitem përpjetë, ata po vijne me shiqu rezultatin edhe unë, po vjen aty afër nja shtatë a tetë metra edhe po ja boj me zo të lartë, "Darko, ki kalu", po serbisht atje, ai thotë, "Me të vërtetë?" Me buzgaz po vjen me më përçaf.

Këta jonë dyfyrsha, kish haru ai çka m'ka thonë mua fare. Po vjen me më përçaf a din si faliminderit edhe tu nga me më përçaf edhe unë, "*Položio si...*" ia boj banale në serbisht, banale një fjalë ia lshoj thashë, thashë, "Atë sharrë", thashë, "që ma ki vizatu mu, shko merre edhe dil e sharro dru, se të presin Beogradi ty me sharru, a unë do të shkoj me studiu". Thashë, "Do të studioj që ditën e hane do të regjistrohëm. E ti", thashë, "shko merre atë sharrën". Mo kurrë s'e kom pa në Beograd, pesë vjet kom qëndru kurr s'e kom pa në Beograd.

Erëmirë Krasniqi: Kjo a ishte hera e parë për juve në Beograd, që dilshit prej një qyteti të vogël?

Fatmir Krypa: Po, po, tash ishte, po na kishim qenë në ekskurzion, nja dy herë kemi qenë në ekskurzion. Kom pasë njohuri, muzetë, galeritë, muzeun e kem pasë vizitu Kalemegdan-in⁸, qytetin, Terazinë⁹ e dishim, po megjitatë të qëndrojs, t'i shohësh ma për së afërti njerëzit, të bisedosh me ta

⁶ Branislav Nušić (1864-1983) ishte një dramaturg, satirist, eseist, novelist dhe themelues i retorikës moderne në Serbi. Ai gjithashtu ka punuar si gazetar dhe nëpunës civil.

⁷ Dimitrije "Dositej" Obradović (1739- 1811) ishte një shkrimtar, filozof, dramaturg, libretist, serb, përkthyes, gjuhëtar, udhëtar, poliglot dhe ministri i parë i arsimit i Serbisë.

⁸ Parku Kalemegdan ose thjesht Kalemegdan, është parku më i madh dhe një nga monumentet më të rëndësishme historike në Beograd.

⁹ Terazije është sheshi qendror i qytetit dhe lagja përreth e Beogradit, Serbi. Ndodhet në komunën e Stari Grad.

ndryshe është. Ajo ishte një send i hidhur që ndodhi, por fatbardhësisht ishte për mu një udhërrëfim i ri që ndodhi në atë fazë dhe u deshke gjithnji me pasë parasysh se kom edhe darka të tjerë, nuk janë me emër e mbiemër të njëjtë, po ka me pasë të tillë që kom me pasë.

Erëmirë Krasniqi: A ju ndodhi mo diçka e ngjajshme?

Fatmir Krypa: Dhe unë kom qenë me Agim Çavdarbashën të ndjerë kolegun, e kom pasë shok edhe në shkollën e mesme kami qenë aty, e dhamë provimin vetëm na dy se kenë edhe tre prej Kosovës të tjerë dhe ranë. Na dy e dhamë provimin, Agimi nuk mundi me gjetë bursë, nuk kishte mundësi materiale me ardhë dhe vazhdova vetëm unë vitin e parë. Unë shkova në vitin e dytë, Agimi tek atëherë kishte ardhë në vitin e parë, kishte gjetë bursë. Kështu që, unë vazhdova i vetëm në gjeneratë. Në gjeneratë ka një ishin, në gjeneratë ishte vetëm Shyqri Nimani, në gjeneratë ishte vetëm Rexhep Ferri, në gjeneratë ishte vetëm Agim Çavdarbasha, qeshtu ishin ka një. Të thom të vërtetën duhej që të luajsh politikë që atëherë, të bohesh i mirë me profesion, të bohesh i mirë me shoqëri dhe të mos i japësh vetit fort diçka, mos m'u tregu, potencën e artit mos me ju shitë mend se nuk e durojshin, por kur ishte diçka e mirë profesorat ta thojshin.

Më kujtohet vitin e parë profesori kishin landën Elemente dhe ishte ba një muj ditë profesori që na notonte javë për javë na kishte thonë, “Çdo detyrë do t’ju notoj” edhe ne ato detyra për çdo fillim orës ia tregojshim edhe ai i notonte dhe nuk na tregonte niherë, në fund të mujit kur u bo një muj ditë tha, “Ju komunikoj rezultatet e mujit të parë gjithësecilit prej javës së parë deri sot e fundit po t’iu tregoj notat, katër nota. Filan Fisteku notën gjashtë, shtatë deri në dhjetë kuptohet, pesë eventualisht.” Dhe tash unë më kapi një e dridhme thojsha, “Dreqi e honktë tash ku s’na tregojke javë për javë bile njeri mësohet”. Tash i shiqojsh kolegët, keleget afër meje, a din, tash kishim fillu një muj ditë, pak a shumë njifeshim prej kahit, a si, a naj kompliment, a naj punë e mirë edhe tash u munojshe tash ti të bohesh me punë i mirë që t’i bishe në sy, se a ishe i bukur ti a s’ishe i bukur, Beogradi i madh ishte, po.

Kur po thotë, “Kripa Fatmir”, me ‘i’ a din, mandej po më thotë, “Pse?” Tha “Kripa ti? Pse nuk e thu qysh e ki mbiemrin?” Se kishte studiu në Francë Akademinë edhe ishte gdhendë, ishte kogja, bukur kishte arrit nifarë qytetërimi, nuk ishte sikur disa profesora që ishin ma ndryshe. Ai kishtë një diapazon edhe kishte një kulturë, një bisedë, një korrespondencë me studentin ma në nivel të qytetërimit edhe ato profesionale po se po që e kishte si landë. Tha, “Si e ki, si quhesh? Cili është mbiemri juj i plotë?” Tash po i tregoj, “Fatmir Krypa, por sikur ta shënoj, ta shkruj”, thashë, “me ‘y’, ju do të ma lexoni ‘u’, e ‘u-ja’ në gjuhën shpibe është *pogrdna reč* [term derogativ] pak e ndotun, nuk është e mirë”.

Thashë, “Në gjuhën shqipe i thonë edhe krip edhe kryp”, thashë, “nuk prish punë edhe për ashtu edhe për kështu”. Tha, “Në rregull, kjo është çashtja e juj, por të shiqojmë, pyta sa për kureshtje. Të shiqojmë. Ju e keni notën nëntë, e keni notën dhjetë.” E çon kryt, “E keni notën dhjetë edhe e keni notën dhjetë, që do të thotë tri dhjetëshe, një nonshe”. Edhe kërkujt s’ia kishte thonë ato nota deri atëherë. Ishte tu i komunikue notat, kishte hala me i komunikue kolegëve tjerë, s’ishte fundi, s’isha i fundit unë se me a, b, c shkante, tha, “Ti je shtyllë. A e shef atë shtyllë?” Në klasë aty edhe unë p’e kthej krytë p’e shoh edhe po i thom tash vetmeveti çfarë kryeforti a ku me ditë çka po don me më thonë me kto rrotlla a din. Tha, “Ti je sikur ajo shtylla”, e boni një intermeco, “që e manë këtë klasën.”

Atëherë e niva që nuk është puna bash, tha, “Ti je shtylla e kësaj gjenerate gjerë më tani” edhe mu ia nisën si me m’u rritë puplat, ia nisen me më dalë puplat (qesh) menjëherë se s’kishe ndryshe.

Me forcë nuk mund t’i dishe ballë se kishe qasi *majka-janka* në tona anët, e dikush ta bojke me buzagaz, dikush ta bojke me kështu, ti duhesh të ruheshe, të jesh diplomat. Pa qenë diplomat me profesion, por të boheshe njëfarë amateri diplomat edhe t’u msu shkollë për me mujt me ekzistim me një rreth normal. Ti mujshe me çu kokën e me qenë dikushi aty, por kush me të mbrojt, kush me të mbrojt? Ti u duhesh me i ndihmu kolegut, “M’fal se po të ndihmoj diçka” ose me i tregu diçka kur s’e ka mirë, “Hvala” faleminderit ose me i ndihmu praktikisht ose m’i dhonë farë sygjerimi.

Këto ishin që prej teje u pritshin prej një kolegu. Normal fitojshin një dozë, sa do të vogël, simpatie se s’kishe ndryshe. Thoshte Korinti bonu ashtu *gentleman* [eng. Burrë i kujdesshëm] anej e knej, s’bojshe punë, saqë unë u munova pak me kopju një koleg një kohë me i majt flokët, se kisha shumë flok edhe fillova ta boj një prerje të flokit {prek me duar kokën} kështu me të prerë kur fillun, “Ej p’e kopjon”, tha, “Tasën, Tasi që u konë”. Tha “A p’i kopjon, qy Tasa i vogël”, se ai ishte më i vjetër se unë, kishte ardhë me studiu disa vjet, kishte nja dhjetë vjet ma i vjetër sa unë edhe p’i kopjon. Të nesrit unë po e ndrroj frizurën ndryshe. Thashë mos të bi në sy tash, mos ta kopjoj edhe doli thashë të jam unë, gjithqysh me qenë unë thashë.

Ashtu u kry edhe shkolla e parë edhe më një afërsi me kolegët, me profesora. Më kishin thonë kolegët ma të vjetër, “Shiko se, të ndodh diçka, ktu je i monitorum shumë, të vlerësojnë shumë edhe notat t’i qesin të gjithë të regjistrojnë, çdo punim ta notojnë edhe mso tregohu”. Edhe unë ato e kisha marrë si rekomandim që në ditët e para edhe e krewa vitin e dytë me këtë përshtypje.

Erëmirë Krasniqi: Kon e kishit mentor prej profesorëve?

Fatmir Krypa: Jo ata ishin nga Beogradi, ishin profesor të ndryshëm. Secili për landën e vet, secili për landën e vet ishte. Ishin dhjetëra profesora, dhjetë profesora ishin. Erdh provimi pranus për shkallë të dytë. Mu kjo mu gjetë, ky angazhim, me plot forcën dhe filloj. Erdhën tash, përveç që ishim na të Beogradit, të Akademisë të Beogradit erdhën prej shkallës së parë që ishte në Nish, Shkolla e Lartë e Nishit, Shkolla e Lartë e Beogradit, erdhën edhe prej shkollave tjera të larta të Jugosllavisë, erdhën me dhonë provimin pranues. Përveç atyre që ishin, edhe një herë u bo konkurenca më e madhe, a shtatë vetë do të pranoheshin në grafikë, shtatë vetë, a ishim bo mos të them por nja 35-40.

Erëmirë Krasniqi: A është ndodh tani që ju përcaktoheni për, përcaktoheni për grafikë?

Fatmir Krypa: Po, po. Se shkolla e parë ishte e përgjithshme, po. Po mirë, megjithatë e përgjithshme, por kishte një rangim pak sa më të, të një lande, të një landë veç ma tepër msonim grafika. Ashtu kjo m’u gjet dhe m’u duk si përfitova shumë. Pse? Më ndodhi mu një befasi shumë e madhe, se mendojsha tepër për me dhonë provimin pranus, një javë ditë erdha në Beograd të klimatizohem me Beogradin, me atë zhurmë, me atë dinamikë të njerëzve, me gjunën në tona anët andej-këndeje, më hante. Të vishe prej Pejës e Gjakovës, qetësi, një automjet aty kalonte, atje zhurma, dinamika e madhe. Ti u duhesh me prit disa minuta me kalu rrugën në Terazija [rrugë në Beograd].

Erdha me do shokë, ata kishin provime unë thashë, “Po vi me ju, po e marrim një konvikt së bashku” edhe po pres një javë ditë unë po klimatizona po dal, msoni ju, unë s’ju pengoj edhe ashtu vendosa. Prej se e kisha mendu aq shumë nuk e kom vrejt orën në sa do të jetë provimi pranues, se neve na fillojshin ligjeratat në orën nontë gjithnjë, dy vite ligjeratat fillojshin në ora nontë. Pse? Se mëngjesi nuk dilte herët dhe ne vizatojshim me dritën natyrale, duhej të vizatohej me dritë natyrale. Unë atë ditë të provimit edhe kom shku dy ditë përpara, ditën e shtune shkova e bleva letrën me vendos, me zgjedh pozicionin ku unë vizatoj më së miri klasën, pozicioni se është një vend ku konvenon ma së shumti.

Mu m’konvenonte jo frontal, jo edhe një profil, por gjysë profili, gjysë amfas, ashtu kisha punim ma të mirë që mund ta bojsha. Unë me marr letrën dhe shkoj me vu aty, koriri nuk më len. Thom kuririt se m’njifke ai dy vjet isha aty, nuk linte, se e disha klasën ku e mbajmë, ishte emri në klasë ku kisha me dhonë provimin. “Nuk guxoj”, thom të jap lekë, të paguj pare, “Nuk guxoj”, “More”, thashë, “le ti atë punë nuk guxoj, hec qikaq po të jap”. E tregova edhe shumë bukuri të madhe, “S’guxoj”. E morra letrën e ktheva edhe s’guxoj.

Vi unë në ditën e hane pa një qerek, pa nja njëzet, nja njëzet minuta përpara me temën se ajo provimi kishte fillu në orën 8:00. Të gjithë kishin hi, të gjithë kishin vendos punimin edhe unë po kqyri, po nij zhurëm, po thom, “Çka është kjo?” Po nij klasa plot u mbush. Shtafellajin tim e kishin përplas me një qoshe aty, vetëm kto kamzat poshtë që e kishin prek për muri edhe unë s’kisha vend as hunën takohej me tabel, as dorën me zgjat s’më kishin lonë vend. I thom atyne kolegëve, “Shtyju pak koleg, shtyju pak”. Kishin ardhë do prej Nishit nuk më njihshin, kishin ardhë do prej Novi Sadit nuk më njihshin. “Jo, pse je vonu?” Edhe kta të Beogradit më kishin konkurent të fortë, menxi kishin prit me ndodh kjo se më kishin konkurent. Qysh ajo unë e pata fillu me nota të shkëlqyshme edhe e përfundova ashtu. E tash, menxi pritshin me bo naj gaf unë, me ra në provim.

Unë me milimetra ja u barta shtafellajat njonit e tjetrit sa me shti kryt e dorën me zgjat. E vizatoj, kjo është e mundimshme me ndëgju, është e mundimshme për çdo njeri e le mo për ato që e ka përjetu. Me çfarë ambicie po shkoj një javë ditë përpara e unë shkoj tash 40 minuta me vonesë, me temën njëzet minuta ma herët. Tash le që unë nuk e nisi menjëherë, por e bëj një pozicion, kisha ndëgju që mollat e hekin pak stresin. Sa është e vërtetë në atë kohë si student, se e lexojsha *Večernje Novosti* e kisha lexu aty. Atëherë mollat e hekin stresin ashtu edhe unë shkoj përfundi urës së Savës ashtu ka qenë një pemëshitës edhe blej dy molla.

Aty i shitshin një mollë, dy molla i qitshin në terezi sa të dojshin edhe tri molla, sa të dojshin edhe unë i marr dy molla edhe ashtu pa la i marrë për skej të lumit Sava ku bashkohej me Danubin. Aty bashkohej Danubi edhe Sava, ishte Akademia edhe unë përkej po shetiti, e ha njënenë mollë, e ha mollën tjetër, afrona te një kafene aty edhe ulem i thom një kafe me një lugë sheqer edhe e pi kafen. Masi që e pij kafen sikur kur të dhezen motorrat e Boingut më ka ardhë një motiv, krejt i bona tash mbetet prej teje çka me bo, ata veç kishte kalu një orë e gjysë.

Erëmirë Krasniqi: Sa zgjatke?

Fatmir Krypa: Ajo zgjatke deri në 12:30, deri në orën 12:00, por unë e disha që ato muj me për një orë, një orë e gjys unë ato e vizatojsha mirë fort. Por, s'mujsha me pa modelin se isha në fund të sallës, shumë larg edhe nuk mujsha qetë me pa si duhet mirë, qaty problemi se nuk ishte problemi tjetër. Edhe aty shkoj, atëherë edhe i dhezi motorat krejt edhe ma në fund ia dal e vizatoj. Noshta kom mujt edhe ma mirë, ndoshta kom mujt edhe ma mirë, por në krahasim me ata çka kishin vizatu, ai ishte shkëlqyshëm, por mujsha edhe ma mirë. Thom kom mujt edhe ma mirë, nuk e di as nuk muj me paragjyku a kom mujt ndoshta bash mirë, se prej stresit edhe s'kom mujt edhe m'i pa gjanat si duhet. Prej stresit. E kom qetësu veten, e kom pru në nivel, por nuk kom qenë mundesh me marrë me mend tash thom vet me veti, çfarë përgjegjsie për vetveten, çfarë përgjegjsie për prindin që më kishte udhëzu me shku, çfarë përgjegjsie? Sot unë boj grafika për shoqërinë e çoj ekspozoj nëpër krejt botën. E kom përjetu stres.

Por kur përfundoi provimi pranus dhe doli rezultati pozitiv, kalova, atëherë i dhashë vetit komoditet që t'ja fali vetit atë, por cilësinë me pasë ma të madhe. Unë shkoj dy ditë përpara, por s'ma pranoi ai me vu pozicionin e mendja ime po thom të shkoj dy ditë përpara aty me vu. Kjo ishte ambicioze për mu tepër, mirëpo sa ishte ambicioze ishte edhe e palejshme që të hin dikush. Domethënë, nuk lejonte, nuk lejonte koriri me jetë se do ta pagunte me vu ato, "Vetëm letrën deshta..." thashë, kurgjo edhe dola përjashta, "me vu letrën", s'kisha problem tjetër, "Jo, jo, jo, s'guxoj". Kjo është ajo që më dha motiv gjatë tonë kohës, i vetmi në gjeneratë, dhe ta përfundoj me atë sukses që ndoshta e kom pritë, por gjithnji t'u mendu se do të mundem diçka me kontribu për veti. E atë akoma mund të thotë dikush jam modest, por nuk e kom pasë atë në mendjen time që do t'i kontriboj edhe kombit tim.

Unë në atë kohë kom pasë dhjeta libra që kom ilustru për redaksinë e "Rilindjes", edicionin e "Rilindjes" pardon, Ramiz Kelmendi ishte kryeredaktor dhe kom shumë libra prej tyne mund të ju tregoj shumë libra të këtij edicioni që i kom punu, që kom qenë student.

Erëmirë Krasniqi: A gjatë kohës së studimeve i keni bo?

Fatmir Krypa: Gjatë kohës së studimeve edhe atëherë më pat dhonë, bile atëherë thojsha falemineres se kto po më motivojnë edhe me punu në profesion edhe kuptohet një biznes, një biznes i mirë ajo. Ramiz Kelmendi, sa herë visha në gjysëmjetor merrsha punojsha edhe kështu që fitova një simpati ndaj edicionit të "Rilindjes". Mandej vijshin drejtorët e tjerë edhe kështu që fitova unë, kom libra do t'i shifni dhjetra libra për fëmijë, të rritun, biblioteka të tana kom të cilat janë sot në arkivat, se vërshtirë që t'i kenë njerëzit e rëndomtë a di.

Shumkush më thonë emrin tond diku e kom ndëgjju, thojsha, "Po mirë, e ki pa në ndonjë libër që e kom ilustru". "A po, kur e kom lexu këtë roman, këtë libër po më kujtohet e ka ilustru Fatmir Krypa". Kështu që, ishte njëfarë ndihmese ajo, e para ksaj që kom fillu diçka me ilustru, e para gja që e kom ilustru që më dha një motiv edhe pak me ilustru ishte libri i Agim Ibranit me humor, humoristik, ndoshta e dini "Quo vadis, djalosh!" "Quo vadis, djalosh!" Edhe Agimi ka pasë shkru shumë gjana, atëherë në radio ka qenë shumë, shumë ai libër është, e kom diku, shumë aktual ka qenë, jashtëzakonisht i mirë. Edhe në radio i bonte humoreskat edhe ia pata bo librin e parë në klasën e

pestë të Shkollës së Mesme të Artit në gjysëmvjetor më doli një honorar bukur i mirë parapërgatitje për studime, shumë i mirë edhe atje ishte.

Kështu që, fitova tek edicioni një simpati aty, megjithatë të edicionit më thirrshin në telefon, vazhdimisht kisha. Edhe kështu që, m'u bo duhej të jetë dikush në Kosovë ilustrator për ilustrim edhe e mora grafikën e ilustrime, domethonë grafikën. Mirëpo, grafika e ilustrime, kopertina, ilustrimi mrenda, u lexohke libri, shkante atje kurgjo. Por unë, gjatë studimeve e kisha nën B, grafikën figurative dhe pasi që e kreuva studimet grafika figurative kishte një peshë afirmative, ma të lartë. Kopertina figurative nuk mund të ekspozohet. Unë bëra një mori pllakatash për Prishtinë në atë kohë, dilshin anë e mbanë Prishtinës pllakatat e mia nëpër shumë manifestime. Mirëpo sa shkojsha prej fundit të korzës deri në kry të korzës tjetër, ai pllakatat u shkyjke gjysa, aq e kishte jetën. Dhe m'u kjo disi më demoralizonte, e sa bojsha unë për atë pllakatë.

Fitojsha çmim, çmime fitojsha edhe ti fitojshë çmime ndërkombëtare në ish-Jugosllavi, atëherë ishte bukur punë. Kom pasë disa çmime ktu edhe nuk më vinte mirë kur e shihsha pllakatën e shkyme, m'u duke shumë e... ose librin e shfletonte sikur disa raste që i përmenda ma parë, "A po, po më kujtohesh, e kom lexu këtë libër, e kom pa e keni ilustru e vërtetë është, po". Mandej fillova të kuptoj se jeta ma e gjatë e krijuesit është grafika figurative.

Pjesa e Katërt

Erëmirë Krasniqi: A shkojshin në ekspozita në Beograd ku u ekspozojke grafika?

Fatmir Krypa: Po patjetër, patjetër. Ishte një kohë kur ushqimi në menzë ishte fizik, ushqimi shpirtëror ishte ditor në muze, në galeri ishte i përditshëm, ishte i përditshëm. Ekspozitë që vinte nuk mujsha me e lonë pa e pa është e pamundun. Saqë, më kujtohet kur u ardh ekspozita e Van Goghut në Beograd, ka qenë '67, '68-67, '68 mdoket, '68 dhe ishte rendi pafund me prit. Kom prit me dridhje kambësh deri sa më ka ardh rendi me pa, gati me më ra të fiktë kur jom ardhë e i kom pa veprat e Van Goghut. Kisha mësu në shkollë të mesme, kisha mësu në Beograd për Van Goghun, kisha bo një temë një shoqes, shoqes time për temë të maturës, njëzet faqe ia kisha shkru për shkollë të mesme, kisha msu shumë për Van Vogh-un.

Dhe kur i afrohem derës prej pozicionit të korridorit hyjshin mrenda e shihsha një pjesë, një fragment të pikturës, mu pulsi filloi të më rrahte. Thojsha, "Çka po don me ndodh me mu?" Ishte një përshtypje shumë e madhe, s'di kush ta shpjegoj atë. I afrohem veprave të Van Goghut, dridhesha si e shihsha çdo potez të brushës, se si ashpërsinë e tij i ka shku dhe kështu që deri sa kambët mbajtën, deri sa u lodha në tërësi unë i qëllova fundit (qesh) me i pa, do të thojsha se me polici ka ardh me mbrojtje, me sigurim të hatashëm ka ardh, as Titon nuk e rujshin aq tepër kur e kanë marrë prej stacionit të trenit, ka ardh me tren.

Kështu që, këto manifestime ishin, nuk mund t'i shmangeshim se ishin ushqim përveç anës praktike që ne e mësonim në Fakultet, duheshim të merrshim edhe frymëzime nga eksperinca e artit botëror, se defilojshin edhe artistë botëror në Beograd, që edhe nga ajo shkollë të pajiseshim me dije çfarë niveli po ekspozohen. Kështu që, vitin e fundit ishte një dilemë, a të vazhdoj studimet post-universitare në Zagreb, a të kthehem në gjirin familjar dhe të vazhdoj dikur ma vonë kur të bohet? Dilema ishte shpejt e zgjidhshme nga se atëherë veç se isha në fazën e babës, isha bo prind, kisha këtë vajzën që e patë Ardianën edhe kështu duheshe që prind të mos financonin tash shoqën, tash po më financonjë mu, por edhe në shoqën edhe në vajzën dhe duhej me u punësu, të gjindet një intermeco mandej studimet post-universitare.

Erëmirë Krasniqi: Kur u martut, në këtë tre-vjeçaren e fundit?

Hysni Krasniqi: Në '67, në '68 kom përfundu studimet dhe kthehem në vendlindje në Gjakovë, punësohem në Shkollën Normale "Hysni Zajmi". Aty gjej një shoqëri shumë të mirë, shkollën e re, nxanësat të sjellshëm dhe u bonë të sjellshëm edhe me punë. Duke e tregu punën, ata i preferojshin kërkesat e mia dhe tregoheshin rezultate. Ata të knaqun me punën e tyre, unë i knaqun prapë me punën e tyre që po knaqen ata, dhe ishte knaqësia e ndërsjellët. Dhe kështu ishte një kohë ku qëndrova katër vite e diçka dhe kisha vajzën e dytë.

Një ditë kisha pauzë në Shkollë Normale dhe marrë gazetën "Rilindja", vinte ai që e shet "Rilindjen", Islam e ka pasë emrin, e Lam e thirrshim. Vjen ai në sallë të arsimtarëve, "Rilindja, Rilindja, Rilindja!", thomë, "Lam ma jep një Rilindjen". Atëherë ishte e vetmja gazetë edhe unë e shfletoj gazetën edhe vi deri në fund, kur shoh ka fundi aty konkurs. Kurrë s'kisha pa konkurs një faqe "Radio Televizioni i Kosovës", i Kosovës, po, konkurs. Au *blaj, blaj blaj* {onomatope} çka paskan shpallë tonë kto vende në televizion, çka po dojka m'u bo ktu? I lexoj...

Erëmirë Krasniqi: Kur u hapë televizioni atëherë?

Fatmir Krypa: Dojke mu hapë atëherë, po. Unë e lexoj aty krejt ku, çka do bojkan, nejse kto regjisor e kameran, kto e kto e kto, po. Krejt ato po, kur pe lexoj piktor - ilustrator Akademia e Arteve. *Ueee* {onomatope} qitu jam. Ishte dimër, ishte kohë vjeshte e vonshme ngat stufe po nxena. Thashë, "A me konkuru?" Jom shku në shpi edhe i thashë shoqes, tash e disha që kjo nuk thotë jo me shku në Prishtinë edhe i thom, "Hyrije qeshtu qeshtu, një konkurs në Televizionin e Prishtinës po hapshin këto vende të punësm mes të tjerash edhe piktor e ilustrator. A mund me m'u gjetë ilustrimi i telopave e vendeve aty për televizion", mirë. Ishte i ndjeri Petrit Dushi edhe unë menjëheri lutjen të nesrit në televizion shkoj tek drejtori i produksionit, Petrit Dushi.

Thom kështu, kështu jam Filan Fisteku qeshtu qeshtu, të kryme Akademinë anej e knej, punoj, nëse doni informata mundeni Fahredin Gungën, Entin për Botime atë më njofin thashë, Remiz Kelmendi thashë, "S'jonë njerëz të rëndomtë që mujn fjalë gojesh me thonë, por të japin. Kom ilustru", thashë, "me dhjetra, dhjetra mos të thom me qindna libra, po ilustrime" thashë. Edhe ishte një konkurent, një djalosh prej Pejës, kishte kry në Belgjikë një Akademi private, po edhe ai ishte konkurent. Petriti po më thotë, "Duhet me bo një test. Vjen ditën e hane tjetër". Edhe shkoj unë, vjen edhe ai. I thom, "Çka me

bo test? Qe ku i kom veprat, kqyri librat, kqyre bibliotekën, çka kom libra, kqyri këto ilustrime, kqyre ato nuk janë fjalë që, kqyre këtë kandidatin tjetër”. Tha, “Veç po më vjen keq që nuk kom vend ku me të sistemu, se zyre nuk kom, por do të punojmë bashkë. Ti në atë qoshe, unë të këtë qoshe. Të koftë përhapër, urime!” Edhe tha, “Ditën e hane vjen ia fillon punën prej të parit.”

Erëmirë Krasniqi: Sa keni punu në Televizion?

Fatmir Krypa: Në televizion kom punu një vit dhe ndërkohë hapet Akademia e Arteve me 1974 dhe tash puna e mirë në Televizion ishte, krijova një shoqëri të jashtëzakonshme.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ishin fillimet e Televizionit? Qysh u gjindshit krejt me një teknologji televizive?

Fatmir Krypa: Nuk kisha problem se mujsha me shku në Beograd me huazu teknikën, me pa si po punojnë dhe me ka dy javë me nejt atje lirisht, po. Një ditë, dy, dy javë një herë kom nejt edhe me pa të gjitha ato çka kanë mundësi me i bo puna ime ishte fjala se jo për punë të tjera, montazh e ç’montazha s’kishin mundësi për mu. Puna e ime që e bojsha edhe...

Erëmirë Krasniqi: Çka bojshit? A shkrujshit...

Fatmir Krypa: Po me shkru tellopa, ishte me vizatu, nuk ishte një punë edhe aty e pashë që nuk o puna një fat i imi si me ardh në shprehje dituria ime, ajo ishte a tepër. Dhe drejtori, Riza Hala kishte ndëgju që du me lëshu, kisha bisedu me disa kolege, gazetarë që vishin aty në zyre te unë dhe “Fatmiri po bojke me shku a?” “Jo, more. Kush të tha?” Më thirri Riza Hala, “Po si more don me shku?” Tha, “Valla” thashë, “nuk po ka banesë, ndoshta bon vaki edhe shkoj”. “Mo, do të shiqojmë me dhonë banesë, do të shiqojmë”. “Nëse më jepni banesë do rri, nëse nuk më jepni banesë deri këtë ditë, unë do ta boj lutjen për në Akademinë e Arteve. Atje me punu me studenta tri ditë edhe me dhonë kontribut për artin, atë maksimalen që e ke me dhonë”. Thashë, “Unë ktu nuk po muj me dhonë krejt ato çka e di, kjo është që po më dhemb. Ku me marrë burrë si ty, si këtë, si atë...” po i përmendi, “Xhevat Junikun, mrekulli me shoqerinë që e kom këtu, s’e kom pasë kurrë”. Thashë, “Edhe mirë, mirë, si të dush, si të kish qef”. Nejse, u hap në Akademi, u hap konkurs për me hapë degën e grafikës, u lajmrova unë, u lajmrinë edhe tre kolegë të tjerë, Shyqri Nimani, Xhevdet Xhafa edhe Hysni Krasniqi.

Erëmirë Krasniqi: Në ekspozitë a?

Fatmir Krypa: Urno?

Erëmirë Krasniqi: Për ekspozitë krejt...

Fatmir Krypa: Për konkurs profesor e landës së grafikës. Domethonë, për një vend pune katër kandidatë u hapë. Edhe të thom të vertetën konkursin e parë ku me çu me shkru, me çu me shkru në Beograd. Këta s’kishin, s’kish kush me shkru recension, se s’kishe njeri që e kishte kry para nesh. Me ligj nuk mund ta shkrunte një jurist i thjeshtë për ne, duhej të kishte dije arti për landën të cilën ne konkurronim. Duhej profesor i landës me thirrje të lartë jo si ligjërës, por thirrje të lartë, jo asistent,

profesor inordinar, profesor ordinar ose ma së paku docent, atëherë që ishin ato thirrje. Dhe u deshtë me shku a në Beograd, a në Zagreb, a në Lublanë, a në Sarajevë. Meqenëse, ne ishin tre që e kishim kry në Beograd, unë, Shyqriu, Hysni Krasniqi, vendosëm mos me qenë në Beograd, në Lublanë e kishte kry Xhevdet Xhafa, vendosëm në Lublanë mos me çu, po i çojmë në Zagreb.

E kanë çu recenzionin e kanë shkru në Zagreb edhe e kanë kthy pozitivisht për mu, mirëpo njëri prej kandidatëve kishte një afërsi s'po e jap emrin se e kom shok, kishte afërsi me njerëz në pozita të larta politike dhe arriti që me anul konkursin, u bo. U anul konkursi, u shpall konkursi ndryshe, fillum me konkuru, konkurum tre kandidat. Konkurum Xhevdet Xhafa, Hysni Krasniqi edhe unë. Tash jo në Zagreb m'i çu, se Zagrebi e kishte dhonë fjalën, "S'kemi çka shkrujm na mo tjetër, e kemi dhonë fjalën. Mendimi jonë është ky". Por po i çojmë tash në Sarajevë, se edhe Sarajeva kishte metë, p'i çojmë në Sarajevë. Sarajeva na thirri neve personalisht me na pa si pedagog, si fizikus, si profesor i landës, domethonë me punimet tua, qëndrimi yt dhe si po e jep landën.

Tha, "A ke dëshirë që ta improvizojmë orën para studentave, a para komisionit?" Thashë, "Komisioni po e pysin kta, anëtarët e Komisionit të Sarajevës. Për mu është krejt e njëjtë, por ma merr mendja që m'u konë unë anëtar i komisionit atje kisha përfitu ma shumë me qenë para jush, kisha përfitu se më kishit pyt, a nxanësit, pysin studentat çka pysin, ju mundeni me pyt në mënyrë ma profesionale edhe kështu me i ditë gjanat ma interne." Tha, "Në rregull, para nesh do ta japësh orën". Këta kolegët tjerë s'i kom pyt, s'i kom pyt qysh i kanë dhonë.

Nejse, e dhashë atë mendimin edhe e dhashë. Po shkojmë edhe njoni anëtor i komisionit tha, "Po më pëlqen si njeri, puna u kry, na e kena dhonë mendimin, por ta të bëhemi të sinqertë, kolegë jemi. Atë moment kur ta transmetojnë, kur ta, Fakulteti yt i thotë kujt kush u pranu, se nuk goxoj me ta komunik". Kqyre anëtar i komisionit tha dalim pijmë kafe nëpër Sarajevë, shetimtim tha, "S'guxoj me tregu kush është pranu, se e dimë". Se unë isha i fundit që e kisha dhonë, dy para meje ishin ata tjerët dhe i lash përshtypje. Aty e vëreja se ka diçka të mirë te ky njeri që po më afron, ka mirë diçka sigurisht, thashë ka diçka pozitive. Tha, "Ndëgjohemi dikur kemi me pasë raste kolegë, kemi m'u shkru, m'u ndigju, m'u pa", se ishte grafist edhe ai. Me këta dy tjerët jo, me këta dy tjerët jo, se ishin kështu strikt, Xhevat Hozo, Mersad Berberi, njerëz me nam edhe s'dojshin fare me diskutu për këtë çashtje. Edhe unë po pres rezultatin zyrtar, si e çojnë për të gjithë të tjerët. Vjen rezultati zyrtar prej Fakultetit të Sarajevës që për landën e grafikës zgjedhet Fatmir Krypa, për landën e grafikës.

Atëherë e kuptova pse ai kolegu kishte dhonë njëfarë pëlqimi që këtë besim me shetitë me to, por nuk... e ruajt në diskrecion deri në pikën e fundit. A mundte me më tregu, me thonë, "Hesht se ty ta kemi dhonë", por ishte niveli i pedagogjik tek të gjithë në atë kohë që ta ruajnë nivelin pedagogjik edhe me kolegun edhe me studentin. Kështu që, unë aty e fitova atë status të profesorit, në realitet ishte ligjerues thirrej.

Erëmirë Krasniqi: Veç ta kjartësoj, domethonë ju për mu pranu këtu në Prishtinë aplikacioni juj është shqyrtu në Sarajevë.

Fatmir Krypa: Në Sarajevë, një herë në Zagreb në mungesë të kuadrit, kuptohet se s’kishim kuadra, s’kishim kuadra dhe mandej filloj punën në Fakultetin e Arteve me një grup studentash sa e kishin fillu, ishin pranë.

Erëmirë Krasniqi: Ata vishin prej Shkollës të Lartë në Prishtinë?

Fatmir Krypa: Jo, prej vitit të parë, vitit të parë jo prej vitit të lartë, prej shkollës së mesme.

Erëmirë Krasniqi: Ishte edhe një dy vjeçare shkollë e mesme.

Fatmir Krypa: Po po, por jo me vit të shkollës së lartë, por me klasën e parë mas kimit të shkollës Gjimnazit ose Shkollës së Artit.

Erëmirë Krasniqi: Po preferojshëm studenta të Shkollës së Mesme të Artit.

Fatmir Krypa: Nxanësat që vinin nga Shkolla e Artit në Pejë kryesisht, se s’ka pasë Gjilani. Kanë qenë, tash është edhe Gjilani, atëherë ishte vetëm Shkolla e Artit e Pejës, por mundeshin me dhonë edhe me Shkollë të Lartë me dhonë vitin e parë, por u duhshë në vitin e parë, e në qoftë se t’i pranojnë landët. Atëherë me provime ma vonë u duhshë me edhe me Shkollë të Lartë në vitin e parë u duhshë, se Shkolla e Lartë kishte rang tjetër, e Akademia kishte rang tjetër. Kështu që, edhe ai me Shkollë të Lartë duhej të konkuronte në vit të parë, por na ia pranojshëm ato provimet të cilat i kishin dhonë në Shkollë të Lartë.

Edhe kështu që e fitova statusin e pedagogut aty e mandej e hapa edhe unë konkursin për një asistent e mora një koleg që kishte konkuru, Hysni Krasniqin. Edhe mas një kohe atij i thashë m’u avancu, thashë, “Kolegë jemi, avancu në thirrje ma të lartë” edhe po menoj të kenë të drejtë të ligjeror edhe si student dhe njëheri të ketë ma tepër qasje me kolektivin kështu si pedagog, e jo asistent vetëm, por të ligjeron. Ishte ndryshe statusi i asistentit, ndryshe kur ishte asistent i angazhum si ligjerues, kishte një privilegj pakëz te kolegët edhe ndryshe avancohen mandej në thirrjen e ligjeruesit. Kështu që, ajo kohë kaloi me një... edhe fitum, unë u bona, i bomë dy klasë të grafikës edhe mandej u bomë edhe rival, kështu.

Erëmirë Krasniqi: Çfare ishin kushtet në atë kohë?

Fatmir Krypa: Fakulteti me një si me thonë terren të rritjes vazhdimisht, mirëpo kushtet sado pak i plotësonim për punë dhe kontributi ynë ishte shumë i madh, shumë i madh për me nxerr prej një pune që bonim me studenta në ato kushte në baraka. Në atë objektin ku e morrëm masanej mas luftës, ku ishte për... e dini ku është Akademia e Arteve? Ai ka qenë deri diku për Kisha, e patëm marrë, e patëm shëndrru në do klasa improvizuse.

Erëmirë Krasniqi: E në fillim kur keni qenë?

Fatmir Krypa: Në baraka të Ferstudentit.

Erëmirë Krasniqi: Çka është Ferstudenti?

Fatmir Krypa: Kanë qenë për studenta, aty ngjit me...

Erëmirë Krasniqi: Me arkitekturën?

Fatmir Krypa: Jo, ngjit me Fakultetin e Mësuesis [Fakulteti i Edukimit], ngjitë me Kishën, ma knej Kishës.

Erëmirë Krasniqi: Përballë barakave ushtarake...

Fatmir Krypa: Jo, jo, ato barakat ushtarake kanë qenë ato, po po.

Erëmirë Krasniqi: Domethonë, përball Galerisë?

Fatmir Krypa: E mandej janë marrë ato baraka, kanë bo për banim të studentave, janë largu studentat edhe mandej kemi marrë për me bo si klasë ligjeratash. Kushtet jashtëzakonisht të vështira, ftoft bonte jashtëzakonisht shumë. Ti nxeheshe, e kallte stufën por stufa barakën s'mund ta ngrohte. Kushtet ishin tejet të vështira, mirëpo vullneti i ynë ishte shumë i madh, shumë i madh. Dhe praktikisht ia dolëm që edhe unë si dekan e bana një kërkesë, atëherë nuk kishte Ministri, por Sekretariati të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, që të ngritet një ndërtesë e veçant për Akademinë e Arteve. Ndërkohë ne e kemi zhvillu, përveç ne u forcum, e bom si motër Akademinë e Muzikës, u bomë Akademia e Arteve dhe Akademia e Muzikës. Ndërkohë, me iniciativën e Fadil Hysës unë e mora shumë seriozisht, e çova përpara atë punë, mund ta pysni Fadilin kurdoherë kush është iniciator edhe në realitet iniciator ka qenë ai, por i shtytjes së ndërtimit dhe themelimit të Drejtimit të Dramës.

Një ditë po e pyt një student ngjit në lift në Radio ku ishin RTV, Radio Prishtinë, ishte Fadili me një studentet të vet, "A din kush ka qenë iniciator për themelimin e Dramës", tha, "Jo s'e di", tha "Njerin e ki përpara" dhe ashtu filloi kërkesa. Unë shkova në Beograd, i mora krejt elaboratet çka duhet për themelimin e një drejtimi edhe ata thanë ju ndihmojmë në recenzura, ju ndihmojmë në çka të doni, instruksione për mësimdhënie dhe aty patëm një mirëkuptim kur unë e bona një elaborat dhe ai elaborat u aprovu dhe Akademia e hapi drejtimin e Dramës. Kur u bomë që te trijat, atëherë...

Erëmirë Krasniqi: Kto e kishit bashkë me Artet Aplikative?

Fatmir Krypa: Jo, jo, Artet Figurative ishin, artet nuk ishin të ndame figurative, aplikative, por Artet Pamore, Arti Figurativ quhej, ishte Muzika edhe Arti figurativ ishte me Grafikë, me Skulpturë edhe Pikturë edhe Dizajn Grafik dhe mandej e murrëm thashë Muzikën, mandej Artet e Dramës dhe kur u bomë te trija. Unë qëllova si dekan dhe e bona një elaborat për ndërtim të ndërtesës, se kushtet... edhe s'kom lonë derë pa trokitë në Kuvendin e Kosovës, në të gjitha figurat politke, instancat ma të larta për me gjurmu, për me gjetë mirëkuptim tek njerëzit për hapjen e Fakultetit, të ndërtimit të ndërtesës.

Erëmirë Krasniqi: Tash ish '74 deri...

Fatmir Krypa: Dhe në fund arritëm që me ndihmesën e një kolegut, kolegut tonë Agush Beqirit, vllaut të vet që ishte arkitekt Qemailit dhe e bomë me kërkesën e pedagogëve, “Secili grup”, thashë, “Ta merr mbi vete çka i duhet skulpturës, çka i duhet pikturës, çka i duhet dramës, çka i duhet muzikës, diçka karakteristike që t’i vëj në letër dhe ne t’ia japim arkitektit që ai t’i ketë si bazë për formimin e klasave, madhësisë së klasave, anës ka jugu, ka veriu, ka lindja, don dritë natyrale. “Skulptura s’don dritë të diellit, por du dritë nga veriu, dritë që e ka vazhdimisht njësoj, që nuk e pengon, dritën e ka si paradite, si masdite njëjtë.” Agimi [Çavdarbasha] thojke, “Se tash më bie dilli. Tash mi bien hija kështu e ma prish pozicionin” edhe kështu që patëm, me këto ndryshime e bomë një ndërtesë e projektum. Masi që u bo kjo kërkum mjetet. Mjetet u aprovun.

Erëmirë Krasniqi: Në cilin vit veç, veç tregoini vitet.

Fatmir Krypa: Viti tash ta kthej trakën, ta kthej trakën.

Erëmirë Krasniqi: Sa vjet mas themelimit?

Fatmir Krypa: ‘79, ‘78-‘79, pardon, pardon, pardon ‘88-‘89, ‘88-‘89 ka qenë viti, pardon më fal ‘87-‘88, ‘87-‘88.

Erëmirë Krasniqi: Si mendohej m’u ndërto?

Fatmir Krypa: Kjo mendonte me u ndërto edhe...

Erëmirë Krasniqi: Në cili lokacion?

Fatmir Krypa: Ku është Kisha nja njëzet metra përpara, nja njëzet metra përpara, përpara Akademisë, te Shkolla e Lartë andej nja njëzet metra. Qeshtu u konë pasë parapa të ndërtohet në dy faza. Ma lejun 500 milionë Radio Televizionit për gurëthemel, 500 milionë mu për Akademinë e Arteve. Muhamed Bicaj, si sot më kujtohet që nëse e ndigjon këtë emision, shumë m’ka pasë gzu atë ditë. Më thirrë në orën 8:00 të mëngjesit, ishte prorektor Muhamet Bicaj, a e din? Nejse, ka qenë prorektor e thotë, “Mirëmëngjesi shoku Dekan edhe urime.” Thashë, “Për çka është fjala?” Thashë, “Urime mirëmëngjesi”, tha, “po ndërtohet Akademia e re, shoku profesor, shoku Dekan”, thashë, “Qysh bre?” Tha, “Mramë u mbajt mbledhja në Rektorat, finale për realizimin e kësaj kërkesës t’juj.”

Edhe unë thashë, “Muhamet, as njo, as dy përfaqime qitash s’muj me ta bo, po vi tash meniherë në zyre ose hajde, por jo prorektori m’i ardh dekanit, jo po vi unë te ti pe pijmë një kafe së bashku, e çka do të pason mas kësaj e shohim”. Shkum, kom pi kafën me të edhe kemi uru njëri tjetrit, një falenderim e kom pasë gjithnjë që edhe ai ka bo përpyekje. Ky gzim nuk shkoj gjatë. Ato pare që m’i

ndanë në konto të Fakultetit të Arteve u dedikun Ismail Bajrës, atij për Radio Televizionit ia ndanë atje kur s'kanë shku me thonë 20-25 ditë edhe u fut Milošević¹⁰ në të gjitha instancat bankare.

Erëmirë Krasniqi: Kur ndodhi kjo ndodhi edhe fjalimi i Milošević-it?

Fatmir Krypa: Ajo ndodhi i murr të gjitha, të nesrit nuk ka kurgjo çka ka pasë mbramë. U përmbysën të gjitha, krejt ranë, çdo vendim, çdo gja çka ka qenë deri në orën 24:00. Të nesrit ka ndodh diçka tjetër, kurgjo mo nuk vlen, krejt janë rregulla të reja. Filloi lufta, filloi represalja, filluan fjalimet, filluan të gjitha dhe mbeti edhe andrra. M'kanë thirrë nja dy herë, një vajzë prej Redio Televizionit me dhonë po qe nuk ka ardhë me bo bisedë, tha që e gjeta njeriun adekuat me bo bisedën për rritjen, që paska pasë mu bo në vend të Kishës Akademia, sot mu konë ish' gjetë. Megjithëse, ata e kishin bo ku është Fakulteti i Mësuesisë [Fakulteti i Edukimit], ata masi që... m'u pa konë ajo ndërtesë e kishin bo pak ma larg ose e kishin rrxu.

Pjesa e Pestë

Erëmirë Krasniqi: Po kthehemi tek zhvillimi juj ma shumë, profesional...

Fatmir Krypa: I krijimtarisë.

Erëmirë Krasniqi: I krijimtarisë, po. Çka ndodhke?

Fatmir Krypa: Prej shkollimit përveç punës pedagogjike që ka qenë si me thonë thirrja e parë. Por, përveç punës pedagogjike, punë të cilën e kom kry në fillim kur jam ardh prej studimeve, kam qenë i preokupum që ta ndërtoj vetën edhe në forma të artit që mos të mbetem edhe pse jam në një provincë, mund ta quj ashtu, ku arti i grafikës nuk ka qenë më parë domethënë prezent edhe në Kosovë. Kom bo shumë lëvizje si në Francë, në Gjermani, në Itali, në Angli, në Hungari, në Greqi të gjitha t'u hulumtu, t'u vrej edhe me begatu vetin me krijimtari artistike.

Por, gjithnjë me qenë ai nga Kosova, i kësaj treve, i këtij nënqielli, me dhonë artin e njëmend të cilin do ta përfaqonte një shqiptar i Kosovës, i Shqipërisë a kudo por edhe një krijues tjetër, një krijues i vendeve të ndryshme, që ta ketë vlerën e artit edhe pse ta ketë përballë një malësore, ai t'i ketë vlerat artistike të atij punimi përballë, jo vet për motivin por edhe vlerat artistike. Kështu që, këtu ka qenë ajo intenca ime që krahas kësaj ta mësoj mirë, mirë se grafika nuk ka fund, teknikisht nuk ka fund.

Sot, para një muji unë kom gjetë gjana të reja, para një muji, që tani po konsolidohem në këtë studion e re. Menxi po pres këto ditë sa t'i barti krejt inventarin e atjeshit me ia fillu punës. Kom ide shumë të

¹⁰ Slobodan Milošević (1941-2006) ishte një politikan jugosllav dhe serb, i cili shërbeu si President i Serbisë nga 1989 deri në 1991 dhe brenda Republikës Federale të Jugosllavisë nga 1991 deri në 1997, dhe President i Republikës Federale të Jugosllavisë nga 1997 deri në 2000.

reja. Kom ide po më vlojnë në kokë. Unë nuk e di sot si po muj me prit për nesër, me prit javën me ia fillu. E kjo është ajo, që kur të akumulohet ajo shpërthen patjetër.

Arti në Kosovë e kemi pasë një andërr ekspozitat me i bo. I kemi pasë andërr. Kur u punësum nuk dishim studentave se si të ju ilustruam punën që duhet me e bo. Ti ju spjegojsh me gojë, por nuk kishte muze, nuk kishte galeri që mundte studenti me vështrë, me shku aty edhe me pa. Ne profesorat në Beograd, na thoshin, “Shko në muze, në galeri këtu ti shiqoje, në katin e dytë, këtu shiqoje këtë personazh qysh punohet, qysh e ka punu.” Si e thashë ma parë Van Goghut kur ia shihsha ato potezat e brushës unë u rrëqetshja, e shihsha sikur po më duket që dora e Van Goghut po lëvizë tash.

Kjo ishte një mangësi që duhej ne ta forcojmë artin dhe unë si në shkollë të mesme ku kom dhonë mësim në Gjakovë, në Shkollë Normale, fillova e bleva presën, se pa të nuk bon grafika, në Novi Sad se këtu nuk kishte kush ta punonte ashtu. Atje i punonin dhe fillova me i ekzekutu grafikat e para në Gjakovë dhe i kom disa ekzemplarë, një prej të cilave e kom, e keni edhe ju, e ka edhe Galeria, “Variola Vera”¹¹ ka qenë në Gjakovë. Unë e pata regjistru në kokën time dhe në veprat e mia atë rast me dy grafika dhe prej atyhit ia kom fillu të mirrem, të ekspozoj në ekspozitat e para të Sallonit Pranveror të Kosovës, të cilën e kemi bo bashkë me Engjëll Berishën, piktorin Engjëll Berisha. Ai ishte kryetar i Shoqatës [Shoqata e Artistëve të Kosovës] dhe unë e morra iniciativën që ta bojmë edhe pllakatin, ta bojmë edhe katalogin, ta bojmë edhe ekspozitën në foajen e Teatrit të Kosovës. Dy vjet e kemi hapë, tri vjet e kemi hapë aty rregullisht, po.

Është hapë dhe ne e bomë që të garojnë piktorët të cilët e kanë të krym Fakultetin, jo studentat. Për me qenë edhe studentat aktual e bom edhe një termin tjetër, “Ekspozita vjeshore”, i thonim. Aty kishin të drejtë përveç pedagogëve, profesorave të tjerë që ishin, krijuesëve të ndryshëm, mujshin me marrë pjesë edhe studentat me veprat e tyre, por kuptohet studentat e viteve ma të larta dhe aty ishte anëtarët e Shoqarës të Artistëve Figurativ të Kosovës dhe jo-antëtarët e Shoqatës. Kështu që, u formu njëfar brezi i larmishëm që kishin me shoqatë, pa shoqatë, studenta të ekspozojnë nëpër katalogje të ndryshme dhe jeta filloj të gjallërohej, fillojmë të kishim ekspozita, fillojmë të marrim edhe nga vendet e tjera.

Kështu me hapjen e Galerisë u bo një ndihmesë shumë e madhe për vend-ekspozim, se problemi ishte përveç që artisti e kishte anën financiare për ta përgatit një katalog, për shtyp të një katalogut edhe vendin e ekspozimit. Atëherë u bo edhe Galeri me stafin që kishte e bonte një komision për të cilin edhe aty duhej që të ekspozonin vepra të cilat ishin të mirëfillta. Nuk bonte të ekspozon gjithkush që t'i bjen në qef që mirret me art, “Hajt ta boj një ekspozitë në Galeri unë”, por kur ta bojmë një ekspozitë të Galerisë ajo e ka një tretman. E kanë bo ekspozita personale, kanë bo mendej edhe në foaje, por pa ndonjë kriterium. Kanë bo nëpër kafiteri, kanë bo, por pa ndonjë kriterium. S’kanë pasë kriterium. Kurse në Galeri e kishte këshillin i cili e vendoste, shkonte te artisti edhe ja vështronte veprat se këto

¹¹ Variola Vera ishte një sëmundje infektive e shkaktuar nga një nga dy variantet e viruseve, Variola major dhe Variola minor. Shpesh ata që mbijetuan kishin dhëmbje të mëdha të lëkurës dhe disa mbetën të verbër. Në Jugosllavi shpërthimin e fundit e pati ne vitin 1972 kur një haxhi musliman ishte kontraktuar me virusin në Lindjen e Mesme. Pas kthimit në shtëpinë e tij në Kosovë, ai filloi epideminë në të cilën u infektuan 175 njerëz, duke vrarë 35.

vepra bon të ekspozohen këto nuk bon të ekspozohen mandej, nuk e ka nivelin për ekspozitë edhe nuk ja jepke si me thonë mundësinë për me ekspozu.

Kështu që, atëherë filloi edhe një... përveç larmisë edhe një rang i krijuesëve fillun, me rangun e profesorëve, studentëve të avancuar edhe fillun të boheshin ekspozita edhe jashtë Kosovës. Për ta afirmu atë punë që ne e bonim në kuadër të Kosovës fillum edhe si Galeri e Arteve, se kom qenë edhe në Këshill Artistik edhe në Këshillin Blerës që janë ble ato veprat, që të bojmë ekspozita në trevat ma s'pari Jugosllave, në Republika të Ish-Jugosllavisë, në Rumuni në Javën e Kulturës, në Slloveni kur ishte. Këtu java e kulturës kur ishte shkonte me një ekspozitë, se edhe ekspozita edhe arti pamor ishte kulturë, që do me thonë përveç dramës, përveç një koncerti kishte edhe ekspozitë, do të thotë të jetë ajo kulturë e larmishme, të mos jetë me një koncert, me një dramë, por të jetë edhe artet pamore. Aty ishin arte figurative, artet aplikative, kështu që u bojke pak a shumë një... edhe gradualisht nëpër krejt Jugosllavinë fillun të informohen se ekziston edhe kishte ftesa tani, fillonim të bonim edhe ekspozita individuale.

Unë e bona një ekspozitë individuale në Dubrovnik. Dubrovniku e kishte një si me thonë zëvendës drejtor tjetër *Varaždin* [qytet në Koraci]. Ai po më thotë tash, "Masi që e ki, duhet tash ta bojsh edhe te ne në *Varaždin*" e edhe në *Varaždin* u desht. Kështu që, një lidhje nëpër galeri filloj të afirmohemi edhe individualisht ne si krijues edhe në tërësi arti i Kosovës fillon të zhvillohet. Fillum me katalogje, mbetshin katalogjet aty në galeri, e merrte dikush katalogun, dikush të thirrte mandej në ekspozitë, të kishte pa, adresën e kishë, numrin e telefonit edhe e bonte ftesën edhe kështu që kom marrë ftesa me bo ekspozita jashtë, shumë ekspozita të Galerisë Moderne të Lublanës. Kom bo ekspozita në mbi njëzetë shtete të Evropës, mbi njëzetë shtete të Evropës.

Erëmirë Krasniqi: A ndodhshin kto në kuadër të Shoqatës?

Fatmir Krypa: Ishte galeria, ishte galeria, e kishte kostosin dhe ai e bënte përzgjedhjen, "Prej Kosovës du me zgjedh Fatmir Krypën". U kry, "Prej Maqedonisë me zgjedh Filan Fistekun, një, dy, tre". U kry. Dikon tjetër prej Serbisë, prej Maqedonisë, prej Malit të Zi, prej Sllovenisë kto. E bonte njo 25, 30 piktorë, grafistë i bonte.

Erëmirë Krasniqi: E prej Kosovës qysh u promovojshit, përmes Shoqatës të Artistëve Pamorë apo përmes Galerisë, lidhjes me Galerinë?

Fatmir Krypa: Ma shumë ka shku kur është formu Galeria, se Galeria e ka pasë stafin ku menaxhojke ma mirë, kishte korespondencë edhe me telefona edhe ishte drejtpërdrejtë me adresa edhe me emra të drejtorëve të Galerive të ndryshme i njoftum dhe ata e bonin propagandën e vet tu e afirmu artin e tyre në artin e Kosovës, t'u çu ftesa se do ta bojmë artin e Sllovenisë atje atje, a do të marrin pjesë me pikturë ose grafikë të Kosovës. Kështu që, vinte një kërkesë prej atëherit dhe ne ju përgjigjshim. Kështu që, Galeria ishte si një urë-lidhëse, se si Shoqatë nuk kemi pasë. E kemi pasë një zyre, Engjëll Berishën, e kemi pasë një kohë të gjatë një zyrë, i bojshim mbledhjet, "*Bllaj, bllaj, bllaj*", i mbledhim ekspozitat për sallon sa punime, kush po bohet kryetar i këtij salloni, kush po bohet kto, kush po i aranzhon, qito gjana. Punë vullnetare amatoreske, *full* amatoreske, kurse në Galeri ishte ma

profesionale. Ishte stafi që e bonte aranzhimin, ishte stafi që bonte edhe lidhje direkte, shkrunte mesazhe, teleksat kanë qenë në letra, telegrami e qesi sene ka pasë, deri qitu u konë teknika, s'ka pasë ma tutje.

Mandej vishin ato, se letra vinte prej Jugosllavisë për një ditë dy edhe ato telefonata u merrshin vesh ma shpejt. Kështu që, kemi pasë një begati me Lublanën, me Zagrebin, me Sarajevën, me Beogradin kemi pasë edhe është hapë Muzeu i Arteve Pamore në Maqedoni, na kanë çu ftesa “Kush janë ata bamirës artistë që dojnë me dhuru vepra arti ta begatojmë kulturën tonë në Muzeun që po e formojmë.” Bukur një numër prej tonëve, unë për veti e kom çu një grafikë edhe më kujtohet ajo ka qenë {bën me gisht tek një grafikë mbrapa} “Hasjanja”, ajo atje. E kom çu “Hasjanen”.

Muzeu i Titogradit kur është formu më kanë çu ftesë me dërgu një vepër arti, Muzeu i Beogradit ju kom çu. Kështu që, ishin kontaktet individuale. Këto ekspozitat e përbashkëta kanë qenë me marrëveshje kanë shku në ekspozitë, me ardhë ekspozita edhe ka shku si njoftim i artit të Kosovës në botën e jashtme edhe ata kanë me qenë si me thonë kurrështar me ditë se çka po ndodh me artin e Kosovës, se paska edhe art në Kosovë në çfarë niveli qenka. Edhe kështu që ju tregova pakparëz që kur kemi ekspozu në Londër me një galeri na kanë ftu, mandej edhe pesë galeri tjera të cilat e kanë pa artin e Kosovës e aty kanë qenë. Prej atyne piktorëve që merren me grafikë, disa prej grafikëve që jemi edhe një numër i konsiderushëm që e kemi pasë thirrë të studentave të posa diplomum dhe e formum një grup i cili vërtetë u prezentu këndshëm prej nga ishte në Londër, një kulturë që ishte shumëvjeçare të bohej një ekspozitë me studenta edhe na ishim amatorë, ishim fillestar.

Erëmirë Krasniqi: Kjo në '85-tën a po?

Fatmir Krypa: Po, ishim fillestarë. Arti don shtrimje të gjanë me pasë. Unë kisha besim në vete deri diku, por jo aq sa mujsha me qenë i besushëm në vlerat që ata i mendonin edhe kështu që mandej filloi besimi kur hapën katër, pesë ekspozita, kur hapën mandej i lypën në Gjermani në dy vende, në Mynhen në dy galeri, aty po bohet. I kërkun mandej në Itali, po bohet ajo shumë edhe kështu që mandej në Turqi. Fillon të zhvillohet, të merr frymë. Arti i Kosovës mo nuk mbeti ashtu mo në paragjykime, nuk mbeti në art si me thonë i...

Erëmirë Krasniqi: Pse a ka pasë në Jugosllavi paragjykime për artin e Kosovës, a mundesh me na tregu.

Fatmir Krypa: Po ku mos me pasë, se ti ki qenë tabu temë, ti ke qenë, s'u shkru për ty kurrë një fjalë, për artin, jo, jo. Për artin fare nuk u shkru në Jugosllavi, vetëm kështu çka kemi arritë na individualisht nëpër Fakultete me proklamim ka pakëz ashtu, se s'ka pasë. Paragjykime aty me shqiptarë çka dinë ata?

Tash një student i imi ka konkuru në Akademinë e Zagrebit, që masi e pata kry unë i thashë me shku se ka kushte shumë në Zagreb. Dhe ai student me ato kushte është zhvillu edhe mirë e ma mirë, një prej studentëve ma të mirë që kisha në atë kohë. Ndërkohë kanë ardhë nga Akademia e Zagrebit, një bashkëpunim vllazëror kështu me Akademinë e Romës. Akademia e Romës ka ardh vizitë me

profesora, me studentë me pa se si duket Akademia e Arteve të Zagrebit, dhe kta mandej kanë shku në Zagreb, në Romë. Kur ka ardhë njëri prej profesorave aty në klasë, t'u punu në atele dhe ky studenti i im që ka shku atje edhe t'u punu i afrohet ky profesori, tash me kureshtje me pa çka po punon ky studenti.

Jugosllavia kishte 22 milionë, i kishte gjashtë Akademi dhe e pyet këtë studentin, e sheh që ky studenti e ka kry punën shumë bukur, po udhëheq shumë bukur këtë grafikën, a din, dhe tash profesori po e pyet, thotë, “Prej cilës Akademi vjen ti të Jugosllavisë?” Domethonë a të Beogradit, a Zagrebit, a Lublanës, të Shkupit, a të Sarajevës. Tha, “Unë profesor e bona një intermeco shukata njëherë edhe e mendova”. Thashë [me vete] për çka po më pyet tash? A për mirë a për keq? Me thonë prej Prishtinës bon vaki s'i pëlqej, bon vaki që keq me ra prej Prishtinës. Edhe dikur tha, “Prej Akademisë së Prishtinës”. “A?” Tha, “Shumë bukur”, po ma rreh krahin, “Shumë bukur, bravo.” Tha edhe unë tha (qesh) e morra veten tash, po e shoh veten pakëz u shlirova me ato se.

Kështu që, ajo çka kishin msu studentat tonë, ne çka ju kishim dhonë ishte shumë e sinqertë dhe lavronte, e lavrojshin edhe vet studentat. Kështu që, nuk kemi kursy fare dijen që me ja dhonë studentit që të arrijnë në këtë nivel. Se thojshim, thojsha me veten time, “Po ta kom një studente të mirë, po ta kom një student të mirë bohem edhe unë ma i mirë. Kur e kom një shoqëri të mirë, është i fortë, bohem shumë ma të fortë, në art të grafikës bohem shumë ma të fortë”. Gati se ashtu doli. Atë çka e kom pasë në mendjen time ia kom tregu studentit.

Kolegu që punojsha me to serb, punojshim në kushte në baraka si qysh të spjegova, por përveç se ishim në baraka mundesh me marrë me mend me punu me një klasë, me një barakë edhe profesori shqiptar edhe profesori serb me studentat e vet. Kjo u konë veç... katastrofa brina nuk ka ma keq. Por, prapë vullneti për me bo diçka mirë, për me ia dalë. S'mujshje ti me prit kushtet të jashtëzakonshme tash, “Du ndërtesën, du une kto”. Kush bre don? Kush po ta jep? Ku i ki? Nuk ke me çka. Kërko. Na kërkujshim, por ato kushtet ishin çfare ishin atëherë.

T'u dalë prej klasës kolegu serb po më sheh mu me gjithë studentin për të cilën e zura në gojë qitash. Sa ishte student po donte me shtyp pllakën, se kishte punu qe dy, tri javë në pllakë, por nuk e dinte si do të manifestohet {bën me gisht nga grafikat e tij në sfond}, çfarë ndryshimi ka kjo me atë. Dhe i thashë, “Tash koka bo shumë bukur, koka bo gati për m'u shtyp. Merre edhe shtype e po të pres”, procedura nja 15 minuta deri sa të shtypet. Ky kolegu po ma bon, “Hajde Fatmir, koleg po shkojmë se u kry ora”, thashë, “Qe deri sa ta shtyp, se ka punu dy javë ditë e po du me ditë edhe unë se çfarë rezultati po del në punë”, e kishim meditu se qysh me dizajnu atë ide.

Ky studenti e shtypi, e nxurr ekzemplar in edhe po e qet në tavolinë edhe unë po e jap vlerësimin si shumë të mirë. Vetëm tash, ajo ishte shumë e mirë nuk ka skej edhe kurrë nuk u ngijsha, nuk u ngopesha me atë që është mirë, por ta kërkujmë edhe diçka ma mirë. Edhe i thom atij studentit, “Shumë e mirë është, por qitu puno, lavro edhe diçka e të bohet shumë e mirë”, “Po, profesor”, “Në qito mos e shtyp, por edhe pak punoje qito del e shkëlqyshme”. “U bo”.

E kemi lonë klasën, jemi dal me shku në sallë të arsimtarëve. Ishte ajo rruga me bagrema qysh ishte përpara, nuk di a të kujtohet. T'u shku rrugës te një bagrem u pshtet dhe i ka qit durt {i kryqëzon duart} ma boni serbisht ai, nejtash s'po flas serbisht, tha "Qysh bre koleg? A krejt çka mëson ti në atelenë tone, e çanë kokën e u ofron studentave bukë të gatume?" Thashë, "Pse çka ka të keqe Zoran?" "Ruje pak veten". Tha, "Mos ju trego gjithçka. Këto sendet e tuja interne ruji për veti. Ti i ki fitu me ndjersë, me intelekt. Me ju tregu gjithçka..."

Thashë, "Zoran ky student që ka ardhë, ka bo kërkesë te Fatmir Krypa me ardhë me mësu grafikën, a mund ta mëson grafikën me qito kushte? A shiqon në bibliotekë te na çka ka? Kurgjo nuk ka për artin e grafikës, e ka Rubensin, e ka Rembrandtin, artin klasik të grafikës, por artin bashkëkohor të grafikës s'ka fare në bibliotekë. A ka muze ktu? A ka galeri ktu?" Ishin atëherë, as Galeria, as Muzeu. Thashë, "Prej kahit ka me mësu ky, a prej qiellit ka m'i pik dija atij kur s'ia tregoj unë, kur s'ia tregon ti." Tha, "Ki me pa, kurr s'ka me ta ditë". Thashë, "Mos t'ma din more ai, punë e madhe. Çka ka lidhje? Diku rrethi, dikush ma din, s'është qare". Sikur ai që ka thonë prej Zagrebit në Kosovë edhe në Kosovë e din kush i jep ndoshta edhe e ka marr vesh. Ndërgjigja ime, ai kërkesën p'e shkrun 'E du me msu grafikën te Fatmir Krypa' edhe unë pe di se qysh bohet kjo, qysh bohet ajo edhe nuk i tregoj, po e mshefi.

Tash kur e shiqon njeri artet diskrecion i msheftë është, e vërtetë është. Për art ti s'mundesh me ditë fort qysh e ki bo bre. Muslim Mulliqi më pyti për atë kanaqen e asaj malësore {bën me gisht lart nga vepra}, më pyti në ekspozitë kur e kisha ekspozu, "Hajde bre tregom qysh e ki bo për Zotin, qysh e ki bo? Shumë interesant." Tha, thashë, "Hajt bre profesor ti ki me punu piktura, leji, kur të munesh me punu grafika vi të tregoj. Leje hiqju asaj hajgare". Nejtash e murrem qashtu si hajgare.

Studentit mos me ia tregu fshehtësistë ishte gjynah, mëkat i madh, se s'kishte ku me pa, ku me ni, s'kishte ku me shku. Ishte e konzervume Kosova, s'kishte ekspozita që vishin. Ku me pa? Kështu që... Kanë bo numër, kom ni numër nuk du me përmend me emra, se ata janë atje, janë mjaftë, m'vijjnë pushimeve më vizitojnë, kanë dëshirë t'i evokojmë disa gjana, raportet profesor-student, profesor-profesor, tash krijues jemi të barabartë dhe artin me çu përpara.

Erëmirë Krasniqi: Qysh i keni pasë raportet me serbë në atë kohë ose gjatë ktyne viteve po më intereson, në këtë nivelin profesional qysh ka funksionu ajo?

Fatmir Krypa: Po, raportet kanë qenë si të thom të krijuesit ma fleksibil.

Erëmirë Krasniqi: A keni pasë ekspozita të përbashkëta?

Fatmir Krypa: Po ekspozitat kanë qenë të përbashkëta gjithsesi. Pa ndonjë serbë aty, bilë një numër i përfaqërt me numrin e banorëve një me katër, një me tre. Ashtu kur kishte, kur s'kishte, s'kishte, pa e shti edhe ndonjë turk, ka qenë një Fefzi, Fevzi Tüfekçi, Fevzi Tüfekçi ka qenë prej Prizrenit. Kështu që, ishte një numër i konsiderushëm edhe prej Prizrenit që kishim ekspozita, ishim piktorë, skulptorë, grafikë edhe kështu që në saje... nuk do të thotë je në pikturë njësoj, por në përgjithësi në numër që merrshim pjesë nuk e kqyrshim sa ka grafikë e sa ka piktorë, s'mujsha m'i bo barabartë, por në numër përgjithësi pa tre, katër serbë nuk kemi shku me naj ekspozitë dikund.

Erëmirë Krasniqi: E këto shkëmbimet kulturore...

Fatmir Krypa: E këtu kemi qenë kështu edhe ndërmjet veti kemi pasë tolerancë, për shembull kur ka ardhë puna me dhonë ndonjë shpërblim, la kanë dhonë ndonjë shpërblim edhe pse e ka ditë që është i filanit e po e meriton. Nuk ka qenë ndonjë bllok paragjykimi, ky është për këtë e ky është për këtë edhe me pasë inat, ky është i kësaj apo i këtij kombi. Na ato pak a shumë i kemi pasë tejkalu, politika na ka pasë tejkalu, politika na ka pasë tejkalu. Ka qenë lidhje e komunistëve atëherë që s'kanë lonë me hi ksi bungaja me thonë ti ktu naj fjalë, jo. Të gjithë kemi qenë parti atëherë e ajo parti ka qenë e një zëri. Kur ki punu në arsim të gjithë kemi qenë në parti, të gjithë e kemi pasë një mendje, me ngrit nivelin e kulturës, e arsimit, e civilizimit, t'gjitha, qajo ka qenë. Kështu që, me pasë inate mos me ia dhonë, aty nuk ka pasë ndarësi, jo nuk ka pasë ndarësi.

Bile, më kujtohet qiky Zorani kur u martu vetëm mu më ka thirrë prej të gjithë shokëve, prej të gjithë kolegëve, prej të gjithë afërsisë çka e ka pasë, motrën e vet, nonën, babën, mu. Edhe s'kom lonë gjo pa i dhonë kritika, i jepsha kritika, por e merrke, e gëlltitke si të mirë, se kurr s'i kom dhonë si me thonë kritizere me thumbim, kritikë me ja nënçmu punën, me ja çvlerësu ndonjë gjest, kritikë për përmirësim kolegu kolegun që ka qenë e mirëseardhun çdo kohë shoku i mirëfilltë, anëtari i mirëfilltë i shpisë të jep kritikë për me mujt me përmirësu gjendjen, *status quo* edhe kur të mendon për të mirën e tij.

Kështu që, e kemi pasë një bashkëpunim të ndërsjelltë dhe gjatë studimeve aty nuk e kemi vërejt shumë se nuk na kanë lonë ndoshta atmosfera me u dallu shumë edhe vet nuk jemi dhonë ma u dallu shumë. Kemi hi, ndoshta nuk të ka pëlqy ndonjë thanje, ndonjë diçka që nuk e kemi me bo domethonë kontrimin, reagimi me të ashpër që me u ofendu se tash dy shqiptarë janë me dy fjali ashpërsohen mendimet, ngriten tonet edhe ti thu për çka u bo, për kurgjo send edhe ne bonim aty politikë si studenta, politikë që mos të idhnohem njeni me tjetrin, ta rujm nivelin e kulturës, ta rujm nivelin e artit, të fitojmë sa ma shumë nga kjo edhe kështu që kur të vijmë në vendet ku do të veprojmë ta kemi njëfarë...

E pash në Facebook një shok i pikturës, pikturat ia pashë në Facebook kur kom qenë i gjeneratës sime, para një javës ia pash çka po punon. Mu duk që kish ndryshu ai po se po, por me pa artin, me pa edhe shpirtin e tij, shpirtin e tij edhe shpirti i artistit shifet në art. Çdo vijë, çdo detal kur të merr e analizon që ki kohë, psikiatri gjonë shumëçka. [Skender Boshnjaku](#) është neruropsikiatër, e din, e njef doktor Skenderin? Ai shkrunte për ekspozita, ka qenë kritik, shkrunte për ekspozita, bonte vlerësime, hapte ekspozita në Galeri, po, Skenderi ka qenë i përherëshëm. Ai të analizon shumë bukur, shumë bukur edhe si artist edhe si njeri kur ta shiqon temperamentin, të gjitha. Kulturën, të gjitha t'i vlerëson, të bon me kuptu se a të lexon në tekst, a të lexon në forma, në vija, në ngjyra ato tek artisti.

Dhe kështu ne e mendonim këto që ta pasqyrojmë dhe pata fillu që si krijues të marrë një iniciativë, përveç këtyne ekspoztave që i bojshim të përbashkëta, të bojmë edhe ekspozita personale dhe këto ekspozita personale të jenë si me thonë pasqyra ma e madhe të jetë e artit tim. Njëheri të marrë pjesë, jo si arti i kulturës kosovare që merrshim pjesë si grup, por të marrë pjesë si individ si po më presin.

Merrsha pjesë nëpër konkurse të artit të grafikës nëpër krejt Evropën e Botën. Kom marrë pjesë prej Japonisë e nëpër Evropë krejt, në Amerikën Latine. Kështu që, kom qenë prezent në shumë ekspozita, bienale, trienale, anale nëpër Evropë, kom... kom katalogjet mujm m'i pa, janë një numër i konsiderushëm.

Pjesa e Gjashtë

Erëmirë Krasniqi: Tregonani për këtë ekspozitën që e keni pasë në Shqipëri edhe për këtë bashkëpunimin kulturor që ka ndodhë në të '70-tat. Qysh keni shku? Çka keni pa atje? Çfarë përvoja ka qenë?

Fatmir Krypa: Po të them të vërtetën, ne kishim vetëm atë çka na ofronte televizioni, shtypi, nuk kishim qasje në shtyp. Shtypi kishte vetëm dy fletë, “Zëri i popullit” katër faqe, dy fletë i “Zërit të Popullit”. Nuk kishim informata për artin e tyre, vetëm atë çka mund në mënyrë vizuale, kur bohej promovimi i ndonjë shtatores ose monumenti i pavarësisë kur është inaguru e kemi pa në televizion edhe sa ki pa ti kom pa edhe unë, e kemi pa të gjithë. E kom vlerësu sa e kom vlerësu prej ekranit, a ndryshe kur shkojsha e shifsha Monumetin e Pavarësisë oooo {onomatope} kjo ishte vepër, kryevepër. Ti shihshe ato muskuj, ato fuqi arti që i kishin shterrë ata skulptorë, t'i shifshe aty në vendin e ngjarjes. E kështu që, pikturat ma pak u prezentoshin, vetëm këto që s'kishin qare kur u promovoke, inaguroke ndonjë shtatore e ndonjë heroit, aty ti mujshe me i pa.

Kur ne ishim në Shoqatë edhe atëherë rastsisht në bisedë e sipër, “Po e bojmë një ekspozitë. A e bojmë një ekspozitë në Tiranë, more? Po pse s'e bojmë? Çka ka të keqe na me marrë telefonin qitash edhe me marrë Ambasadën e Shqipërisë në Beograd dhe me pyt numrin e Galerisë të Arteve të Tiranës me na dhonë edhe a mujm me bo këtë ekspozitë”. E marrim ambasadën, ambasada na përgjigjet shumë bukur, thotë, “Ide shumë e mirë, por duhi të kontaktoni me Galerinë e Arteve të Tiranës”. Ata ndërkohë i kanë bo krejt këto bisedat Ambasador-Ministër i Kulturës të Tiranës - Galeria e Arteve të Tiranës aty mrenda minutave i kanë bo këto biseda. “Shif se tash do të ju thërrasin artistët nga Kosova dhe do të ju pysin për këtë mundësi” dhe ne e marrim Galerinë e Arteve të Tiranës në telefon.

Galeria e Arteve thotë, “Po si, kurgjo të keqe nuk ka, kjo Galeri, idea shumë e mirë me ardhëna me një ekspozitë me bo në Tiranë dhe procedurat, procedura normal vizat nga Ambasada e Tiranës edhe na tregoni ditën kur do vini neve ju garantojmë një termin, një sallë”. Aty edhe ne shkojmë i marrim vizat dhe të gjithë i kanë marrë vizat vetëm unë jo, unë s'e kisha pashaportën e vazhdume. Unë pres ata shkun me automjet, me kombi, me vepra të artit, me ekspozitën komplet. Ishin Nuredin Loxha, [Shyqri Nimani](#), Agim Çavdarbasha, [Rexhep Ferri](#), unë, [Blerim Luzha](#), tash s'po m'kujtohen bash, bash krejt emrat, por po thom këta kemi qenë dhe Nuredin Loxha, po e përmenda. Kanë shku të gjithë me automjet, me automjete, Nuredin Loxha me automjetin e vet u dashtë me mshel me lonë para Dajtit,

Hotel “Dajtit”¹² edhe mos me lëviz fare deri në ditën kur të kthehet, me mush me benzin edhe m’u kthy curril, jo me shetitë me kerr të vetin, jo jo. Ata krejt e kishin agjendën me përcjellsa, me vetura, me krejt, e unë u çmenda si nuk po muj me shku.

Rastësisht kaloj ka korza, shoh motrën e Rexhep Ferrit, Besën. Po më thotë, “Fatmir po më vika keq që...”, kish marrë vesh që unë nuk po shkoj prej vllaut të vet Rexhepit, që unë nuk po mundem me shku, pse nuk e kisha punën e pasaportës të vazhdume, u deshke edhe një ditë me vazhdu disa minuta edhe me marrë drejt me shku, por unë se kisha kqyr t’u menu se e kom në rregull. Ata e kishin në rregull, e kanë dhezë kerrin shkunë në Beograd, janë ardhë edhe e kanë kry punën. Tha, “Po, shiqo” tha, “ekziston një mundësi” tha, “shiqo në ‘Putnik’ se ka lidhje ajrore me aeroplan nëpërmjet Beogradit dhe Tiranës, ditën e mërkure”. Edhe unë si isha në korzo te Hotel “Bozhuri”¹³ atëherë, aty ka qenë një zyre e “Putnikut”, agjensionit turistik “Putnik”.

Ata kanë qenë për udhëtime dhe e shof atë djaloshin tu e mbyll zyren, po thom, “Ngadal, ngadal” thashë a di, ishte serb a di, “se kom me të pyt diçka”. Tha, “Urrno?” Thashë, “A ka aeroplan prej Beogradit për në Tiranë?” Tha, “Po”. “Kur?” Tha, “Ditën e mërkure”. Thashë, “U shumë bukur, ditën e mërkurë. Po bileta?” Se aeroplan i vogël gjashtë veta kemi qenë, shtatë, gjashtë veta, një stuardest, piloti. M’i pasë dhimtë kryt pilotit m’i thonë, “Hajde ndrrom!” (qesh) Dikush tjetër, s’kishte. Kur e kom pa aeroplanin (qesh) jom tmerru, një aeroplan i vogël me dhjetë veta edhe nejtse unë e morra pasaportën, shkova në mëngjes herët për me nxerr vizën në Beograd, shkova me tren që mos të më dështoj najfar autobusi.

Me tren mrrij në mëngjes herët atje në orën dhjetë, shkova menjëherë, në pesë e gjys më la aeroplani. Shkova e morra, në orën shtatë ambasada hapej. Prita deri sa të hapet ambasada, u sillsha kur u bo ora shtatë i rash ziles edhe doli dikush aty prej ambasadës, “Urnoni, çka kërkoni?” Ishin të informum se shkoni dikush ktu se i kisha informu në Galerinë e Arteve të Tiranës se unë do të vij me aeroplan prej Beogradit në aeroportin e Tiranës me më dal dikush me më prit.

Kështu që, unë aty e morra çka kishte procedurë të pasaportës, atë vizën dhe ambasadori po më thotë këto që e përmenda parëz tha, “Mos u habit” tha, “do të habitesh se ‘Rilindja’ e ju j do të del” tha, “36 faqe” tha, “e ‘Zëri i Popullit’ i ynë” tha, “katër faqe ka”. Thashë vetmeveti, “Lshom se s’kom kohë me bisedu për ksi tema” a di, edhe i thash, “Këto gjana si në dy faqe si 36 faqe varet çka shkruhet në to”. E menojsa veç ama qat letër, a ja ki qit vulën se po më ikë aeroplani. Thashë, “Zotni Ambasador, po më ik aeroplani”, aty me taksi unë, jo me autobus, po me taksi deri në aeroport të Beogradit. Aty hypa në aeroplan kur e pash aeroplanin edhe aty mandej na kanë prit shokët që ishin nga Kosova që shkoni atje edhe e bom ekspozitën në Galerinë e Arteve.

¹² Hotel Dajti ishte një hotel në qendër të Tiranës, Shqipëri. Mbante emrin e Malit të Dajtit aty pranë, ishte qendra kryesore për vizitorë dhe diplomatë ndërkombëtarë gjatë periudhës socialiste të Shqipërisë, është blerë nga Banka e Shqipërisë dhe aktualisht nuk funksionon si hotel.

¹³ Hotel Božur (Bozhuri), një pikë referimi në Prishtinë, ishte një ndër hotelet e parë në qytet. Sot, ajo është shndërruar në Hotel Swiss Diamond në Bulevardin Nënë Tereza.

Ekspozita qe aq e mirë, qe aq e pranushme, që aq e theu akullin... Ishte një, nuk e di, për shumë gjana kom pa ekspozita edhe kom pasë emocion në hapje të ekspozitës qoftë grupore, qoftë personale, por sikur në atë ekspozitë nuk kom qenë i emocionum. Thojsha si duket ajo Shqipëri? Si duket ajo atdhe? Si duket ajo Galeri? Si duken ata njerëz? Si duken ata piktorë? Si duken ata... Çdo gja ishte në nivel, çdo gja ishte e mirëpritun, çdo gja ishte në mënyrë të kulturume, mirësjellje dhe ne e prezentum, këta kolegët që ishim prezent artin që e realizonim në atë mënyrën tonë ma të mirë të mundshme.

Erëmirë Krasniqi: Shumë ma ndryshe, ka qenë shumë ma ndryshe se arti që ata e kanë bo në atë kohë. Ata kanë qenë në realizëm, ju shumë ma modern...

Fatmir Krypa: Po, bile pakëz pat një vërejtje te “Malsori”, te një tjetër malsor, por e ka pasë shpinën e kthyme. “Pse me shpinë të kthyme?” Ma bojshin, po qe ajo atje {bën me gisht nga punimi} për shembull, kqyre, thojsha, “Ai është tu vrejt afishjet e një vendi ku qiten pllakatat, ai po i vren gjërat të cilat po i shef, e nuk mundet me i pa tu të shiqu ty, me kthy kokën e ti me vrojtu mbi qafë”, atë spjegimin ishte pak e çuditshme, por ja se ishte më se e vërtetë edhe ajo ju dukej pak sa abstrakte megjithëse çdo gjë ishte reale, ai shalli, ato detalet, çdo gja ishte reale. Por pse me u kthy mbas? Por nuk mundet me pa ndryshe. Qysh e shef ti? Qysh e bon ti? Ti nuk mundesh me bo në profil e me pa ato.

Ishte pak edhe unë i dhash një mbështetje por ashtu ishte. Ishin gjanat pakëz të pakapshme, megjithëse ata e dishin si artista se e vërtetë që ashtu duhet, por do ishin prej politikës ma të lartë, “Pse kanë bo kësi gjana?” Kësi arti me pranu, që ishin baba i Edi Ramës, Kristaq Rama ishte sekretar për kulturë. Baba i Edi Ramës ishte edhe më i gjatë se Edi, Kristaqi ishte, ishte... edhe masandej i dhamë spjegimet tona ato që ishin. Por, ajo ishte nga dy anët ekspozita shumë e pritun, e mirëpritun aq sa vizitorë ka pasë shumë, shumë ka pasë edhe në hapje edhe gjatë tonë kohës sa ka qëndru hapun një muj ditë ka qenë. Na kemi qëndru ndoshta nja dy javë kemi qëndru edhe gjysma kem kthy, krejt kem kthy, Agimi [Çavdarbasha] nejtji, Rexhep Ferri ndejti për shkak e kish vllaun edhe thash, “Valla mu nuk po më shkohet” thashë, “po më rrihet edhe një javë”, thashë...

Erëmirë Krasniqi: Mjshje me zgjat qëndrimin?

Fatmir Krypa: Po, po edhe Shqyriu [Shyqri Nimani] ndejti se e kishte nanën, tjerët u kthyn me Nuredin Loxhën se ai ishte me veturë e ata u kthyn. Kështu që, ishte njëfar situatë pak ma ndryshe prej ekspozitave tjera. Kur u bo Java e Kulturës në ‘96-97, atëherë kemi shkru, Java e Kulturës Kosovare, muzika, koncertet, drama me disa pjesë teatrale të teatrit, kem shku na me ekspozitë të madhe disa krijues me ekspozita personale kem shku dhe kem shku me ekspozita të përbashkëta, disa veta. Kem shku Muslim Mulliqi me ekspozitë të përbashkët të pikturës, ka shku Agim Çavdarbasha me ekspozitë personale të skulpturës, ka shky Shyqria me ekspozite të dizajnit personale edhe unë ju bashkangjita me një grup të piktoreve.

Kështu kemi shku edhe pesë piktorë edhe unë. Kështu që, kemi bo një grup bukur i madh i artistave nga Kosova me të gjitha zhanret edhe ajo ka qenë një, një manifestim, s’din goja me tregu. Aty është ra muri, aty ka ra çdo gja ka qenë domethonë e pacenzurume, domethonë çdo gja veç shkante mirë e ma

mirë. Bile Batoni [Haxhiu] ishte organizator, po më thotë, “Ti prite si ma i vjetër atij grupi piktorëve ma të ri, prite Sali Berishën”. Vinte Sali Berisha, kryetar ishte, ishte kryetar i Shqipërisë atëherë edhe vinte me të shoqën në hapje të ekspozitës edhe dola unë si ma i vjetër prej atij grupi që isha edhe pjesëmarrës në atë ekspozitë, në atë grup me prit Sali Berishën në mirëseardhje aty ku është ai mozaiku i madh në galerinë kombtare aty.

Dola përpara se u deshke, se nuk kishe aty, bukur larg atje. E prita, e përcjella mrenda, ia skjarova ato, ja sqarova ato masandej me Batonin Haxhiun, me një grup piktorës u mbledhëm edhe, edhe Sali Berisha me një që e kishte të kulturës aty bisedonim për ecurin e punës, të mbarvajtjes si ka shku e, si po realizohet e, të gjitha ato edhe qëllimet e kësaj çka po bohet, shumë mirë që aty i ra, se s’kishte politikë aty, çdo gjë ishte transparente për art dhe në të mirë të njerëzimit, në të mirë të bashkëpunimit, në t’mirë të afrimit, të afrohemi disi në ndonjë mënyrë.

Edhe kjo ekspozita, kjo e dyta ishte shumë bomb ishte për në atë kohë dhe besoj që unë kom pasë terminin me bo mas ekspozitës që kom pasë në Shkup, mas ekspozitës që e kom pasë në Tetovë, muzeu ma pat dhonë terminin vitin e kalum në mars, në prill edhe me bo por, për shkaqe shëndetsore e pata bo operacion në sy edhe e bona një prollongim. Tani kom mbet me bo kërkes, megjithëse mjetet mu kanë nda, qëndrojnë akoma në Ministri të Kulturës, duhet ta bëj një kërkesë përsëri Galerisë së Arteve të Tiranës, Muzeut që për këtë vit të ma ndajnë një termin që ta boj edhe një. Kom shumë koleg, kom shumë miq, kom shumë adhurues i kom te Facebook-it që presin artin e grafikës ta shofin.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ju kanë largu prej punës në vitet e ‘90-ta? Qysh erdh deri te qajo klimë politike? Qysh ju detyrun me u largu nga aty?

Fatmir Krypa: Po si çdo kund edhe te ne në Fakultetin e Arteve fillun këto reprocialet e rezhimit të atëhershëm, indikacionet që të bëhet diçka ma e mirë në mënyrën e tyne dhe insistonin që ne të përkuleshim punës të një drejtimi edhe në pikëpamje arti edhe në pikëpamje pedagogjike. Po i njëjti koleg me të cilin kom studiu që thashë ma parë, i cili askend s’e ka thirr që thash në martesën e tij, kolegun me të cilin kom bashkëpunu, e kom nda një klasë së bashku, gjysën e klasës ai, gjysën e klasës unë. Kolegut të cilit ja kom majt ligjeratat një vit dhe ai ka marrë rrogën dhe ka shku në studime, për studime kështu me kriju art, i thojshin si me pasë një parapërgatitje për ekspozita personale.

Erëmirë Krasniqi: Si hulumtim artistik?

Fatmir Krypa: Hulumtim artistik, ashtu diçka. Një vit, një vit me ja dhonë me pages Fakulteti, por duhesh me gjetë zavendësin. Po më pyt, “A e manë mësimin, a mi man ligjeratat?” Thashë, “Po bre, sot unë ti maj ty, nesër ti m’i manë mu edhe çka ka të keqe, shko”. E boni kërkesën, ju aprovu, shkoj, e murr një vjet hulumtime, çështje hulumtuse për art edhe mu përgatit për ekspozitë personale, me bo shëtitje andej këndej nëpër vende të ndryshme. Dhe vjen puna e provimit pranues sa studenta mi pranu dhe vjen m’pyt mu në sallë të arsimtarëve.

Ne rrishim në karantinë prej orës tetë deri në ora dymbëdhjetë e tridhjetë, sa zgjate msimi, por rrishim në karantinë kështu në klasë, veç mujshe me pi një cigare, me bo një muhabet, eventualisht ndonjë gru bonte kafe, me na pru ndonjë kafe. Me bo me dal jasht ndërtesës e ndërkohë me pru letrën për me u nënshkru, ata e bishin sot në tetë, ditën tjetër në dhetë, ditën tjetër në nimdhetë, ditën tjetër në nontë. Nuk u dike kur e bibe letrën mu nënshkru, të gjithë ne që ishim aty u dukte me nejt aty si në karantinë, patjetër, pate s’pate punë, s’kishim ligjerata kurgjo, hala s’i kishim pranë studentat. U dukte me ardh se kishte fillu viti akademik, por na u dushim me ardh aty prej orës 8:00 deri në 12:30.

Vjen ky kolegu Zoran Jovanović dhe e çelë derën... nga turpi se s’mundte me i pa kolegët e vet ashtu me i pa ashtu qysh rrishim ne si për gjyna. Profesorat, me ka sa vjet punë rrishim si për gjyna, eventualisht naj lojë shahu me pasë shumë durim me lujt naj lojë shahu me kalu kohën. Më thotë tash mu, “Sa studenta po i pranojmë sivjet në grafikë?” Thom, “Si zakonisht, qysh i pranojshim në gjuhë shqipe në grafikë tre ose katër, në serbisht një”. Po thashë, “Ti mundesh mi pranë edhe dy në serbisht”. “bre” tha, “hala” tha, “ti po menon ti me atë {rrotullon gishtin} procedurën e dikurshme?” Tha. Tha, “Një me dy, një me katër” tha. Thashë, “Zoran,” thashë, “Qeshtu i kemi pranë, qeshtu është popullata” thashë, “struktura” thashë. Thashë, “Ti pranë dy, për mu tre, ti dy edhe u kry puna në vitin e parë”. “Çka po menon ti?”

Thashë, “Qysh bre po sillesh kështu me mu, si m’u konë tu u sill” thashë, “me një derr? Po a e din që ta kom majt shpirtin” thashë, “një vjet? Me paret e mia ti ki nejt në Beograd, ki bredh nepër Evropë poshtë e naltë edhe unë ta kom majt msimin” thashë, “ti i ki marr paret” thashë, “ki shetit” thashë, “si zotni” thashë. Qysh nuk të vjen turp?” Ja kom kap qitu pak {prek fytin} vetëm e kom prek, thashë, “Qet’ gushë ta kom ushqy” thashë, “një vjet me pare t’mia” {ngrit gishtin tregues}. “U” tha “Çka po ma prek dorën, tap. Tash ki me pa” tha, “ti!” Thashë, “Kadale çka u bo?” Thashë, “Qitash ki me pa ti”. U shku në sallën ku ishin ata komisioni i ksaj që u bohke interne për me shkru këtu.

Erëmirë Krasniqi: Të rishikimit të punëtorëve a...?

Fatmir Krypa: Jo, jo ka qenë njëfar grupi që i monitoronte pedagogët tjerë a po vijnë a s’po vijnë, si Këshilli i tyne.

Erëmirë Krasniqi: Për masat e dhunshme?

Fatmir Krypa: Për masat e dhunshme, Këshilli i Masave të Dhunshme, ky ka qenë anëtar i Këshillit të Masave të Dhunshme. Kur ka shku te këshilli ka thonë, “Fatmirit shkruja *rraaak, rraaak, rraaak* {onomatope}” dhe unë aty meniheri e kuptova me atë reagimin si e boni tash çka m’pret. Ulem qaty në mes të kolegëve edhe po më vjen pastrusja të cilën e kisha marr në punë une si dekan. Po vjen me një facikëll, me një libër n’realitet edhe mu nënshkru aty që e morra edhe me një letër aty që ma kishin dhonë për suspendim edhe tha, “Profesor” tha, “më fal” tha, “a bon me nënshkru qito?” Thashë, “Çka është kjo?” Kisha s’pe di unë, a di. Tha “Ky profesor a di”, thashë, “Bjere, bjere hajde”. E nënshkruva edhe shkoi ajo. Thashë, “Shokë, kolegë ju vazhdoni sot deri nesër kur të jeni jeni, por unë shkova”. Të parin e patën qit Muslim Mulliqin, i dyti une dola.

Kështu mandejna e vazhdova punën me aktivitetin tim. Në Qafë e kisha katin e 13 një atele timen 24 metra katror, 24 metra kanë qenë një pjesë edhe nën kulm edhe e pengonte ajo, domethonë me marr njëzet metra katror. Ku bohet atelea njëzet metra katror? Në atele aty u dukte me qënë një banjo e vogël, u dukte mu konë me zi diçka aty. Me punu, ku me punu? Presen ku me lonë, tavolinën ku me lonë, një kauq me të ardh një shok me dit ku mu ulë, veç qaty i pata bo menxi, u bo mirë. Filloj viti i ri akademik. Ju thom studentave një grup viti i dytë ditën e hanë, viti i tretë, se prej vitit të dytë i merrshim na, viti i parë i përgjithshëm u konë një profesor i majke krejt grupet, unë i merrsha grafikën vitin e dytë. Vitin e tretë ditën e mërkurë, ditën e martë, viti i tretë ditën e mërkure dhe thashë, “Secili n’qoftëse ka diçka mundet me nejt edhe ditën e ejte me vazhdu punën”.

Qito pllakat e zinkut u desht me ju dhonë, s’kishin. Krejt materialet ato pigmentet, acidet u desht me ju dhonë. Me ju bo dimrin verë, dimrit me ju bo nxehtë, me ja u nxehtë atelenë me radiator harxhojsa rrymë. Por kush po të vetë për atë punë? Krejt këto dijen që ju thashë është ma e vogla, tu mos e kursy as energjinë e fundit të atomit dhe ashtu përfundoi viti i parë, viti i dytë, viti i tretë e kështu me rradhë.

Dhe ishte një befasi kur një vit po vijmë, kur boni me kris lufta qatëherë në vitin ‘99, po vjen Ambasadori Amerikan për Marrëdhanie me Botën e Jashtme për Evropë dhe Azi, se i ndajnë këta, është një në përgjithësi Ministër i Punëve të Jashtme edhe njo për Evropë dhe Azi i kanë kontinente i ndajnë, ata janë si ndihësa. U ardh te Rugova, tek kryetari Rugova i thojshim, kanë bisedu, kanë hangër drek edhe mirë krejt. Kur u ardh herën tjetër, po vjen mas dy tre mujve po më thirrin këta të LDK-së, Adnani. “Fatmir,” tha, “ku e njeft ti këtë Ambasadorin?” Thashë, “Jo valla nuk e njoft, por vetëm e kom pa në televizion. E kom pa” thashë, thashë, “s’e njoft fare”. “Jo more ai ka lyp me ardh në atele te ti” tha, “me të pa” tha, “mu njoftu” tha. Ka shkru tha, “Du me vizitu atelenë e autorit, e Krypës, e profesor Krypës dhe të njifem personalisht me te”.

Thashë, “Jo more”, nejtse, tha, “Kur mundesh me na pranu?” Thashë, “Jo bre, por nuk ka problem pranimi” thashë, “qysh me bo unë termin, po kur mundeni ju me ardh?” Tha, “Na hajmë bukë në orën tre, e në tre e dhetë minuta na ki aty”. Qafa me restorantin “Ora” treqind metra, tre-katërqind metra, dhetë minuta me ardh në kom edhe kanë hangër drek. Janë ardh në atele, Skender Hyseni... m’i çunë përpara nja tre bodigarda. “Nji,” tha, “profesor” tha, “duhet me nejt qitu mrenda”, thashë, “Po more, rri”. “Tjetri” tha, “te lifti poshtë, te lifti nalt, {tregon me gisht kahjet} te hymja në lift nelt, ka njo poshtë e nalt”. Tjetri tha, “Ku me nejt unë?” Thashë, “Rri te dritarja qaty”, ishte presja te dritarja thashë, “Pshitetu qaty te presa, s’ki ku me nejt” thashë, “këta le të vijmë le të ulen qitu”, thashë, “s’kemi vend”, nejtse.

Si u ardh në derë prezentohen ata amerikant qeshtu. Tha, “Unë”, tha, “e kom nji dhuratë, një grafikë të kujmë që ma ka dhuru kryetari Rugova para kësaj rradhe, para tre mujve edhe e kom kornizu, e kom shti në shpi, e kom qit në dhomë të ditës. Ma kanë pëlqy kolegët, miqët, ma kanë pëlqy familja, më pëlqen mu” tha, “më ka pëlqy mu. Edhe kom ardh me u njoftu” tha, “personalisht me ju edhe me pa vendin ku është kriju ajo vepër”. “Kuku për mu”, thashë vet me veti. Qe cila ishte, ajo {tregon me gisht pikturën} e dyta poshtë, e dyta poshtë edhe kur thashë, qysh thashë thuj... ish Skënder Hyseni përkthys atëherë, ishte përkthyes i Rugovës.

I thashë Skender thuji, “Ardit Gjebrea thotë ‘Ja ku jam’ [këngë] artisti ja ku jam” thashë, “po, s’keni ku me hi” thashë, “këtu mrenda veç hajde hini hajerli koft [me fat], urdhnoni hini”. Ishte edhe sekretarësja e Ambasadës të Beogradit Elisabet Bonkovska quhej edhe këta ranë masnej, t’u fol t’u i pa vizatimet edhe ato grafikat e studentave ju qita. Thashë, “Nëse keni kohë pesë minuta” thashë, “dy-tre minuta” thashë, “edhe me i pa grafikat e studentave”. I kanë pa një nga një edhe po kqyren ftyrë për ftyrë, kadal-kadale, po flasin edhe thashë, “Skënder a bon me ju ndërhy unë me frengjisht?” thashë, “Mos m’i lonë shumë se paskan problem diçka me përkthi” thashë a din, “mos të nxerri telashe”. “Jo more, jo” tha, “le të flasin masanej përkthejmë”, “Ani mirë”, thashë.

Kur u kry tha, “Po kanë dëshirë me ta bo një ekspozitë ne Beograd me mujt që këto shpenzime, këto harxhime që po i bon për studenta me ta, me ta kompenzu pak”. Thashë, “Në Beograd me shku unë jo” thashë, “nuk kom” thashë “frigoj”., “Jo”, tha, “E ku m’i bo?” Tha, “Në ambasadë, në leximoren në *Čika-Ljubina* [rrugë në Beograd]”. Thashë, “U në *Čika-Ljubina* përdit kom kalu si student, i kom revistat e juja” thashë, “*Pregledin*’ që e shtypni në gjuhën serbishte për kulturë”, ajo u konë për art pamor e për krejt artet u konë “*Pregled*” quhej “Pasqyra”. “E ki marrë Pasqyrën?” Thashë, “Qe ku e kom”. I nxerra nja tri kopje i pata, “Qe ku i kom” thashë, “*Pregledat*” po ia qes njo ka njo, *tak-tak-tak* {onomatope}. “Aha, tash ma jep adresën ta çoj në shqip, tash shqip po i botojmë”, thashë, “Oo sa mirë”.

Nejse, ramë në ujdj që me shku unë në Beograd edhe tha, “Çmimet qysh i ki?” Thashë, “Çmimet për në Beograd i di çmimet, por po gjej një me çmimet e Kosovës po e boj një mes. Në Beograd e di që i boj në 600, 700, 800 e ma shumë” thashë, “këtu” thashë, “i shes 300, 350. Atje mi shit qeshtu 350, 400”. “Eh mirë” tha. U murrem vesh me shku, në rregull, me shku, me shku. Ajo u bo, jo... kërkova me shku me Edita [Edita Tahiri], thashë, “Edita,” thashë, “masi që po shkojnë” thashë, “edhe ju me ardh”. Katër veta ishin në veturë me shku bashkë, ishte kryetar Rugova, Adanani, Edita edhe shoferi, “Me ardh edhe une atje”, tha, “Jo, jo, jo nuk bon ti me aeroplan shkon anej”. Kur ajo krisi në Prekaz, u bo qajo qysh u bo, 24 orë që u luftun dhe situata u prish. Kështu që, mbeti ekspozita pa u hap edhe prej asaj kohës masanej metën marrëdhajet shumë të këqija me Serbinë dhe ekspozita metë pa u realizu.

Nuk e kom që m’ka mbet ajo se unë në Beograd e kom pasë ekspzitën, në Beograd ju kom shitë mend, e kom majt një ligjeratë në muze, më kanë thirrë, jo që kom shku vet. Më kanë thirrë me majt një ligjerat se e kanë majt për grafikë në vitin ‘70... ‘88. Në vitin ‘88 shumë situata e ndërlikime u konë, para se mu bo konfuze. Më thirren, muzeu më thirri me majt një ligjeratë. Por kur e kom pa emrin tem dy kat Fatmir Krypa *aaa* {onomatope} mu ka bo zemra mal, thashë, “Për qito hallal ju kofshim”. Me ‘y’ ma kishin shkru ashtu qysh e kom, me ‘y’ ma kishin shkru e mban ligjeratën në orën kaq. Po, prej orës kaq e man ligjeratën, këtë temë. Edhe mu ma çon Zoti, kur të don Zoti, por kisha bo edhe përgatitje, i kisha bo krejt përgatitjen qysh duhet me shtyp. E kom shtyp atë, atë grafikën atje {tregon me gisht lart në mur}, atë e kom shty e kto e ka pasë ble muzeu. E ka muzeu, e ka pasë ble edhe unë e morra me qëllim që me pa qysh duhet të shtypet, a din mirë. Po më thotë drejtoresha e muzeut, “Profesor mos ke emocione, se profesori nga Sllovenia mramë” tha, “i ka dështu grafika, ka pasë shumë emocione”. “Jo, more” thashë, “kom mjaft vite pedagogjike”. Por, tha, “Ai ma i vjetër se ti edhe i ka dështu shtypi”.

Unë a e din sa të fshir e kom ato për me shtyp, me më pa duhet një orë e 40 minuta me punu tu fol, tu mendu çka po flas midis të Beogradit edhe me dalë mirë. Kom mendu, i kom bo përgatitjet përpara, ngjyrat përpara, krejt i përgatita që aty mos me përzi diçka i bona krejt gati, krejt i kisha bo. Kur i kom pa profesorat e mi përpara atje, 200 e kusur veta. Por në nivel ishin emocionet dhe ai momenti, s'e harroj kurrë. Kur të shtypet grafika e kap prej fundit, ja qet letrën e qon përpjetë dhe ata e shofin ti nuk e shef qysh është shtyp.

Kur i kom ni shuplakat *rra rra rra* {onomatope} që s'po pushojnë a din, veç pak ja kom kthy {bën sikur e mban fletën me dy duar} e kom kqyr edhe unë unë pak vet (qesh). Thashë por, po dul, thashë, "O Zot qitu" thashë, "t'lumshit durte", kurrë s'i kom thonë vetit. Thashë, "T'lumshin durte edhe përvoja, që dul mirë për shumë gjana", jo për emër, ishin në pyetje edhe shumë, shumë gjana mas kësajna. Nuk u kqyrke mo si emër edhe si mbiemër, e si komb, e si gjithçka kqyrej. Doli mirë edhe po thom kur e kom pa emrin dy katë, gjashtë metra, e kishin hudh prej naltit poshtë. Emrin e kishin lshu dy metra të gjonë bezin. Thashë, "E shyqyr midis Beogradit", por s'jonë konë këta aparata, po ti ta kishe marr një fotograf me bo një fotografi para qasaj, ajo ish konë kryevepër.

Pjesa e Shtatë

Erëmirë Krasniqi: Po kthehem mbrapa, se prej '88, shkum në '90, s'ka lidhje. Mendova m'u kthy te ai tregimi i '81-tës kur e keni pasë ekspozitë në Galeri të Arteve në "Boro Ramiz" që kanë pasë me ardh të dy delegacionet, pak ma shumë specifike si storje.

Fatmir Krypa: Ishte, ishte ngjarje pak sa interesante edhe politikisht e pakapshme për atë kohë. Po thom ishim anëtarë të Lidhjes Komuniste, tonë ishim edhe unë posaqërisht dikur, kur të punojsh edhe si prodekan e, isha dekan e, drejtor i studimeve post-universitare, ku mos me të shti tani edhe si sekretar partie edhe tonat me t'i flug. Hajt po punon, po punon, po çon rond, po çon rond, hajde ngarkoja edhe këto. Por, aty kur u bo ekspozita ishin të planifikume me ardh amerikant, i kishin lajmru Galerisë që do të vijmë në hapje të ekspozitës. Po ndërkohë, erdhën, u informum se do të vijmë edhe një grup i Ambasadës të Rusisë do të vjen në hapje të ekspozitës edhe tash marrëdhajet ruso-amerikane nuk ishin kurrqysh edhe të takoheshin aty në distancë shumë të afërt nuk binte kurqysh.

E të bijsha unë viktimë ishte edhe ma kurqysh. Disi u gjet njëfarë, ata e gjetën rusët, e gjetën solucionin që të vijmë ma vonë, lëshun pe, lëshun pe që të vijmë ma vonë. "Masi që të hapet ekspozita" tha, "na po vijmë". Edhe në hapje shihethihet aty, në hapje të ekspozitës janë delegacioni amerikan është në vijë të parë. Kurse fotografi me ta nuk kom se erdhën, bile keq pasna bo që fotografi aty nuk më ka bo fotografi me ta, t'u ju spjegu grafikë për grafikë ju interesojke. Grafikë për grafikë ju kom sqaru idenë, qysh e kom fitu idenë, qysh e kom realizu e krejt atyne, po.

Ajo m'pat njëfarë emocioni, thashë se edhe po i ngjan Galerisë diçka edhe mu si person, po bohet njëfarë konfuziteti, marrëdhajet nuk ishin kurqysh, po del diçka, por në përgjithësi përfundoj bukur.

Ata të knaqun dy parët delegacionet, delegacioni amerikan aty, me ta mujta me bo fotografi me të gjithë. Me kta tjerët u falenderum që pata mirësi, që i prita edhe ata, ju bona edhe një, veçantë edhe një skjarim të veprave të mia dhe përfundoj mirë. Kështu që, ato gjana ndodhin te artisti. Mirë jonë që ma kujtove, se ma evokoi, se nuk janë gjana të rëndomta, por ja ndodhin edhe kështu gjithmonë ka me pasë raste kur janë ekspozita.

Edhe në Beograd kom pasë *grafički kolektiv* [srb. Kolektivi i grafikës] është përballë Hotel “Palace” në qendër të Beogradit. Ishte planifiku një profesor i Akademisë me ma hap ekspozitën. Ai tha, “Unë kom qef me ta hap ekspozitën”. Që the ti parëz i kemi rujt pak marrëdhanjet, nuk kanë qenë ashtu të shkëputuna qysh janë tash. Ti s’mundesh me marr me mend, por i kemi rujt. Po më thotë, “Unë do ta hapi ekspozitën”, thashë, “Mirë” thashë, a di, “po kom dëshirë” a di. Në hapje të ekspozitës, ndodhin këto gjanat e paprituna, profesori im Mihailo Petrov¹⁴ i cili e ka themelu grafikën në Serbi e mu më ka dhonë mësim edhe nuk e kishin thirrë në hapje të ekspozitës, por e kishim marr vesh nëpërmjet televizionit, radios e kish marr vesh që në orën kaq Fatmir Krypa hap, “U Fatmir Krypa është studenti jem e kta nuk m’kanë thirr mu”.

U ardh me zo, me njëfar konflikti me Galerinë ai profesori, e knej kish mu hap ekspozita. U bo ajo ni gja bukur e pakandshme. Ma në fund ata e panë që kanë gabu, “Na fal profesor se koka bo një, një e paqëllimët”, tha, “Studentit tim, studentin ma të mirë timin mos me ma pru ftesën. Unë me marr vesh nëpërmjet mjeteve të informimit”. Ai nuk pritonte se ishte edhe në moshë, në penzion. Erdh pak ashtu i revoltum në prezencën e njerëzve, thashë po më prishet ekspozita kuku midis Beogradi o Zot i madh.

Ajo shoqja ime [Hyrije Krypa] më la flejtëm në hotelin përballë “Palace”. U çova në mëngjes, unë flej si top. U çova në mëngjes, Galerinë e kisha karshi {tregon me dorë përball} dhjetë metra përballë, veç me kalu rrugën edhe p’e kqyri Galerinë, p’e kqyri kërkush s’u ardh hala edhe thashë nejtse po presim. “Dalim hajmë mëngjes” thashë, “A fjete ti?” Tha, “Hiç s’kom flejt”. Thashë, “Pse?” Tha, “Jo mër, s’di nuk më murr gjumi valla”, po mirë thashë, “Hyrije e pse nuk të murr gjumi?” thashë. Tha, “Kuku menojsa”, se e kisha ciklin e këtyne “Malësorëve” se kom shumë ksi sende {tregon kah muri me gisht}. E kisha ciklin e “Malësoreve”, tha, “Kur ti shohin midis Beogradi, këta Malësoret kur t’i shohin çmenden krejt, trullaven”. Ttha, “Ku me ditë qysh kanë m’u nda me ekspozitë”. Thashë, “Hajt bre”, thashë, “dertin duna me bajt unë për ato. Kur të o puna e mirë, tema...”, nejtse. Boll edhe mu ma shtini njëfarë fitili. Kur hajt tash nejtsha, rrisa, kur s’di gjo shkova te Galeria. Tash për me ma thy qato që ma dha shoqja, kur pe shoh një koleg prej Beogradit ish’ ardh tu prit te Galeria.

“O mirëmëngjes, mirëmëngjes” serbisht tha, “Si je, si je?” Tha, “Kom ardh me të ndihmu më i aranzhu punimet. Kom ardh me qef se shumë më ka ardh mirë kur e kom pa thirrjen se ki me hap ekspoziten. Erdha bar një surprizë me ta bo. Me të ndihmu me i aranzhu punimet, atë ndihmese me ta bo”. Se ata nuk kishin kesi aranzher sikur e ka Galeria, por ti e merrshe dikond, vet kapakëz, e dishe për afërsisht, se u duhshe me pa Galerinë sa eksponate për afërsisht të formatit mundet me i zonë. Unë e kisha vizitu

¹⁴ Mihailo S. Petrov (1902–1983, Beograd) ishte një grafist, piktor, ilustrues, poet dhe kritik, profesor, hartues dhe shtypshkrues i librave dhe posterave. Studioi pikturën në shkollën e artit në Beograd me prof. Lj Ivanoviç dhe M. Milovanoviç (1919-21), dhe vazhdoi në Vjenë (1922), Krakóë (1923) dhe Paris (1924-25).

ato përditë, se aty isha në Galeri me qindra herë kisha shku në ekspozita. Edhe ai po vjen edhe ma thej pak ato, thashë, “Se kqyre me sa vullnet Hyrije vijinë, këta e dijnë çka boj unë, çfarë krijimtarie boj”.

Masanej i kom ndryshu do gjana se s’mund të rrish vazhdimisht me punu me kësi gjanash, ai njeri bohet monoton me krijimtari. Se krijimtarinë ti mund ta rujsh, mund ta rujsh ti ato drejtshkrimin, dorëshkrimin, mund ta rujsh gjuhën e artit tond që flet, a ti mrenda asaj gjuhe çka mund të flasësh, çka mund të shkrujsh, nuk është e thonun ti gjithnji me bo një gja të tillë {tregon me dorë punimet} Bohet monotone në jetë sa do të jetë ajo e bukur, sa do të jetë e mirë shterret, shterret edhe bohet averzion për dikond, e shetit nëpër Galeri edhe del prej Galerisë. “Po e pash kjo si ajo, ajo si ajo tjetra, kjo si kjo” edhe u kry u pa ekspozita, jo.

Teknikën kur e ki, teknikën që e kultivon, une, tash s’po thom, qito nuk e kultivon. Ju kom mundu me ju ofru në Shqipni Fakultetit, por xhelozia, “Jo veç ndaq me ardh në *workshop* [ang. Punëtori]”. Ku bre, po kjo ka shumë problem, kjo është shumë problematike për *workshop*. A din kur vihet në *workshop*? Në *workshop* vihet atëherë kur ti ki një njohuri e qat njohuri don ti me ngrit edhe don me begatu me gjana ma të ndryshme, ma tjera. A ti tash për herë të parë po ndin e po sheh për këto gjana, e në *workshop*, *workshop*-i kërkon bazë me e njoft diçkafin. Se qysh e boni Fatmiri s’ka lidhje, jo more, jo, atij studentit mi met diçka, mi met në kokën e tina diçka. Kërkova me shku me ju dhonë ligjerata, anej-knena, “Do shikojmë, do shikojmë”. A vet m’patën thirr në vitin ‘86, vet m’patën thirr mu për grafik, Shyqrin [Shyqri Nimani] për dizajn.

Erëmirë Krasniqi: Në ‘96 apo ‘86?

Fatmir Krypa: Në 86’ se po m’përzihen, 86’ me dhonë ligjeratën, me dhonë mësim. Por situata nuk ish kurqysh edhe drojtëm me shku, na nalshin pashaportat, s’na jepshim masanej edhe mbeti ajo andërr. Thashë, “Une kom ardhë, kom dalë në penzion edhe muj me kontribu” por thanë, “Jo, mundesh veç me *workshop*”. Ajo është hajgare, është...

Erëmirë Krasniqi: A jeni tu fol mas të 2000-tës, kur jeni penzionu ju?

Fatmir Krypa: Kush?

Erëmirë Krasniqi: Ju kur jeni penzionu?

Fatmir Krypa: Ka tash...

Erëmirë Krasniqi: Por është mas vitit 2000, nuk është në ‘96.

Fatmir Krypa: Jo, jo shiqo, unë kur kom qenë në Shqipni kom qenë qitash ma vonë, po menoj kur jom pensionu po flas. Në ‘86-tën ju kom thonë me ardh, atëherë m’kanë thirr në ‘86-tën.

Erëmirë Krasniqi: Kur ka vdek Enver Hoxha.

Fatmir Krypa: Eh atëherë, atëherë m'kanë thirrë, por ne s'guxojshim me shku. E këto që i kom thonë unë kanë qenë tash vonë kur jom dal në pension. Ajo që m'kanë thirr ata ka qenë në '86-tën, ma herët shumë. Aty kom, hala kam qenë në forcë, kom qenë në vendim, pa marrë parasysh ato gjana, por ne sakrificën donim ta bonim, mirëpo ishte e tepërt që mos me ra viktim. Na merrshin edhe na, na, na sakatojshin me të gjitha ato pengesa, se ne në arsim kemi qenë të monitorum shumë herë. Mu si sekretar të partisë m'kanë pasë ftu. Aty e kom pa veten se muj me kontribu diçka jo vetëm në art por edhe në punë profesionale edhe punë shoqërore.

Më patën thirr atëherë në Komitetin Komunal një herë patë qenë bisedë rasti informativ me dhonë ndonjë mendim për disa shokë, për disa kolegë mi dhonë disa mendime unë. "Ti si sekretar i partisë aty mi dhonë disa mendime. Keni disa probleme aty", kur t'ju kom kthy me një ton bukur riskant por thashë o bahçe o bunar le të bohet, me të vërtet thashë se kajherë na se kem farë politike po amaterski, në mënyrë amatoreske. Ajo ishte konë shumë e qëllume a di. Thashë, "Po kadal, këto ekspozita që i kemi bo në Jugosllavi, që kemi ekspozu në Rumania te Java e Kulturës, që kemi ekspozu në Slloveni Java e Kulturës e në krejt këto galeri që po ekspozojmë andej e knej, kush ka afirmu ma shumë, qita kolegët me studenta. Ata koleg që e kanë afirmu qet Kosovë e qet vend, e qet strukturë, qet shtet. Tash m'i sakatos ata a? A qaq shumë paskan bo mëkate që duhet mi sakatos ata a?"

"Jo por duhet me gjet, mendo mirë..." Thashë, "Shiqo, unë nuk dal prej zyres me atë fjalë mendo mirë, se ajo mendo mirë domethonë që duhesh apet me ardh me raportu. Unë mo këtu nuk vi." Edhe aty e kom përfundu çashtjen politike. Edhe thashë me politikë s'mirrna kurrën e kurrës edhe ajo ishte sa mundesh me kontribu, se me qenë dikush mundesh me shku me thonë keq për ato, keq për ato me qit në pozitë të keqe. Situata ka qenë shumë e koklavitun me mbijetu edhe si krijues edhe me rujt kolegun si pedagog edhe si njeri. Çka do të thoshte unë me thonë për një koleg timin me fol keq, ajo automatikisht dal prej pune. Qashtu e qiten Fehmi Aganin, qashtu shkunë plot, krejt, krejt gradualisht.

Erëmirë Krasniqi: Të stacionohemi te lufta, tek qajo periudhe e '99-tës. Qysh fillon lufta për juve? Po mendoj, ka fillu njejt për krejt neve por qysh ju gjen juve qajo periudhë?

Fatmir Krypa: Po ta thom të vërtetën ajo është për krijuesin dy herë ma e vështirë se ato emocionet, se njeriu mundet me mbijetu me një kafshatë bukë, me një gjellë të begatë, me pak diçka mundet me mbijetu. Artisti nuk mundet me mbijetu kur nuk i ka ato rrethanat për krijimtari, është shumë e zorshme edhe si nuk mundesh me kriju është njisoj sikur mos me hangër buk, si mos me ushqy barkun, e ki shpirtin të pa ushqym. Ti barkun e fryn, e mban, por ndjenjat lypin, kërkojnë me pa gjana të reja, vlojnë nëpër kokë meditime të reja. Ato nuk mujn mu shpraz, nuk kanë ku. Arti don me pasë një qetsi, e ne ta thom të vërtetën e kishim edhe sopatën mbi kokë dy herë edhe si pedagog edhe si krijues.

Unë ndërtesën qato atelënë ku e kom pasë ka qenë e Sekretariatit. Katër kat kanë qenë të banorëve që i kanë pasë shpijat, pjesa tjetër deri në të dymdhetin kat ka qenë e banorëve të cilët kanë qenë të punësuar në Sekretariat, o polic të uniformum, o civili që kanë punu nëpër zyre, por pa marrë parasysh në Sekretariat kanë punu. Ata e kryjnë misionin edhe pse si ka teshat e kaltërta ai e kryen misionin edhe me të pame edhe me të nime e ka për obligim me referu gjithçka.

Unë nxansave të mi, studentave ju thojsha, “Mos mu tuboni te lifti, ka njo ka njo, nji, dy hec. Ku po shkoni? Nxene numër 36”, mos me ma çu dikond a di. Ishte drojë, po ma bijnë ujkun në torishtë si pedagog. Mandej, ku me gjetë inspirimin? U duhshe pa qare prit sot, prit nesër, prit masnesër po bohet ma mirë kur i nijshe gjithë ditën protestat. Unë e kom grafikën, pikturën e punume aty në sallon të inspirume prej protestave. Atë ditë jom inspiru për atë pikturë, e kom punu një skicë të vogël e tash e kom realizu të madhe. E kom punu në ditën kur janë bo protestat, i ndigjojshe, ulërojke rruga atëherë i thojshin “Marshall Tita”, tashti qaty te Teatri ajo, te korza ku është defilojshin protesta.

Unë ku me gjetë inspirim? Por, kaniher me zor, kaniher thoshte njeri po bojka edhe në këtë mënyrë po bojka. S’ki, prit sot, prit nesër, ishte mllef, arti donte, gufonte, qite njo, qite tjetër, thirr në ekspozita kjo galeri, thirr në ekspozita kjo galeri ti me hesht, me shukat, jo mër. Nuk po shukati, po ja boj, po ia çoj një grafikë atij, po ia çoj një grafikë këtij, p’i boj këtë. Hop i hypa aeroplanit, shko në Zvicërr e bona ekspozitën me tregu në Chatel, e në Llozanë, e në Cyrrih, tri ekspozita i bona mrena një muji e gjys, ka 15 ditë atje, 15 ditë atje, 15 ditë atje. Ajo ishte, bile ky Agim Ramadani në Cyrrih ishte si Sekretar i Kulturës, bile gruja e vet ma ka pasë hapë ekspozitën, gruja e Agimit ma ka pasë hapë ekspozitën.

Aty e dijshe, knej vlonte trishtimi, u planifikonte diçka ma e keqe e ma e keqe, ti u duhshe me shku me bo ekspozita atje, me harxhu pare, me harxhu material, mi dhonë studentit material. Por kur e mendoj krejt këtë po mendoj ndonjëherë është një energji që kaniher veç kur po i ndëgjoj fjalët e mia po thom a unë po flas, a po i thotë dikush që unë i pasna bo, apo dikush e paska monitoru punën teme edhe po mi thotë. Jo more jo, i kom dokumentet, i kom fotografitë të Cyrrihut kur m’kanë ardh me tupana me ma hap ekspozitën, me tesha kombtare, qe i kom fotografite. E kom marr nipin, vajzën e kësaj vajzës, nipin në krah, më erdh ai “Gjysh”. Këto janë emocione me të ardh.

Mirëpo, ato ishin, kishin edhe një të mirë, afirmim i kulturës që e bojsha atje, shkrujshin gazetata, ajo ishte prapë një afirmim. Sa më vike mu mirë, më vike mirë, i kom ato gazetata e preme, të citume, ju vike mirë edhe këtyneve, shqiptarëve. “Albanen, shqiptar, albanen, Kosova, shqiptar, albanen, Kosova, albanen”. Atëherë e kqyrshin situatën ma ndryshe kur e shihke se edhe ky koka shqiptar. E ngritke pak, ata thojshin po na bjen edhe neve si me thonë, po na ngritet rejtingu [vlerësimi]. Plot kështu ekspozita ku kom hap...

Erëmirë Krasniqi: Bombardimet kur ja fillun ku ishit?

Fatmir Krypa: Bombardimet, isha në klasë, isha... po.

Erëmirë Krasniqi: Ishit në atelenë e juj?

Fatmir Krypa: Jo, jo isha në Fakultet.

[Këtu ndërpritet intervista]

Fatmir Krypa: Po është' një situatë që gjithkush e ka përjetu në atë mënyrën e vet. Që ishte e papritun nuk ishte, ajo pritej, bile sa ma shpejt, por që do të na ndodh mandej ajo tjetra pas bombardimit ndoshta në atë mënyrë nuk e pritnim. Por, unë e kom pasë siguru pak a shumë krijimtarinë time në *slide* të mëdhej. Kom pasë bo gjithë krijimtarinë time e kom pasë fotografu në *slide*, qe i kom aty. Të deri atëhershme sa ishte koha. Edhe me ndodh te ma e keqja, far ekzodi, kurgjo s'muj me marr me veti, qato *slide* muj m'i shti, muj m'i shti diku, mi mshef. Dhe ashtu në emocion e sipër kur erdh koha e luftës, e bombardimit u desht me lëshu Kosovën, u desht me lëshu Prishtinën, banesën dhe një natë përpara na urdhërun policët që nesër banesa në orën tetë me qenë e zbrazët, me 41 familje, me qenë e zbrazët.

Përfundi te "Bast Trade-i" u futën forcat policore se u bombardu stacioni policor. Erdhen hinën në "Bast Trade" poshtë e na për me qenë ata të sigurtë mos me ekzistu na aty se na ishim ngjit me "Bast Trade-in" edhe me na largu neve. Mirë, çka ki me bo. I thashë shoqes, "Të palojmë gjanat ma akute që i kemi edhe duhet me dalë". Dokumentat që ishin ma primar, i morrëm dokumentat, e bona një shtres të torbës, se thashë robaqepsi, tash robaqepsi gjindet dora edhe e kom bo një bazament tjetër, i kom shti krejt dokumentat, një karton përsipri, e kom kepë kartonin edhe e kom bo kartoni vet që u konë përfundi i vet torbës. E kom shti aty në najllon krejt dokumentacionin origjinal, çka kishim kësi fotokopje, duplikata diçka, thashë, "Maje në torbë, maje në çantë. Me t'i lyp policia dokumentat qito i kemi, çka kemi qito". Ato vendimet e shpijës, e baneses, çka kishim do gjana, ato i shtina mrenda aty. Tapijat, e kisha shpin në Gjakovë, krejt i shtina përfundi edhe e qepa, s'merreshin vesh fare, masandej qiti teshat, shprazi teshat aty, kurgjo kërkujna.

Dhe erdh mëngjesi, fillum të zbrazim, u zbraz banesa. Shoqja [bashkëshortja] tha, "Po e pysim një shoqe" të saj "a na pranon te Bashkësia e Tretë Lokale në Prishtinë", në Dardani poashtu. Tha "Po ejani." I thashë, "I kemi të gjitha". I kisha marr me suxhuk që e kisha bo gati për dimën, i morra dy paqeta vezë, a marr miell, a kisha makarona, a kisha sheqer, a kisha gjalp, a kisha... t'gjitha i kom pasë përgatit. Kemi pasë ndëgju prej Sarajevës që lufta ka zgjat shumë edhe i kanë rujt ato gjanat. Unë i morra ato të gjitha tu mendu që çfarë lufte, menjëherë hup, s'ka luft aty me bo edhe i thashë, "I kemi të gjitha mos droj se duhesh" thashë, "me na bajt dertin për buk, t'gjitha i kemi". Aty edhe një nat, të nesermen kanë ardh policia, krejt ato lagjet që janë soliterat e lartë me dalë prej atyhit. Kur u bo ora dymdhetë e kanë zbraz krejt ndërtesën, nëpër vetura edhe jemi nis drejt Maqedonisë, po.

Kur kemi bo me hi në Maqedoni, në kufi me Maqedonin i kom thonë shoqes, "Kom gabu," thashë, "i kemi harru" thashë, "*Slide*-at, mendo" thashë, "tash me më pyt kush je ti. Jam piktor, profesor, jom grafist". "Ku e ki? Në bazë të çkafit me pa?" "Kurgjo s'kom". I kom pasë bo gati të gjitha *slidet* e mdhaj, gjashtë me nontë. Desh lujta mensh një javë ditë aty, por, ai njeri s'ka çka me bo, jeta e omël, kur e shihsha që njerëzit vdisshin, s'kishe çka me bo, duhet m'u pajtu. Një javë ditë kalun në Maqedoni, kalum dy muj ditë aty. Ditën kur hyn NATO-ja, i zoti i shpisë, unë si i hutum fare...

Erëmirë Krasniqi: Po mendoni trupat që hinën në kamp?

Fatmir Krypa: Po, hin trupat edhe po e shiqojmë televizionin. Ai tash mu po më kqyr me bisht të synit reagimi im, unë ashtu i ftoft, disi s'po di çka po ndodh n'mu, a hupën ndjenjat, krejt, a si në habi ashtu.

S'e di njeri ashtu me qenë i pakoncentrum se *hooo* {onomatope} me bërtit anej-knej, por krejt i humbun, s'e di as pse më ndodhi ajo. E po më kqyr ai, tha, "Axha Fatmir, a nuk po gzoresh që po hyn NATO-ja a?" "Po mër po" thashë, "qysh nuk gzohet, tash do t'ju bojnë, do t'ju rrotullojnë!", pak m'u dha ajo. Tha, "Që ki qef, nesër është e shtunë", punonte ai, në librari shitës, tha, "Të dillen në mëngjes herët, sot e premtë, shtunë, masnesër" tha, "në saba me dritë na shkojmë në Prishtinë edhe e kqyr qysh e ki situatën. Hiç mos u merakos tash ti". Thojsha, "Po ajo po bohet, por ku me dit çka na kanë bo se", tha "Hajt more se shkojm, e kqyrim, e bojm" edhe ashtu veprum.

Të dillen në mëngjes ne nisemi me makinën e tij dhe mbërrijmë në banesë. Kur ju kom afru banesës, ne në ushtri e kemi mësu, se unë e kom kry ushtrinë, (qesh) asaj kohe, kemi mësu që armiku kur të largohet i minirat dyert që kur të shkon ti eksplodon. Edhe ky Naseri, pronari i asaj shpisë ku isha unë e kishte kry ushtrinë edhe ai e dinte atë. Thashë, "Naser mos u frigo. N'u frigofsh shko qaty mas stubit qatje, të hi unë mrenda e ti eja mas meje", se e shihsha që rrike mbas, frigohej. Jemi hi mrenda edhe ne i kemi pasë ofru dritaret, por qysh i kishim kazermat shumë afër, ajo detonacioni që vike neve na çojke në kam, na dridhke shpinë, na dridhke banesën.

Ishin qel krejt dritaret ishin bo sallamadi, krejt ishin qel dritaret. Pluhuni, mos pyt a je në rrugë a je në shpi. Thashë, "Naser, po e ham pak buk qitu", e kishim marr me hangër, "e të zbres në podrum", e në podrum i kom pasë mshef krejt grafikat. Podrumit ia kom pasë bo ni derë, derë të burgut të trashë dhetë centimetra profilin. Jo profil, por kësi tubë është katror të plotë edhe dy milimetra llajsnën e trashë, me tri bri të pjerrta kështu që mos me mujt mu laku ajo. S'ka pasë ato veç minat mujshin me çu në hava me hi mrena, me thy shancë s'ka pasë.

E për qaty e kom pasë hek vesvesen me hi qaty dikush, por megjithatë ata pe çojn, çka kanë bo. Kur kom hi, e kom qel derën i kom pa grafikat aty thashë, "Qitash Naser mujm me hangër, mujm me ndejt, me bo muhabet" edhe dulën ni gru e kojshive, një burrë i kojshive, ju dhash tepricat që më teproj mu buka, s'kishin as bukë. Ju dhashë bukën, djathë që më teproj, njo Coca-Cola gjysën ja u dhamë atyne. Ishin tmerru, ishin frigu. Ata kishin nejt, gruja e çalë s'mujke me hecë, burri ka nejt shkaku i grus, aty kanë nejt i kanë ndi krejt ato detonime që kanë ndodh, krejt ato, ishin tmerru.

Ashtu që, mandej u kthym përsëri i murrëm familjet, u kthym e krijum jetën, e bona një modifikim aty ku e kisha banesën, terrasën. Terrasën time e bona atele, atelenë time që e kisha e shita, e bona q'atë kompenzim, e rrita 24 metra, e bona këtu 60 metra. Aty e bona një çlirim edhe e zhvillova krijimtarinë prej asaj dite mas çlirimit deri para një muj dite kur kom shtyp aty. Qe një muj ditë nuk kom punu fare se isha në hap tu pru grafikat, tu i kornizu, tu ma pru tavolinën, tu e pru presen. Këtë dorëzën e madhe, rrotën e madhe ja kom qit tashti, se nuk e ka pasë. T'u ble, t'u bo diçka, jo eja një ditë e pruna tavolinën, jo këto e pruna këtë karrikën, kështu që t'u e kompletu. Një muj ditë fare fare fare me art nuk jam marrë, veç me meditim si po zhvillohet ecuria e punës.

Tash besoj se do të ndreqet edhe koha se këtu e kom ngrohjen qëndrore, muj këto me e ngroh, por nuk e kom lëshu qëllimisht. Dy, tre radiatora i kom, por ende s'ia kom nisë punës edhe thashë mos të krijoj shpenzime koti. Tash duhet me mendu për një ekspozitë retrospektive si rezyme e krejt kësaj bisede.

Pjesa e Tetë

Fatmir Krypa: Mendoj me bo këtë ekspozitë që m'ka metë pa e përfundu vitin e kalum në Muzeun Kombtarë dhe të marr pjesë në disa bienale gjatë vitit që jemi. Të marr pjesë në disa me punime të reja dhe plani i fundit, ma i fundit që e kom, n'i arrifshim me i bo tetë zero zero, mi bo të 80-tat edhe dy vjet edhe me bo një retrospektivë, me një katalog të madh, me i dhonë ngjyrë kombtare se këto grafika që do t'i shifni tash dhe që i shihni kanë erë lufte, janë të kalluna ato mas shpinës. Kanë erë lufte, janë kallun. Ajo është "Ekzodi" {Bën me gisht drejt}. Janë gjana të cilat i kom përjetu e i kom qit në krijimtari. Kështu që mendoj me bo një monografi e cila do ta përmbyll punën time me t'gjitha ato peripeti, me t'gjitha ato dëshira, me t'gjitha ato ku ai kolegu ma vizatoj sharrën [i rreferohet tregimit të provimit pranues në Akademinë e Arteve në Beograd].

Parameno tash ta kisha pasë aparatin me fotografu sharrën para emrit tim edhe unë nuk e dija fare se çka është ky simbol i imi, nuk e disha fare. Me një shok timin mas nja tre mujve kemi dal e kemi njoft Beogradin, se isha brucosh, s'e njifsha Beogradin, s'e njifsha jetën në Beograd. Dhe dalim mas Teatrit Kombëtar të Beogradit, *Narodno Pozorište*, Teatrit Popullor, kur aty është një bashçarshi. Ecim, ecim kur i shohim tu fol shqip bllaj, bllaj, bllaj, ai tjetri ka sharrën në krah, ky tjetri e ka kazmën në krah, ky tjetri e ka një shati në krah. Shqiptarët ishin dal mu shit punëtor krahu dhe unë atëherë e kuptova se çka paska dasht ai me atë me më thonë, se ti nuk je për kësi por je për qisi.

Mundesh me marr ti me mend, duheshe ti me relaksu veten, s'kishte kush me të relaksu, ishe i vetmi. E vetmja qajo që thashë ma parë që doli profesori më tha, "*Ti si ovaj stub*" [srp. Ti je kjo shtyllë], çka është ajo, për këtë klasë? Ma rriti mendjen, ti je domethonë i fortë që p'i manë. Kërkush nuk i kish tri dhetëshe, një nonshe, kërkush nuk i kish. Njoni ni dhetshe dy nonshe, shtatshe tjerat. Unë isha ma i miri, një femër prej Novi Sadit, Akademia e Novi Sadit, u konë e mirë, u konë e mirë edhe ajo. Një femër ishte hungareze edhe ajo i kishte notat e mira, dy dhetshe, një shtatshe, një nonshe, po. Kështu që, aty dojshe me fitu simpati, me fitu edhe dije me profesorat, e me kolegët, simpati për me mujt me ekzistu ti me kry punën tone.

Harrova të tregoj edhe një rast që është drastik, drastik është në vitin e dytë. Teknika e litografisë është kësi soji, është guri qashtu i bardhë, i rrafshat {fërkon duart} edhe punohet edhe pastrohet krejtsisht prej yndyrnave edhe ti e vizaton me lapsa të yndyrshëm, ose me tush të yndyrshme, me çka të dush, ndaq me penë, ndaq me laps, {lëviz dorën sikur vizaton} ndaq me brush, çka të dush ajo teknikë i duron dhe e kryen detyrën. Masi që ta kryen atë vizatim, duhesh mandena me kimikale me arritë procesin me shtyp, procedura kimikale. Profesori kur erdh ma pa vizatimin edhe po m'lavdon. "Shumë mirë, po..." i pëlqej, anej e knena.

Nji hungarez, tu bo me dal profesori, e kreu msimin po don me dal me shku n'shpi edhe ky pi thotë, "Profesor, profesor" tha, "me të pyt edhe diçka, m'fal" tha, "Po, kur ta përfundoj këtë si me bo këtë procedurën kimike?" Tha, "Po çka po të vyj unë, qe ku e ki Krypën" tha. "Ky" tha, "të tregon". Kuku, ai prepotent, kur i ka thonë, "Çka po t'vyj unë, qe ku e ki Krypën" "On sve to zna" "Krejt këto i din" tha, "qe ku e ki pyte ato". A kopi njeri, a ju kuqen veshët {kap veshët}, ia shihsa ftyrën, ju kuqën veshët, dul përjashta. Por, kur jom ardh të nesërmit, se nuk e përgatita me shtyp krejt, po mendoj ishte bo gati, por të nesrit pritsha me shtyp se procedura zgjat. Profesori më tha, "Mirë vazhdo, veç shtype tashti", e thashë mirë nesër natje.

Çka ka bo ai? I ka marrë durt me burek, burek të yndyrshëm, se burektoren e kishim në derë të akademisë edhe me yndyrë, yndyra nuk shihej, e ka marr te detalet e vizatimit ku i kisha ato ma që s'mund të fshihen ato, mi bo mi fshi ato prishet krejt, s'munesh me intervenu. I ka prek me dorë, ato dalin si njolla, dalin të zeza e nuk shihen me sy. Kur ta shtyp ti me procedurë teknike, ajo yndyra, e ka thith guri yndyrën. Atya dolën gishtat rak, *rraaak* {onomatope} kështu të sillun, jo me lon gishtin kështu, por të sillun gishtin e ishin prish ato.

Aty ti nuk e vrejshe te vizatimi se ishte me tush i zi edhe guri i bardh, normal. Por ajo yndyra aty mrenda detaleve. Kur i kom qit ato kemikalet aty për mi nxerr ato vijat që kisha mi bo, mi përforcu me yndyr unë, kur e ka thith dorën aty. Kur pi shoh gishtat, a u tranova, u tranova. A din tash inteligjenca nuk don brina, aty s'ish inteligjenc e madhe me pas, s'dojke çka me dyshu njeri se kush ta ka bo. Pe thirri asistentin edhe p'i thom, "Kqyre dikush çka m'ka bo prej kolegëve" thashë, "Atë ditë që m'tha profesori e ki mirë vazhdo detyrën, shtype edhe" thashë, "tu bo me dal që e pyti qysh bohet kjo, qysh bohet kjo, e profesori i tha çka po të vyj unë kur e ki Krypen, ai të tregon krejt se i din" edhe ai asistenti po ma bon, diqysh i vike atij keq, e tash me bo atë punë të madhe, mi thonë profesorit ai do ta kishte, as nuk do ta konsideronte si student, do ta kishte përjashtu edhe prej Fakultetit ndoshta.

Më kshilloj që mos ta ngris nivelin e kësaj shtate dhe, "Ti do ta punojsh përsëri njo tjetër dhe profesori mos të merr në konsideratë ndonjë veprim të pahijshëm ndaj kolegut, se nuk është bo mirë fare, ne e dimë, e kemi pa që nuk është bo mirë fare, por ti do ta bojsh edhe shpërblimin do ta marrësh notën". E kur e them këtë mundesh me marr me mend me çfarë peripeti, ajo ishte në vitin kur e jepsha provimin, kjo ishte në vitin e dytë, kjo ishte në vitin e dytë me kolegun që ishte i grafikës. Mundesh me marr ti me mend atë ditë kur jom vonu për provim pranus unë, ky kolegu qysh e ka ndi vetin që unë nuk jom aty momentalisht, që jom vonë e që do të boj gaf, që s'kom koncentrim në fund të sallës aty menxi me pa, por edhe në këto mënyra të veshtira me ja arrit kaniher po i thom vetit se di, *afërim* [turqisht - të lumtë] le ti thom, por ke nji...

Për vetveten kom bo mjaft edhe tashti po mundohem se kur isha në Facebook, kur mi blenë këto grafikate në Muzeun e Kinës, Muzeun Qëndror të Kinës. Aty nuk është gja e vogël me të qëndru vazhdimisht veprat tua në një muze të madh edhe shumëkush ndihen krenar. I kom nja katër mijë në Facebook i kom fansa e të gjithë niheshin si me thonë krenar që një koleg, një njeri, një krijues i jonë po arrin qëllim të hapë ekspozitë atje, që veprat e tij t'i blejnë atje, t'i ekspozohen përjetshëm atje.

Kjo të jep edhe vullnet, se tashti po vjen një i afërm i imi dhe më pyt, “Ka sa p’i shet grafikat edhe a po të shiten?” Si m’u konë në pazar. Unë i thashë, “Ka një, ka dy”, a din? Ka sa po të shiten, “Ka një, ka dy” i thashë (qesh), çka mi thonë? “Shiko,” thashë, “përpara kom pasë ma shumë shitje, vetëdijësimi ka qenë ma i lartë. Në kohën e fundit vetëdijësimi është shumë ma i ult edhe se unë veten e kom ngrit cilësinë e punës time edhe afirmative edhe cilësore, por nuk ka shitje”. Ma parë ka pasë ma varfni, kanë ardh kanë ble për lokale, për shtëpi banimi, për dhurata prej qytetit në qytet.

Kom pasë shitje që muj me të thonë diçka që s’kom mujt me arrit me shitë edhe shoqen e kom pasë shti në funksion punën e saj me më ndihmu gjatë procesit të shtypit të grafikës, nuk m’rijsa me i shtyp. Kisha oferta nga jashtë, kisha oferta nga mrenda. LDK-ja, kush vinte ndonjëherë, se një herë kryetari Rugova ka qenë me një delegacion dhe ajo rasisht tash unë ja shita një shokut nja dhetë grafika, erdh në atele te unë. Restoran “Ora” nuk e di a e din ku është, te Kuvendi, tash ishte bo hotel ndëgjova. Qaty rinte kryetari Rugova me delegacion, aty i çonte me hangër ushqime. Aty e ka pasë, vend të sigurtë e ka pasë.

Vjen ai djali me mi ble disa grafika, Masari u konë, thotë, “Prof kom ardh me t’i ble disa grafika”. Thashë “Fjala disa po m’pëlqen. Sa koka ajo disa?” Tha, “Po nja dhetë”. “Hajde” thashë, “Masar urdhno”. Erdh i zgjedhi edhe tha, “Sa e kanë çmimin?” Ja dhashë një çmim i cili ishte, kur është një grafikë është ndryshe, kur janë dhetë është ndryshe edhe ja bona një çmim ma të lirë. Kur i murr ato pi pshtjelli. Tu bo me dal po m’i nxerrë njëqind marka, se atëherë marka ishte në funksion. Thashë, “Masar, qito njëqind marka çka jonë?” Tha, “Po qe nesër masnesër ti bi edhe kusuritem me këto”, thashë, “Masar, unë duhet me ble material, duhet me shku në Turqi, në Francë” e blejsa letrën, “krejt material i importum nuk është kurgjo e ktuhit”. Tha, “Po nesër ti bi”. Qysh ia dhashë edhe unë? Thashë vet me veti. Tek e fundit, ma n’fund me bo mos me mi pru paret për nja ni muj, dy muj shkoj në restoran ja heki njonën e tjetrën ja marr, pse, ai nuk ka me ik.

Kur po shkoj n’shpi p’i thom shoqes, “Yhh kom bo biznes, dhetë grafika i kom shitë, qeshtu qeshtu”. “Au, mirë kujna?” “Ni Masarit tek ardh ni restaurant ‘Ora’ me djemt e axhës” edhe “U mirë” tha “E paret?”. Paret i thashë që m’i ka dhonë njëqind marka e tjerat m’i bjen. “Puh çfarë njeri?” Tha, “Qysh more tonë atë mund, tonë atë siklek, me ja dhonë njerit veresije ashtu?” “Kqyre”, thashë, “unë jom djali i tregtarit”, thashë, “hiç mos e ki merak”, tash pe arsyetoj veten diqysh. Thashë, “Kanë mu ekspozu në restaurant, atë restaurant është si mini ekspozitë. Dhetë grafika nuk janë të vogla” edhe kërkund nuk majshe atëherë me bo ekspozitë kërkund, i kishin marrë shkijet atëherë.

Po ishin vitet e ‘96-‘97 edhe kur shkojnë në restaurant i qet ky aty. Ulen delegacionet ku i vishin Rugovës edhe ka njerëz që i kanë veprat e artit prezente nëpër shpia që ku e nxona në gojë këtë. I thotë Rugovës, “Kush i ka punu këto grafika?” “Pse” thotë, “a po të pëlqejnë a?” Thotë, “Po shumë po më pëlqejnë, shumë të mira teknikisht kokën punu”. Çohet ulet, shkon ngat m’i kqyr, se grafika duhet m’i kqyr edhe nga afërsia qysh e ka punu teknikisht me mujt me vjedh ndonjë detal qysh e ka gravu, e qysh e ka shtyp me mujt... P’e kqyr, tha, [Adnani \[Merovci\]](#) po m’tregon mu masanej, “P’i kqyr” tha kështu a din. Kur i ka thonë [Editës \[Tahiri\]](#), “Edita, shko te profesori thuji dy grafika le t’i bojn gati”. Fatmiri nuk është në shpi, s’ka telefon, unë në Gjakovë. Ka marr telefonin, “Ku është Fatmiri?” “Është në Gjakovë”.

Po m'thirrë Edita, në Gjakovë unë sa isha shku, e premtë me pushu pak. Thashë nja dy ditë, kur tha, "Po të thirrë Edita Tahiri", Hyrija në telefon. "Hajde Edita", thashë "Qeshtu, qeshtu" tha, "kryetari Rugova po i lyp dy grafika", andej e knej. Thashë, "Mori Edita kur t'vyjn ato grafika?" thashë, "Qitash jom në Gjakovë". Tha "A munesh nesër në natje ka ora dhetë se shkojnë", "Po," thashë, "nesër muj. Unë në mengjes çona edhe po vi, çka kom me bo", thashë. Hajt bona sakrificë, shkova ju çova, ju shtina në tuba ju bona krejt. Atyne ju kishin pasë pëlqy ato grafikat, kur, "Çka, grafika këtu?" Disi shumë peshë, shumë dhuratë e rondë kjo, a din me ta dhonë një vepër arti, "Kush o ky profesor i Fakultetit tonë, i Fakultetit të Arteve" a di tu i thonë. "Aaa {onomatope}".

E mandej, kur vishin qeshtu, Rugova donte mi pru. Ku mi pru nëpër atele? Atelea e vogël, se e dinte Edita u konë nja dy herë, Adnani qeshtu, u duhke me ja çu Adnanit në zyre dhe ajo.. kaniher shkojsa tek vajza në Zvicër e i thojsha Adnanit, "Kqyre se ja kom lonë djalit grafikat, e kur t'shkojsh lypja atij, ai ti jep cilën grafikë". Titullin e ka në kapak të shkrume të bome në tub, tuba e fortë plastikë edhe prej aeroplanit me gjujt s'ka problem me kapak, me letër mbështjellëse, perfekt profesionale ju bojsha.

Kur Adnani masanej, herën e vitit tjetër p'i thom, "Adnan, unë po shkoj tash në Zvicër grafikat ja kom lonë djalit". "Kuku, jo". Thashë, "Pse Adnan? Menxi e kom nxon atë djalë tondin" ky i ri a din, rrin deri ka njo sahati, ky gjithë ditën allo, allo e kish telefonin në xhep. "Allo, allo!" Badihava, s'ka. T'u e thirrë Adnani deri n'dymdhetë të natës. Thojke, "Mo pashë Zotën, bimi grafikat në zyre t'i kom edhe sa t'shkojnë, shkojnë për këtë një muj ditë" edhe ashtu ishte jeta edhe artistike si krijues me ato kushte në atë atele shumë të ngulfatun, të vogël, pa kushte edhe në kushte politike shumë jo të favorshme edhe së treti tu ju dhonë dije, ushqim shpirtërore, informative dije edhe studentave.

Ishte një rrëmujë që mos u ktheftë mo, por as vet nuk e di se si ja kom dalë. Kur e kqyri në atë kohë e kom bo "Trungun Ilir", e kom bo "Zogun e lirë", e kom bo "Mollën e epër" {tregon me dorë punimet}, por këto thojsha tash m'i punu edhe n'qito kushte, ndoshta s'di edhe a i kisha bo. Me të vërtetë kur i shiqoj a din, thojsha kaniherë se më inspiroj kur u hek propaganda atëherë, ato televizionet, radiot kishin të drejtë gjithçka me fol kur u hek, unë e bona, "Zogu i lirë", domethonë zogu i lirë me fluturu, çka të dush ishe i lirë, po. E kjo, "Molla në tokën e epur", tokë e djegme por megjithatë e rujtun, a din kështu e rujtun.

Ishin do gjana, nejtash ato "New Born" mas luftës, ato gjanat. Edhe ajo grafika është shumë e mirë [E shikon dhe bën me dorë nga grafika që e sheh] me ato dardhat aty, thom kur i kqyri me ato kushte, në asi situata tu prit edhe një ditë studenti kur i kanë fshi ato pllakat ma ka humb shaberin. Shaberi është një grryes, shaber është fjalë gjermane grryes, kur i ka pshtjell ato letrat me i gjujt në bërlllog e ka marr me gazeta, me krejt edhe shaberi ju ka pshtjell aty. Ju ka bo dengi i madh i atyne letrave edhe s'e ka ni shaberin që p'e ndrydh, se ajo është me maje, s'e ka ni edhe ju ka bo. Edhe e ka hudh.

Thojsha, "Qito mos ma leni. Këtë bërlllog që e boni, qito s'ju lo, merreni me veti, çojeni ka t'dilni, a kur t'vini nesër e gjoni pastër, e gjoni nxet edhe m'gjoni me kohë, as një minut me prit të dera, as një minut". Kur, ai student që ma ka hup, shumë keq i ka ardh. Kur po jen orën tjetër i thashë, "Po shaberin që e ki punu dje gjithë ditën? Mu m'ka vyjt ajo, ku e ki lonë?" "Profesor në tavolinë e kom

lonë qitu u konë”. Thashë, “More kërkush nuk u konë, unë kom ardh mas teje. Ti që i ki përzi ato i ki gjujt, mos e ki hudh me ato?” “Kuku, mos ndoshta e kom hudh nashta profesor, nuk e di” dhe thashë, “Mirë” thashë, “e ki bo padashje veç të kesh kujdes” thashë, “Ku me marr” thashë, “une?”

Kish nga, porositi vajzën në Zvicër me shku në këtë filan shitore, me ma ble këtë shaber të kësi soji, kështu duket, me ma ble se s’ mujsha me punu fare as studentat as unë. Është sikur penën kur e ki, sikur diçka që shkrun me ta. Ajo është grrysë. Thu, “Për qito paske hek keq profesor a? Jo bre po me pa ditë une” edhe kur mas dy vjete e kishte kry ai akademinë, kur po i bjen ziles *cërrrr* {onomatope}. “Mirëdita profesor”, “Mirëdita”, po e nxerr prej xhepit, tha, “Profesor, para dy vjete ta kom hup një shaber. Ta kom ble të ri në Gjermani edhe kom ardh me ta pru, se shumë keq m’ka ardh çka ki dhonë ti për ne edhe qato me ta hup” tha. Thashë, “Po e ki bo pa qëllim” thashë, “por duhet me pase kujdes a di”, tha, “Jo profesor, s’ia fali vetit hiç, por shumë faleminderës me m’falë”.

Kjo ishte ndoshta një storie, po thom ndoshta kisha shumë gjana se qysh ishin kriju, qysh janë bo në jetë, por krijimtaria shkon, po krijohet. Unë ka grafika që e kom ekzemplanrin e run, e ka një të mirë. Nuk e boj tirazhin e lartë, maksimum dhetë copa, përjashta “Skenderbeun” që e kom bo njëqind e sa kopje, po. Kjo është prej kopjeve të para [kthehet anash e shikon punimin] dhe mbetet pronë e autorit, se nuk e di çka kishte ndodh tonë ato vepra me shku edhe kisha qenë ma i vobekti [i varfëri] i botës, mos mi pasë ngat vetit ato. Se paret shkojnë e vijnë, kurse vepra të ngel edhe arti mbetet për veten, për trashëgimtarët, për brezat që neser mos të thonë që Kosova s’ka pasë grafikë edhe unë atë e thashë, mendoj me ja dëshmu që me atë monografi me mujt me lonë një shtresim brezor të gjeneratave që vijnë. Mandejna, të shohim. Do të kem punë prej gjeneratave ma të reja të studentave të mi.

Erëmirë Krasniqi: Zoti Krypa shumë faleminderit. Po mendoj që qitu ishim dashtë me përmbyll.